Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Reportazh

Mjegulla që fsheh gjurmët e historisë

Nga **SELMAN MËZIU**


3

Profil

Pedagogjikja, shkolla që ka nxjerrë mbi 2000 mësues

Nga **SHEMSI MANJANI**


4

Histori

Kastriotët e Kastriotit

Kur janë prezent faktet, fjalët janë të tepërta

Nga **MURAT KOLTRAKA**


20

Eja në Dibër!

Festa e të vjelave, Oda dibrane, Panair libri dhe Festivali i teatrove zhvillohen në Peshkopi dhe Dibër të Madhe në fillim të tetorit.

FAQE 4-5

NË BRENDËSI:

- Kërkimet arkeologjike në Bulqizë, zbulojnë një fortifikim të periudhës së Skënderbeut
- Një libër që kujton pjesë të jetës sonë
- Pedagogjikja e Peshkopisë, tempull i dijes
- Mimoza Leka, dibrania mësuese e shqipes në Gjermani
- Duke kujtuar Pedagogjiken e Peshkopisë
- 90-vjetori i shkollës së Bellovës
- Të lumtë Geraldo Hoxha!
- Një histori për klonin që ndau fshatin
- Elda, historia e një vajze që nuk shkon në shkollë
- Ledio, dhimbje dhe dashuri...!
- Takimi i fundit me Rexhep Smaçin



LETËRSI

Batakçiu fiton gjyqin - nga Xhafer Martini

Shkrimtari i fshatit tonë - nga Agron Tufa

Xhaketa e Aliut - nga Ramiz Gjini

Funeral - nga Artan Gjyzel Hasani

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën **<rrugaearberit@gmail.com>**
ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT.
Kushton vetëm 600 lekë në vit.
email: rrugaearberit@gmail.com

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (149). Shtator 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit tetor 2018.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Agron TUFA
Ramiz GJINI
Murat Koltraka
Sami Curri
Selman Mëziu
Shemsi Manjani
Bajram XHAFA
Halil RAMA
Hajri SHEHU
Besnik LAMI
Sakip CAMI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

FotoFAKT



Nga punimet në Urën e Çerenecit, pjesë e Rrugës së Arbrit. Foto: Facebook/Maqellara - Vendi im.

Kërkimet arkeologjike në Bulqizë, zbulojnë një fortifikim të periudhës së Skënderbeut

Kodra është përmendur në një buletin arkeologjie në vitet ’50 nga arkeologu i njohur Hasan Ceka, por deri sëfundmi askush nuk ishte interesuar se çfarë gjendej vërtet aty, përveç thesar kërkuesve. Vandalizmi i të cilëve i ra menjëherë në sy arkeologut Adem Bunguri dhe arkitektit Elio Hobdari nga Instituti i Arkeologjisë në Tiranë, kur këtë gusht kryen vëzhgime sipërfaqësore në rrënojat që ndodhen në majë të kodrës.

Nga **SAMI CURRI** | **BIRN**



Gjatë vëzhgimit në rrënojat e fortifikimit te “Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut”, në Bulqizë. Foto:Sami Curri.

Ngjitja deri aty është gati e pamundur edhe kur nuk ka ushtri që ta ruajnë. Një kodër rreth 1 mijë metra mbi nivelin e detit, në formën e një koni, në fund të një rrëpire në Valikardh të Bulqizës, të cilën banorët e njohin si “Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut”, ka tërhequr sëfundmi vëmendjen e arkeologëve.

Kodra është përmendur në një buletin arkeologjie në vitet ’50 nga arkeologu i njohur Hasan Ceka, por deri sëfundmi askush nuk ishte interesuar se çfarë gjendej vërtet aty, përveç thesar kërkuesve. Vandalizmi i të cilëve i ra menjëherë në sy arkeologut Adem Bunguri dhe arkitektit Elio Hobdari nga Instituti i Arkeologjisë në Tiranë, kur këtë gusht kryen vëzhgime sipërfaqësore në rrënojat që ndodhen në majë të kodrës.

Vëzhgimet dhe matjet e tyre zbuluan rrënojat e një fortifikimi dhe një cisterne e uji, por arkeologët gjetën që ato kishin qenë pre e kërkimeve të thesar kërkuesëve dhe ishin vandalizuar dhe dëmtuar shumë. “Me atë vëzhgim që bëmë ne, kuptuam se kishim të bënim me përdorimin e një cisterne (vend depozitim uji) nga më modernet që janë përdorur në periudhën mesjetare”, thotë Bunguri.

Rrënojat e një fortifikimi, sipas arkeologut janë në përmasat e një kalaje të vogël besohet se i kanë shërbyer Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) në dy betejat e fushës së Vajkalit kundër ushtrive otomane të drejtuara nga Ballaban Pasha. Nga aty është e mundur të kontrollohet hyrja për në fushën e Vajkalit. Sipas historisë Skënderbeu i përdori fortifikimet për të mos lejuar bashkimin e dy ushtrive osmane të dërguara njëkohësisht kundër tij, të cilat më pas i mundi veç e veç në Vajkal dhe Kashar të Tiranës.

“Zbulimi konfirmon plotësisht dy betejat e Vajkalit mbajtur në këtë zonë. Një kullë fortifikuese, me përmasat le të themi të një kalaje të vogël që kishte për mision kryesor, ruajtjen e rrugës së Arbërit në atë kohë”, thotë profesor Bunguri. Arkeologët besojnë se nga gërmimet e thelluara mund të kuptohet më shumë për stragjitë dhe betejat që u zhvilluan në vitet 1464 dhe 1465.

Mësuesi i historisë në Bulqizë, Gazmir Sejdin i tha BIRN se në zonën e Bulqizës deri më sot thuajse nuk janë zhvilluar gërmime arkeologjike. Ai thotë se zbulimi është një mundësi për kërkime me të thelluara, ndërsa shton se rrënoja të ngjashme si fortifikimi në fjalë janë të rralla “dhe vlerat e tyre kulturore dhe historike duhet të ruhen me fanatizëm”. Sipas tij duhet punë për t’i ruajtur këto zona nga thesar kërkuesit.

Për Sejdin një zbulim i tillë është shumë pak nga ajo se çfarë mban nëntoka e Bulqizës përsa i përket arkeologjisë, sepse në mesjetë ka qenë qendër e një sërë betejash të Skëndërbeut dhe një zonë me rrugë kalime shumë të rëndësishme.

Bunguri, thotë se së bashku me arkitektin Elio Hobdari nga Instituti i Arkeologjisë do punohet që një zbulim i tillë të futet në listën e zonave të mbrojtura dhe që në të ardhmen të ketë një gërmim shumë më të zgjeruar.

Bunguri tregon për BIRN se fortifikime të tilla zgjidheshin nga Skënderbeu për shkak të vështirësive të terrenit dhe pamundësisë së ngjitjes nga ushtritë kundërshtare. Sipas tij zbulimi i rrit vlerat dhe shton potencialin turistik të zonës, por vëren se aty ende mungon sinjalistika dhe nuk ka tabela informuese.

Ndërkohë edhe vëzhgimi sipërfaqësorë arkeologji, ka ngjallur shpresa se kodra megjithëse vështirësisht e aksesueshme është një mundësi për banorët në zhvillimin e turizmit. Lulzim Hupi i cili prej disa vitesh pret turistë të huaj dhe vendas në një kullën afro 200 vjeçare, vetëm 1 orë e gjysëm larg nga “Shkëmbi i Kullës së Skënderbeut”, beson se një zbulim i tillë arkeologjik është shumë i rëndësishëm. “Kemi diçka se çfarë mund t’i tregojmë një të huaji kur vjen në Bulqizë, jo vetëm minierën”, thotë ai.

(Marrë nga www.reporter.al)

reportazh

Mjegulla që fsheh gjurmët e historisë

Nga **SELMAN MEZIU**



Ura e Drinit e projektuar me harqe nga një inxhinier italian, filloi punimet rreth vitit 1940. Në atë punë teje të vështirë, disa humbën dëgjimin, të tjerë morën ftohje të rëndë në mushkri, që më pas, ju shkaktoi vdekjen e parakohshme.Në shtatorin e vitit 1943 punimet u ndërprenë. Përfunduan këmbët e drejta dhe venia e elementëve të hekurit nga një shoqërie angleze në vitin 1946. Garancia e ndërtimore pra jetëgjatësia e saj ishte për dyzetë vjet.

Izgavruar nga shpirti e mosbesimi, rropatesha së vëzhguari e gjurmuari dëshmitë historike të krahinës së Muhurrit, ku tallazet e ujërave të lumit Drin dhe Murra dyluftojnë në shekuj. Ato rrinë të fshehura, thellë në hojet e damarët plotë jetë të tokës, të padukshme, në errësirën e thellësive të saj, të padijeve e moskokëçarjeve. Nuk po di pse unë i përfytyroi si yje në hapësirën e paanë të qiellit, ku rrymat e korenteve ajrore herë i mbulojnë me mjegull, herë i bëjnë të duken, por vetëm si xixëllonja pranvere.

MAZREKAT E MAZREKASIT TURFULLOJNË

Ato janë këtu, në mes malesh, kodrash, kurrizesh dhe muresh të ngjashme me një kala natyrore të përsosur. Me gërmadhat e shtëpive e vilave të dinastisë së Mazrekajve të varrosura. Ato kanë muret e kalasë, bedenat me dy gur të lart në disa vende të kurrizeve, me tumat e rojeve e shërbyesve të tyre, në dy anët e arës së Kurte.

Me Shajshat, vendstërvitjen e kazermat e ushtrisë dhe rojeve të familjes fisnike të mazrekasve në perëndim të kurrizit prej disa kilometrash Qafë Dardhë- Maja e Sukës, në krahinën e Muhurrit, një livadh prej disa dynymësh me dy kate, ku në atë më të lartin në vitet '60 të shekullit të kaluar dukeshin tjegulla, gurë e themele të dallueshme.

Maja e Sukës, një majë shkëmbore, me vendrojen 150 metra poshtë kësaj maje, ku vrojtoheshin të gjitha lëvizjet e këmbësorëve apo ushtrive përgjatë grykës së Murrës e përroit të Shqathit.

Në verilindje, duke ndjekur kurrizin e Majës së Vakufit me kuotë 788 metra e zbritje në drejtimin Jug- Lindje, deri në kodrën e Rreskave, e cila gjendet në një livadh me mbetje gurësh që thuhet se kanë qenë burgjet e mazrekasve. Sot njihen me emrin Ara e Robit, e shkruar shkoqur, vendi ku mbaheshin robt e luftës apo të burgosurit.

Kanë shkruar për këto kërkuesit e së vërtetës, shkruesit, historianët Hazis Ndreu, Agim Boba, Fatos Daci, Besnik Këbej. Dhe më tutje, vetëm me një kalim, ka gjetur disa fragmente tjegullash arkeologu Iljaz Kaca, që shkruan se "këto i përkasin mesjetës". Dhe kaq. Ndërsa gojëdhënat e ardhura përgjatë majave thepa-thepa të kohërave janë të shumta, për mbiemrin e parë të Kastriotëve, fisin e Mazrekasve.

Arkeologjia, për më se tetë shekujsh, nuk ka filluar as edhe një gërmim arkeologjik. Historianët e periudhës mesjetare në Institutin e Historisë as që e dinë që ekziston. E fshehur kështu në mjegullnajen e kohërave, nën shtresat e tokës e shtrëngimin e rrënjëve të bimëve të ndryshme, pushojnë në paqe

> Autoritet shtetërore në qendër, me Ministrinë e Transportit dhe të Ndërtimit, duhet ta dinë se ajo sot apo nesër do të shkaktojë një tragjedi njerëzore. Edhe pse historia e kësaj ure dihet, ajo fshihet qëllimisht ose për të vjedhur fondet për rindërtimin e saj, ose presin të ndodh shembja e saj bashkë me humbje jetë njerëzish nga Selishta, Muhurri, Luznia e Sina.

e të pavlerësuara këto dëshmi historike. Me sa duket, rrënjët e origjinës së prejardhjeve të Kastriotëve do të "flenë gjumin e madh" edhe për shumë vite, dhjetëvjeçar, ndoshta edhe shekujsh.

SHGJERTHI

Një sipërfaqe toke prej disa hektarësh, e thirrur Gjerdhi i Epër dhe Gjerdhi i Poshtëm, të shkruar edhe në kujtimet e Gjon Muzakës (1510), me gërmadha ende të fshehura, që rënkojnë ndër muzgjet e shekujve, dëshmitë kryeneçe që kanë bërë epokë. Por, ato nuk i përfill askush, as ambasadori serb Jasterbov, as dje dhe sot qindra intelektualë e mësues të krahinës së Muhurrit në Dibër. Ndërsa i pari, atdetari e shkrimtari dibran Haki Stërmilli do të lidh toponiminë Gjerthsh, gjeografikisht të përcaktuar me thënien proverbiale të Muzakës.

Përpiqen të tjerë ta dritësojnë, e të tjerë ta degdisin pa fre diku larg, e gulçimat e të pavërtetave, kanë mbuluar yllësinë e së vërtetës. Padija, ndëshkimi i kohërave, po shpërbën tokën e bekuar të Pal Kastriotit. Damarët e saj po çahen nga kapriçot e klimës dhe pakujdesia e tiranëve të vetvetes që e rrethojnë.

Gardhi i Epër dhe i Poshtëm kanë rrafshnaltën e Mojzës përkundruall, banuese në regjistrin turk të vitit 1467, me emra baballarësh, fëmijësh por fatkeqësisht pa mbiemra.

Pra, nyja e të panjohurave veç përdridhet e përdridhet pamëshirëshëm duke ndrydhur, shtrydhur për vdekje të vërtetën. Askush nuk interesohet, as qeveritë, as shkenca e arkeologjisë, historisë, toponomistikës, antropologjisë që ta "shqyejnë" copë më copë për të zbuluar thelbin e së vërtetës epokale.

HAPNI GRYKËN TË SHIKONI MREKULLITË!

E mbuluar me dhe të kuqëluar dhe gur të përmasave të ndryshme, rreth viteve '70 të shekullit të kaluar, pa menduar se po varrosnin një mrekulli natyrore dhe një vend dëshmitare e epokës së gurit. Askush nuk mendon, as t'iu shkoi ndërmend ta rihapin. Ndërsa sopata prej guri e gjetur nga inxhinieri gjeolog Mustafa Seferi flet si një ciceron i vërtetë, falë edhe dhënies jetë, nga arkeologu e historiani Iliaz Kaca.

Ndërsa nuk i dihen gjurmët kafshës prehistorike, pa kokë, gjetur po këtu në Shpellën Zgjorgj nga speleologët Çek në vitin 1952, e ruajtur deri në vitet e fundit në Muzeu e Biologjisë në rrugën e Kavajës në Tiranë.

Gjithçka e përhumbur nga mosdijenia, nga mos vlerësimi, nga burokracia shtetërore dhe nga paftësia e njësive administrative lokale. U përpoqa të shkërmoq thëngjijtë e zinj, për





Ndërsa Ura e lumit Murra, edhe pse u ndërtua rreth viteve'70 me projektin e studimin nga inxhinierët shqiptar është kthyer në një kufomë frikëndjellëse.

të zbuluar atje, pak energji pozitive, që t'i shtyje këto struktura apo njerëz të veçantë që ta hapin grykën e shpellë Sgjorgj, për të folur me zërin kumbues, historia muhurrake mijëra vjeçare, por nuk kam besim se do t'ia arrij qëllimit.

URA E MUHURRIT - URAT E VDEKJES?!

Po, çfarë do të thotë kjo? Edhe ato kanë historinë e tyre. Por atyre me sa duket në këto kohëra që jetojmë e me këto qeveri që po përjetojmë do të shkruhet historia me germa gjaku të të varferve të pafajshëm. Dhe ja të qartësojmë ngjarjen.

Ura e Drinit e projektuar me harqe nga një inxhinier italian, filloi punimet rreth vitit 1940. Në verën e atij viti, ku motor kompresoret hiqnin ujin, ndërsa bijtë muhurrakë grryenin e betononin themelet e këmbëve të saja. Në atë punë teje të vështirë, disa humbën dëgjimin, të tjerë morën ftohje të rëndë në mushkri, që më pas, ju shkaktoi vdekjen e parakohshme. Por Italia kapitulloi në shtatorin e vitit 1943 prandaj punimet u ndërprenë. Përfunduan këmbët e drejta dhe venia e elementëve të hekurit nga një shoqërie angleze në vitin 1946. Garancia e ndërtimore pra jetëgjatësia e saj ishte për dyzetë vjet.

Autoritet shtetërore në qendër, me Ministrinë e Transportit dhe të Ndërtimit, duhet ta dinë se ajo sot apo nesër do të shkaktojë një tragjedi njerëzore. Edhe pse historia e kësaj ure dihet, ajo fshihet qëllimisht ose për të vjedhur fondet për rindërtimin e saj, ose presin të ndodh shembja e saj bashkë me humbje jetë njerëzish nga Selishta, Muhurri, Luznia e Sina.

Ndërsa Ura e lumit Murra, edhe pse u ndërtua rreth viteve'70 me projektin e studimin nga inxhinierët shqiptar është kthyer në një kufomë frikëndjellëse. Gjendja e saj u përkeqësua, kur një vërshim i madh i lumit në fjalë në vitet '80 të shekullit të kaluar, ku një pjesë e saj u shemb, e cila u zëvendësua me urë hekuri. Ndërsa pranvera e vitit 2018 e ka çuar jetën e saj në fije të perit.

Kur valle do të ndërhyhet? Koha nuk pret, kjo urë çalon, "shqipon", - siç i themi ne, muhurrakët, nga të dyja këmbët. Me sot me nesër, bashkë me urën e sëmurë rëndë do të largohen nga kjo jetë edhe ndonjë mikrobus apo autobus me dhjetëra njerëz nga Qaf Murra, Selishta, Kacnia apo Fushë Muhurri. E kundërta për këto ura historia dihet por shtetarët nuk duan t'ia dinë për pasojat, për vlerat e tyre njerëzore dhe ekonomike, pa harruar e neglizhuar ndihmesën e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të krahinës.

* * *

Jeta e muhurrakëve ka qenë e vrullshme. Ajo është përplasur në betejat e kohërave me egërsi, duke lënë gjurmë të thella. Por, ja që edhe shekulli i njëzetë nuk arriti të zbulojë, shkruaj e dëshmojë mbi bëmat historike apo vlerat e veprave të artit e komunikimit. Edhe ky shekull i mjegulluar ka filluar për banorët e Muhurrit. Por, siç thuhet, shpresa vdes e fundit!

Rruga e Arbërit nr. 149

pedagogjikja

Pedagogjikja, shkolla që ka nxjerrë mbi 2000 mësues

Nga **SHEMSI MANJANI**

Kam kënaqësi të veçantë që sot, në moshën 85-vjeçare, arrita të jem këtu bashkë me ju e t'ju përshëndes të gjithëve, të ardhur për të përkujtuar 70-vjetorin e shkollës së parë të mesme të Dibrës, shkollës pedagogjike, nxënës i së cilës kam qenë që në fillimet e saj, disa vite mësues së bashku me bashkëshorten e, së fundi si drejtor, dhe duke vazhduar pastaj gati po aq vite mësues, në seksion të arsimit, por i lidhur ngushtë me ish-nxënës, shokë e mësues të shkollës pedagogjike.

Të gjithë ne, ish-pedagogjikasit, mësues e nxënës, ruajmë kujtimet më të mira për vitet që kaluam bashkë, duke pasur parasysh përkushtimin e të gjithëve për të arritur rezultate sa më të larta në mësime e në çdo drejtim. Të admirueshme qenë marrëdhëniet mësues-nxënës që vazhduan e vazhdojnë pa ndërprerje gjatë gjithë këtyre viteve të shumta në pension, me takime të përzemërta të rastësishme ose të organizuara, si për 7 Marsin. Në mënyrë të veçantë të paharruara do të mbeten dhe organizimet e përvjetorëve të maturave apo shumë raste të tjera të gëzuara, kur, të mbledhur së bashku mësues e nxënës, kënaqësia, gëzimi dhe hareja arrinte kulmin.

Dhimbje të thellë ndjejmë sot për ata që nuk janë midis nesh, ish-mësues e ish-nxënës që janë ndarë nga jeta, dhimbje që na ka shoqëruar ndër vite, sa herë mësonim për këto humbje nga radhët tona. I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre.

Përvjetori i kësaj shkolle për gjithë zonën verilindore është i lavdishëm, sepse ishte dhe mbetet e lavdishme vepra e saj, elita e parë për përgatitjen e mësuesve e gjenerimin e personaliteteve vendase. Janë mësuesit e personalitetet që kanë lënë gjurmë të pashlyera për rrezatimin e dritës së dijes në gjithë zonën e më gjerë.

Viti 1948, kur u hap kjo shkollë, e gjeti Dibrën me afro 90% të popullsisë analfabete, vetëm me 14 mësues me arsim përkatës, që kishin mbaruar Shkollën Normale të Elbasanit dhe edhe më keq në rrethe të tjera të kësaj zone. Kishte fshatra ku asnjë nuk dinte të shkruante e të lexonte. Në mjaft shkolla jepnin mësim mësues pa arsimin përkatës, të përgatitur nëpër kurse e forma të tjera kualifikimi. Rol vendimtar për shumicën e shkollave të ciklit fillor e shtatëvjeçar, që funksiononin në ato vite të para, e luajtën mësuesit e ardhur nga rrethe më të zhvilluara, kryesisht nga Elbasani e Shkodra. Populli i zonës verilindore u është mirënjohës për jetë atyre mësuesve që punuan për vite të tëra me përkushtim dhe në kushte të vështira pune e jetese, larg familjeve të tyre.

Qeveria e atyre viteve, fill pas çlirimit, ndonëse në kushte të vështira, duke e pasur të qartë se arsimi është themeli mbi të cilin ndërtohet e ardhmja e çdo vendi, vendosi hapjen e shkollës pedagogjike për të përgatitur mësues për gjithë këtë zonë, që ishte ndër më të prapambeturat në atë kohë në gjithë Shqipërinë. Ndërtesa u bë gati nga specialistët dibranë, gollobordasit duarartë, për shtatorin e vitit 1948, siç ishte planifikuar, me të gjitha pajisjet e nevojshme. Ishte një ndërtesë nga më madhështoret në vend, siç është pohuar edhe nga mësuesit e porsaardhur nga qytetet kryesore të vendit. Shkolla ishte me katër kate, me 12 klasa mësimi, me korridore me shumë ndriçim, me konvikt brenda ndërtesës për 300 konviktorë, me të gjitha mjediset për mësim, edukim e argëtim. Kësaj shkolle iu



Shkolla pedagogjike funksionoi deri në vitin 2008, nga ku dolën mbi 2000 mësues, ndër to afër 450 mësuese, duke llogaritur këtu dhe ata që e mbaruan shkollën me korrespondencë. Mbi 35% e nxënësve të kësaj shkolle vit pas viti mbaruan arsimin e lartë të rregullt a me korrespondencë e ndonjë edhe jashtë vendit.

bashkëngjit shpejt dhe ndërtesa e shkollës ushtrimore, po me katër kate për praktikat mësimore, ku do të jepnin mësim mësuesit më me përvojë për shkollat fillore e ku do të ushtroheshin mësuesit e ardhshëm.

Shkolla pedagogjike funksionoi deri në vitin 2008, nga ku dolën mbi 2000 mësues, ndër to afër 450 mësuese, duke llogaritur këtu dhe ata që e mbaruan shkollën me korrespondencë. Mbi 35% e nxënësve të kësaj shkolle vit pas viti mbaruan arsimin e lartë të rregullt a me korrespondencë e ndonjë edhe jashtë vendit.

Edhe më shumë rezultate do të kishte pasur kjo shkollë, nëse nuk do të ishte ndërprerë disa herë vazhdimi i saj, me pasoja jo vetëm për numrin e mësuesve të përgatitur, por edhe për zbehjen e përvojës së fituar gjatë 19 viteve pa ndërprerje, nga 1948 deri më 1967. Në fund të kësaj periudhe kjo shkollë radhitej me shkollat më të mira të Republikës. Shumë vetave u pëlqente ta quanin dhe e quajtën "Universiteti i zonës verilindore".

Me mësuesit dhe nxënësit e saj, që erdhën duke u shtuar nga njëri vit në tjetrin, Pedagogjikja me veprimtaritë e shumta kulturore, artistike e sportive i dha gjallëri qytetit të Peshkopisë.

Meritë të veçantë në arritjen e sukseseve të kësaj shkolle kanë pasur padyshim drejtuesit e mësuesit e saj, populli i këtyre anëve i etur për arsim e dije dhe fëmijët e tyre të zellshëm. Në nderim të punës së përkushtuar të tyre, më lejoni të kujtoj disa nga drejtorët e mësuesit që kanë lënë gjurmë në shkollën tonë:

- **Rexhep Kadcadej** nga Elbasani, drejtori i parë që filloi punën, pasi mbaroi shkëlqyeshëm Institutin Pedagogjik Dyvjeçar;
- **Pandi Cici**, nga Korça, që kishte studiuar në Francë, me shumë përvojë të fituar brenda e jashtë vendit, i cili erdhi familjarisht në Peshkopi;
- **Shefik Osmani**, nga Shkodra, drejtori që qëndroi më gjatë në këtë detyrë, deri në vitet kur dolëm ne, dy maturat e para, dhe disa prej nesh me interesimin e kujdesin e tij u caktuam për të vazhduar studimet e larta;



Në foto: Nga takimet me rastin e 70-vjetorit të shkollës Pedagogjike

- **Astrit Hozha,** nga Dibra, që kishte mbaruar gjimnazin në Shkodër e Fakultetin për matematikë me rezultate shumë të mira, punoi në këtë shkollë një vit si mësues e tre vite si drejtor;
- **Zenel Sula,** nga Dibra, i pari si ish-nxënës i shkëlqyer që u dërgua nga kjo shkollë për studime të larta në ish-Bashkimin Sovjetik, ku përfundoi po me rezultate të shkëlqyera dhe pastaj punoi disa vite si drejtor i shkollës sonë. Pas këtyre erdhën në këtë detyrë: **Sami Ferizi, Shemsi Manjani, Myslim Koka** etj. Në vitet e fundit para mbylljes, drejtor i suksesshëm ka qenë **Ilmi Cani**, më i interesuari dhe më i përkushtuari në qytetin e Peshkopisë për festimin e këtij përvjetori.

Këtë shkollë e drejtoi vetëm një shoqe, **Naxhie Zekja,** mësuese e ardhur në Dibër familjarisht, pasi i shoqi ishte dërguar me detyrë partie. Ajo u dallua për aftësi drejtuese, përkushtim në punë e për marrëdhënie shumë të mira me kolektivin mësues-nxënës.

Një nderim i veçantë shkon për mësues e mësuese që punuan në këtë shkollë. I kujtojmë disa prej tyre: **Jorgji Sinjari, Kleanthi Qendro, Ismail Turdiu, Llazar Mbreshtanaku, Shefki Hafizi, Sotir Temo, Kolë Tahiri, Hasan Kaduku, Semi Hoxha, Kadri Shupheja, Andon Lakuriqi;** mësuesit dibranë: **Moisi Cami, Ismail Erebara, Shemsi Manjani** e **Zenel Sula,** të parët mësues, ish-nxënës të kësaj shkolle. Mësues të tjerë dibranë: **Riza Manjani, Munir Shehu, Ismet Bellova, Osman Turja, Sabri Vraniçi, Lutfi Hanku, Bexhet Shehu, Myfit Trepça, Fadil Kaca, Qani Përtafi, Bajram Mata, Hamza Spahiu, Fitim Mati, Lavdrim Kaba, Kadri Zhulali, Xhetan Strazimiri, Durmish Shehu, Sefulla Shehu** e shumë të tjerë deri në mbyllje të saj.

Mësueset e pedagogjikes: **Juli Levani, Perihan Dizdari**, **Diamanda Doda, Nevrez Manjani, Fanie Hoxha, Fatmira Zeqo** dhe mësueset e ushtrimores**: Jolanda Rada, Irena Bitri, Drita Zhulali, Hava Hoxha, Sanie Sula** e të tjera.

Nga personeli i konviktit meritojnë gjithë nderimin tonë, zëvendësdrejtorë e kujdestarë: **Nuri Prenjasi, Bardhul Hakani, Hajdar Haxhihyseni, Shemsi Zhulali, Adem Shehu, Remzi Prapaniku, Terzi Dungu, Nuri Abdiu, Esat Caka, Iljaz Kaca, Islam Kosova, Lutfi Manjani, Hava Hoxha, Nadire Hasa, Bardhoshe Pepleka, Fatmira Zenuni, Hike Strazimiri** e të tjerë.

Nuk mund të lëmë pa përmendur në këtë përvjetor e në çdo veprimtari tjetër arsimore e kulturore në Dibër legjendën e arsimit dibran, **Selim Alliun**, me kontribute të shumta për hapjen e funksionimin e kësaj shkolle e zhvillimin me suksese të arsimit e kulturës në Dibër. Ai qe afër 20 vjet shef i seksionit të arsimit e kulturës në Dibër, një detyrë me shumë përgjegjësi e me probleme të shumta për t'u zgjidhur, që i përballoi me sukses, me maturi e kompetencë si askush tjetër. Ai është i pari në Dibër që u vlerësua me titullin më të lartë për kohën "Mësues i popullit".

Të nderuar pjesëmarrës!

Është provuar tashmë se në shumicën e rasteve, pikënisja për arritje të suksesshme e të dallueshme në jetë, fillon që me vazhdimin e mbarimin me sukses të shkollave të mesme e duke vazhduar me shkollat e larta, pa nënvlerësuar kushtet e tjera favorizuese ose jo për këto arritje. Nuk bëjnë përjashtim këtu për këto arritje të dallueshme dhe mjaft ish-pedagogjikas, personalitete, kudo ku kanë punuar e

(Vijon në faqen 6)

arsim



Në foto: Nga takimet me rastin e 70-vjetorit të shkollës Pedagogjike

Viti 1948, kur u hap kjo shkollë, e gjeti Dibrën me afro 90% të popullsisë analfabete, vetëm me 14 mësues me arsim përkatës, që kishin mbaruar Shkollën Normale të Elbasanit dhe edhe më keq në rrethe të tjera të kësaj zone. Kishte fshatra ku asnjë nuk dinte të shkruante e të lexonte. Në mjaft shkolla jepnin mësim mësues pa arsimin përkatës, të përgatitur nëpër kurse e forma të tjera kualifikimi. Rol vendimtar për shumicën e shkollave të ciklit fillor e shtatëvjeçar, që funksiononin në ato vite të para, e luajtën mësuesit e ardhur nga rrethe më të zhvilluara, kryesisht nga Elbasani e Shkodra. Populli i zonës verilindore u është mirënjohës për jetë atyre mësuesve që punuan për vite të tëra me përkushtim dhe në kushte të vështira pune e jetese, larg familjeve të tyre.

(Vijon nga faqja 5)

drejtuar gjatë këtyre viteve. Unë si më i moshuari dhe më i lidhuri e më i njohuri me arritjet e ish-nxënësve të Pedagogjikes, mendova t'i përmend në këtë përshëndetje disa prej tyre për arritjet më të dallueshme gjatë gjithë kësaj periudhe të gjatë duke u nisur nga fakti se është përvjetori i shkollës së tyre. Kërkoj falje për ndonjë harresë apo vlerësim ndoshta jo aq objektiv, siç ndodh në kësi rastesh, në konsiderata personale:

- **Shaban Sinani,** prof. dr. studiues dhe historian i letërsisë, etnolog dhe publicist, shumë i vlerësuar për punimet e realizuara në fushat e mësipërme nga studiues të ndryshëm, brenda e jashtë vendit, akademiku i parë dhe i vetëm nga të gjithë ish-pedagogjikasit e shkëlqyer. Librat dhe studimet e tij të shumtë kanë të veçantë se, veç cilësisë së lartë, trajtojnë probleme të rëndësishme për kombin;
- **Hajri Shehu**, prof. dr., studiues në fushën e gjuhësisë më kontribute të shumta në fushën e leksikografisë e leksikologjisë, bashkautor në hartimin e disa fjalorëve shpjegues të shqipes, autor i një fjalori anglisht-shqip, si dhe i një fjalori krahinor për zonën e Dibrës (Ujemuja);
- **Enver Hysa**, prof. dr., studiues në fushën e gjuhësisë me kontribute të veçanta në fushën e morfologjisë e të fjalëformimit, bashkautor i Gramatikës shkencore të gjuhës shqipe dhe autor i shumë punimeve në fushat e mësipërme, bashkautor i shumë teksteve të gjuhës për shkollat e cikleve të ndryshme;
- **Bajram Xhafa** e **Muharrem Dezhgiu,** prof. dr., studiues në lëmin e historisë, me studime e botime të rëndësishme në këtë fushë;
- Studiues, botues e shkrimtarë të dalluar, që kanë dalë nga kjo shkollë: Prof. dr. **Shefqet Hoxha, "**Mësues i popullit**",** prof. dr. **Arian Kadiu** "Mjeshtër i madh", shkrimtar**;** shkrimtarë e studiues të tjerë: **Xhafer Martini**, shkrimtari ynë i mirënjohur**, Naim Plaku, Lutfi Hanku, Qemal Mata, Rakip Lasku**, **Hysen Shehu, Xhezair Abazi** etj.;
- Gazetarë: I mirënjohuri **Kamber Faruku, Garip Troci, Zaim Basha, Urim Bajrami;**
- Artiste e artistë: **Lirie Rasha**, ëmbëlsia e këngës dibrane, këngëtare e talentuar, shumë e duartrokitur brenda e jashtë vendit, piktorët: **Pjetër Marku, Duro Ibrahimi;** artistë të skenës teatrale: **Dervish Biba, Bajram Ballabani;** muzikantë: **Ahmet Balliu, Iqmet Hoxha, Nuredin Mazari, Mersin Iskurti**;
- Sportistë: **Lutfi Manjani, Shemsi Manjani, Islam Kosova, Meleq Kaloshi, Fran Lena, Zyber Xhetani, Dodë Progni, Kadri Zhulali** (shahist), **Fllanza Toçi**, ish-pedagogjikase, volibolliste e dalluar e "Korabit" në kategorinë e parë.
- Drejtues e pedagogë në arsimin e lartë e në institucione shkencore të vendit: Prof. dr. **Nuri Abdiu, "**Mësues i popullit**",** zëvendësdrejtor në Universitetin e Shkodrës, **Kadri Zhulali,** dekan i Fakultetit Ekonomik, **Enver Hysa**, zv.-drejtor i Institut të Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave e pedagog, **Hajri Shehu, Agim Bardulla, Bajram Xhafa, Shaban Sinani, Shaban Çollaku** e **Riza Lika;**
- Diplomatë: **Abdi Baleta,** ish-pedagogjikas i shkëlqyer, përfaqësues i Shqipërisë në OKB, botues i mjaft librave e shkrimeve me vlerë, **Sulejman Tomçini,** 8 vjet ambasador në Egjipt, Algjeri e Arabinë Saudite, përkthyes e autor i fjalorëve arabisht-shqip e shqip-arabisht. Të tjerë diplomatë **Maxhun Peka,** ish-ambasador në Vietnam, Francë e Kinë, i cili sapo ka botuar librin "Një jetë në diplomaci", **Lazam Koldashi, Përparim Sinani, Ivzi Çipuri, Adem Ymeri** e **Kamber Faruku;**
- Drejtues në Komitetitet Ekzekutive, të Partisë, të Rinisë e të institucioneve të tjera të rretheve: **Avni Fida, Selvie Lena**, **Petrit Spahiu** e **Haxhi Krashi. Lavdrim Shehu,** nxënës i dalluar në shkollë e si mësues, kryetar i Këshillit të Rrethit në vitet e demokracisë;
- Ushtarakë: **Hasan Leka, Sali Onuzi, Shahin Zogu, Musa Riçku:**
- Shefa të seksioneve të arsimit: **Moisi Cami** e **Shemsi Manjani** në Dibër, **Esat Sula** 12 vite në Mat, **Dali Tota** e **Qemal Mata** në Kukës, **Zymbile Zeneli**, Shefe e seksionit të kulturës, kur ky seksion u nda nga ai i arsimit;
- **Zenel Kurti** e **Xhavit Lashi**, sekretarë të parë të komiteteve të rinisë e sekretarë të komiteteve të partisë në Mat e Kukës. Xhaviti, ish-nxënës i shkëlqyer në pedagogjike, i cili, pas botimit të librit voluminoz "Qarku i Kukësit në rrjedhën historike", na ka sjellë sot librin shumë të mirëpritur për ne "Shkolla pedagogjike e Peshkopisë". Po kështu dhe shkrimtari i mirënjohur **Xhafer Martini** ka sjellë librin e ri të tij "Pedagogjikja, personalitete". Me këtë rast i falënderojmë për këto botime me rastin e këtij përvjetori të lavdishëm të shkollës sonë.
- Disa ish-pedagogjikas në vite të ndryshme janë zgjedhur deputetë: I pari nga radhët e arsimit, **Moisi Cami,** pastaj **Natasha Kodra,** ish-nxënëse e shkëlqyer e pedagogjikes, **Shefqet Hoxha,** po i shkëlqyer, **Mustafa Hoxha**, deputet e shumë vite kryetar i BP në Kukës e **Bukurie Lleshi.** Të tjerë ish-pedagogjikas deputetë e drejtues në organe të larta të Partisë, të Pushtetit e të institucioneve të tjera: **Xhelil Gjoni**, në poste të larta partie, **Tefta Cami e Safet Zhulali,** ministra, **Fehmi Abdiu**, kryetar i Gjykatës Kushtetuese, **Lumturi Rexha**, kryetare e Bashkimit të Grave të Shqipërisë.

Duke përfunduar, dëshiroj të falënderoj e të përgëzoj Prefektin dhe të gjithë drejtuesit e Qarkut e të Bashkisë së qytetit të Peshkopisë për kontributin e dhënë në përkujtimin e këtij përvjetori e për pritjen tonë dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë përvjetor.

Lavdi veprës së ndritur të Shkollës Pedagogjike të Dibrës, fidanishtja e parë për përgatitjen e mësuesve dhe gjenerimin e personaliteteve vendase!

Rroftë populli dibran dhe i gjithë Shqipërisë!

PESHKOPI

26 shtator 2018.

Botim i ri

Xhafer Martini


PEDAGOGJIKJA & PERSONALITETE


Botimet M&B | ISBN: 978-9928-256-42-3 | 312 faqe | 1000 lekë

Në ndërtesën që njihet si Pedagogjikja e Peshkopisë dhe që është edhe sot në qendër të qytetit, mësimi ka filluar në vitin 1948, si për maturën e parë, ashtu edhe për nxënësit e shkollës së Dobrovës, që u bartën në shkollën e re, ku ishte konvikti. Konviktit në shkollën pedagogjike i përkiste kati i nëndheshëm, ose bodrumi, siç i thoshim ne, ku ishte mensa, kuzhina, magazinat, rrobaqepësia dhe disa anekse të tjera përkatëse. Në katin e fundit ishin dhomat e fjetjes. Dy katet e mesit ishin me klasa. Po kjo ndarje ndryshonte se ishte e njëjta drejtori, e njëjta administratë: drejtori i shkollës ishte njëkohësisht dhe drejtor i konviktit. Krahas nxënësve që vinin për të ndjekur shkollën pedagogjike, kishte edhe nxënës konviktorë që ndiqnin shkollën shtatëvjeçare "Demir Gashi", por që jetonin në konviktin e Pedagogjikes. Fjetja nëpër dhoma, ngrënia në mensë, veprimtaritë kulturore dhe artistike bëheshin të përbashkëta si shkollë dhe si konvikt. Kështu, si shembull, një kontingjent jo i vogël i nxënësve që ndiqnin shtatëvjeçaren, vinin nga ish - konvikti i Shupenzës, i cili në vitin mësimor 1953-1954 pushoi së ekzistuari dhe nxënësit i sollën për të jetuar në konviktin e Pedagogjikes në Peshkopi. Një prej këtyre jam edhe unë...

TREGUESI I LËNDËS: TRADITË E NDËRPERË : Qyteti prej guri | Shkolla e Fjalëve | Fillimet |Pedagogjika| Shtylla më e fortë e kombit | "Konviktet e rrugëve"| Programet, tekstet | Artistë e sportistë| Libri letrar | Traditë e ndërperë | Trajtimi

PERSONALITETE TË PEDAGOGJIKES**: Abdi Baleta** | **Safet Zhulali** | **Zenel Sula** | **Nevrez Manjani** | **Bajram Mata** | **Natasha Shehu** | **Hasan Leka** |**Liri Rasha**|**Shaban Sinani** |**Shefqet Hoxha.**





Xhavit Lashi
SHKOLLA PEDAGOGJIKE E PESHKOPISË - Kujtime

Redaktor: Hajri Shehu
ISBN: 978-9928-256-41-6
336 faqe | 1000 leke

Rruga e Arbërit nr. 149
botime

Studjuesi Xhavit Lashi shkruan historinë e arsimit në Dibër: Nga shkolla e parë shqipe në qytetin e Dibrës më 1888; Internati i Dibrës më 1923 dhe i Kastriotit më 1925, Unikja më 1945, Pedagogjikja më 27 shtator 1948 e deri tek filiali i Universitetit të Durrësit në qytetin e Peshkopisë

Pedagogjikja e Peshkopisë, tempull i dijes

Nga **HALIL RAMA**

Shtatëdhjetë vjet më parë, më 27 shtator 1948, në qytetin verilindor të Peshkopisë u hap e para shkollë pedagogjike, e cila për vetë "produktin" e saj (qindra personalitete, deri ministra, gjuhëtarë e profesorë, poetë e shkrimtarë, artistë, diplomatë e gazetarë), me të drejtë njihet si "Universiteti i Dibrës". Një bilanc mbresëlënës për faktin se ajo nxori rreth 2200 kuadro, djem e vajza, që çuan dritën e diturisë dhe kulturën në gjithë krahinat e fshatrat e zonës verilindore të Shqipërisë.

Pikërisht në vigjilje të 70-vjetorit të krijimit, njëri nga ish-nxënësit e shkëlqyër të saj, historiani Xhavit Lashi botoi monografinë "Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë". Kjo është dhurata më e mirë që studjuesi kukësian u bën sot në këtë ditë feste jubilare ish-mësuesve e nxënësve të kësaj shkolle. Autori sjell fakte interesante që plotësojnë historikun e zhvillimit të arsimit: Nga shkolla e parë shqipe në qytetin e Dibrës më 1888; Internati i Dibrës më 1923 dhe i Kastriotit më 1925, Unikja më 1945, Pedagogjikja më 27 shtator 1948 e deri tek filiali i Universitetit të Durrësit në qytetin e Peshkopisë.

PAK HISTORI

Mësojmë nga kjo monografi hapjen e të parës shkollë shqipe në qytetin e Dibrës më 1888 nga patrioti Said Najdeni, vetëm një vit pas hapjes së shkollës së parë shqipe në Korçë. Më tej, mbështetur në burime arkivore në libër gjejmë ngritjen e dy Internateve në Dibër e Kosovë, sipas Shkresës së Ministrisë së Arsimit nr.366, datë 8 shkurt 1923. Internati "Dibra" u vendeos së pari në shtëpinë e Shehat Shehut në Qafë të Pazarit, të marrë me qera dhe në vitin 1925. Ky Interant kaloi në Kastriot të Dibrës. Meritë për këtë kanë drejtorët e nderuar: Haki Sharofi, Ferid Jegeni, Sali Morina, Ahmet Imami, Ferid Imami, Ramadan Sejdini e Rifat Spahiu, si dhe mësuesit: Qemal Drita, Zejnel Zajmi, Ramazan Sefedini, Hafuz Fetah Ajdini, Abdulla Çanga, Muharrem Musa, Refik Shpuza, Fehti Dizdari, Faik Pajuni, Beqir Spahiu, Hydajet Ceka, Shyqyri Daiu, etj.

Jo pa qëllim, autori sjell një listë me emra personalitetesh të përmasave kombëtare që kontribuan në drejtim e në mësimdhënie, për të vijuar me nxënësit që kanë mësuar në Internatin "Dibra", ndër të cilët dëshmorët e atdheut Nazmi Rushiti, Demir Gashi e Tufik Çanga, si dhe personalitetet e mëvonshme të arsimit në Dibër: Selim Alliu, Adem Shehu, Xhavit Hysa, Fehmi Plaku, Haki Alush Kumanova, Munir Shehu etj.

Është pikërisht kjo plejadë që do kontribuonte më vonë, pas çlirimit në hapjen e shkollës Unike të Peshkopisë më 1945 dhe tre vjet më vonë edhe të Pedagogjikes, më 28 shtator 1948.

Ky libër që duhet konsideruar si kontributr i çmuar i autorit Xhavit Lashi në letërsinë dokumentare, në pesë kapitujt e tij sjell një lëndë të pasur me të dhëna për Dibrën e Peshkopinë, Shkollën Pedagogjike dhe rrethanat e hapjes së saj, drejtorët e stafin pedagogjik ndër vite, kujtime nga shkolla, ku një vend të veçantë zënë ish-pedagogjikasit kukësianë në Peshkopi si dhe takimet me rastin e përvjetorëve të shkollës.

PEDAGOGJIKJA NË JUBILEUN E SAJ TË 70-të

Ish mësues dhe nxënës të Shkollës Pedagogjike të Peshkopisë, nga Dibra, Kruja, Mati, Kukësi e Tropoja festojnë sot 70-vjetorin e krijimit të saj. Një jubile i lavdishëm ky, që sjell në kujtesën e tyre 28 shtatorin e vitit 1948 kur Shkolla Pedagogjike e nisi rrugën e saj më 21 nxënës: 13 nga rrethi i Dibrës, 5 nga rrethi i Kukësit dhe 2 nga rrethi i Elbasanit. Në vitet në vazhdim u rrit numri i nxënësve, duke u pranuar në të me bursë si konviktorë ata që vinin nga rrethet e Verilindjes. Asnjë mësues nuk ishte vendas. Mësuesit u emëruan nga Ministria e Arsimit.

Studjuesi Xhavit Lashi, në librin e tij, ndër të tjera nënvizon se "Prej Shkollës Pedagogjike Peshkopi, kanë dalë kuadro që kanë bërë emër të mirë në shkallë rrethesh e në shkallë vendi. Nga bankat e shkollës janë përgatitur jo vetëm mësues e pedagogë të aftë, por dhe kuadro të tjerë që kanë punuar me përkushtim e kompetencë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shkencës e politikës. Prej tyre ka shkencëtarë, profesorë, diplomatë, juristë, artistë, sportistë, gazetarë, drejtues të organeve të pushtetit, të partisë dhe të ekonomisë". Në këtë mori emrash autori ndër të tjerë evidenton ish pedagogjikasit e Peshkopisë (deputetë, diplomatë, profesorë e doktorë shkencash, gjuhëtarë, fizikantë, biologë, shkrimtarë, ushtarakë, artistë, sportistë etj)si: Xhelil Gjoni, Tefta Cami, Lumturie Rexha, Femi Abdiu, Safet Zhulali, Shefqet Hoxha, Sulejman Tomçini, Abdi Baleta, Maxhun Peka, Kamber Faruku, Nuri Abdiu, Shaban Sinani, Muharrem Dezhgiu, Xhafer Martini, Lutfi Hanku, Naim Plaku, Sali Onuzi, Musa Riçku, Liri Rasha.... Këta, si dhe dhjetra emra të tjerë të spikatur që u përgatitën nga ky tempull i dijes vijnë të profilizuar në opinionet, kujtimet essetë e disa bashkëpunëtorëve të autorit Lashi, i cili ka spikatur në përzgjedhjen, redaktimin dhe përfshirjen e tyre në këtë monografi dinjitoze, duke plotësuar kështu historikun e Shkollës Pedagogjike të Peshkopisë si vatër e ndritur e dijes per gjithë zonën verilindore të vendit. Libri ka shumë personazhe, që gjithsesi redaktori i tij, prof.dr.Hajri Shehu nuk i konsideron si personazhe të një libri letraro-artistikë, por më shumë se kaq, pasi sjellin kujtime dhe vlerësime për shkollën e për mësuesit. Kjo edhe për faktin se ato janë tubuar sipas një tematike të caktuar. "Kujtimet vijnë nga autorë të ndryshëm e prandaj krijojnë një mozaik, një thyezim. Dhe është një thyezim shumëngjyrësh. Kësioj, shumë i këndshëm", nënvizon prof,dr.Hajri Shehu.

Autori i kësaj monografie Xhavit Lashi që mban diplomën "shkëlqyer" nga Pedagogjikja e Peshkopisë, më 1975 përfundoi studimet e larta për histori-gjeografi dhe filozofi dhe më pas për dekada të tëra punoi si mësues e në detyra e funksione të rëndësishme në rrethin e Kukësit. Ka botuar dhjetra artikuj studimorë e problemorë si dhe librin "Qarku i Kukësit në rrjedhën historike – ndarja administrative dhe qeverisja vendore".

Në librin e ri "Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë", që u botua pikërisht në vigjilje të 70 vjetorit të krijimit të saj, Xh.Lashi sjell në kujtesën e armatës së mësuesve e nxënësve të saj rrethanat historike në të cilat u ngrit kjo shkollë e konsideruar si "universiteti i Dibrës", si dhe një varg ngjarjesh e peronalitetesh që kanë lënë gjurmë në historinë e arsimit tonë kombëtar. Kjo monografi është produkt i hulumtimeve, evidentimit dhe pasqyrimit të ngjarjeve që lidhen me rritjen ndër vite të këtij tempulli arsimor. Studimet e autorit si dhe rrëfimet e bashkëpunëtorëve të tij flasin për një histori përpjekjesh për të përgatitur kuadrot që do përhapnin dritën e diturisë në zonën verilindore të vendit me një popull të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore, në vullnetin e tij për të qenë i arsimuar e i kulturuar.

Botimi i kësaj monografie paraqet rëndësi të veçantë sidomos për më shumë së 2200 kuadrot që u përgatitën nëpër dyert e këtij tempulli të diturisë, por edhe për vetë qytetarët e Dibrës, Kukësit, Matit, Tropojës e Krujës, pasi në këtë historik të Pedagogjikes së Peshkopisë ata gjejnë edhe një pjesë të historisë së tyre.

Parë nga ky këndvështrim, ky jubile i 70-vjetorit të Pedagogjikes së Peshkopisë dhe monografia e sapobotuar për historikun e saj janë një ngjarje e madhe për historinë e arsimit dhe të kulturës shqiptare.

Një libër që kujton pjesë të jetës sonë

Nga **prof.dr. HAJRI SHEHU**

Libri është edhe historiko-pedagogjik. I një lloji të veçantë. Themi i një lloji të veçantë ngaqë është me kujtime. Por në rreshta e midis rreshtave të këtyre kujtimeve janë edhe historia e kësaj shkolle e pedagogjia në këtë shkollë. Në to ka edhe një psikologji të përbashkët dhe një mënyrë të përbashkët gjykimi.

Autori është Xhavit Lashi. Ish- nxënës i kësaj shkolle. Me një biografi mjaft të gjerë pune. Libri botohet me rastin e 70-vjetorit të hapjes së shkollës. Në pjesën më të madhe, libri ka kujtime dhe vlerësime për shkollën e për mësuesit. Ato janë tubuar sipas një tematike të caktuar. Kujtimet vijnë nga autorë të ndryshëm e prandaj krijojnë një mozaik, një thyezim. Dhe është një thyezim shumëngjyrësh. Kësisoj, shumë i këndshëm.

Libri ka shumë personazhe. Por nuk janë si personazhe të një libri letraro – artistik. Janë më shumë se kaq. Ato nuk kanë nevojë për shkrimtarin, që t'i vërë në një pozicion a në një rol të caktuar. Ato flasin vetë. Për vete dhe për të tjerët. Dhe kësisoj, janë njëherësh edhe shkrimtari.

Janë ish-drejtorët, ish-mësuesit dhe ish-nxënësit e shkollës ata që shkruajnë. Të angazhuar tërësisht në shkollën e tyre e me shkollën e tyre. Ky angazhim shihet dukshëm në të gjitha shkrimet. Kush ka qenë në atë shkollë, e ka parë me sytë e vet.

Sigurisht, vendin e parë në libër e zënë ish-drejtorët e ish-mësuesit e shkollës. Dhe na shpaloset puna e tyre drejtuese e mësimore-edukative. Pa dëshirë përdorëm fjalëzën ish. Në libër rrallë e gjen. Sepse me të drejtë ata janë drejtorët dhe mësuesit tanë të gjithmonshëm. Janë me fjalën e tyre, të cilën e kujtojmë gjithnjë. Dhe kemi mall të jemi në klasë, ulur në banka e të ngrihemi më këmbë kur të hapet dera e të hyjë mësuesi. Dhe janë ata pedagogë e ata drejtorë që na bënë ne mësues. Dhe aradha e mësuesve që vjen nga kjo shkollë në 70 vjet është e madhe. Mbi 2000. Nga kjo aradhë mësuesish, disa patën mundësi të shkonin në punë të tjera të shtetit, si, pushtetarë, politikanë, diplomatë, ushtarakë, gazetarë, letrarë, artistë, sportistë etj. – në libër përmenden me emra. Por të gjithë qenë e janë mësues e me gjykim prej mësuesi. Dhe shkolla, që u formoi këtë gjykim, qe pedagogjikja.

Kur lexon këto kujtime, të thëna me një gjuhë të thjeshtë, por të përzemërt, kupton dhe vlerëson shkollën dhe mësuesit e saj: Ata janë më të mirët mësues që mund të ketë pasur ndonjëherë në aksh shkollë. Kanë qenë, vërtet. Me dije dhe me sjellje. Dhe lexuesi kupton se secili prej këtyre ish-nxënësve ka dashur fort t'u ngjajë atyre. Dhe ish-nxënësit e shprehin tërë mirënjohjen e tyre për ta, për shkollën dhe për qytetin. Po. Edhe për qytetin e Peshkopisë sepse ai qe aleati më i parë i shkollës dhe i tyre.

Shkolla ishte pjesë e qytetit, por pjesë thelbësore e kulturës së tij. Në libër përmenden veprimtari artistike e kulturore e sportive të shkollës për qytetin e me qytetin. Thuhen edhe emrat e atyre nxënësve e nxënseve, që kontribuan me teatrin e tyre, me vallet e me këngët e tyre e me sportet e tyre.

Të gjithë atyre, që shkruajnë, u ka bërë përshtypje ndërtesa e shkollës – më e mira në qytet. U kanë bërë përshtypje hapësirat, të projektuara me mbushullí. U ka bërë përshtypje me të drejtë oborri i pasëm – vendi i fizkulturës e i lojrave me top.

Sot litet për kolegje. Shkolla pedagogjike e Peshkopisë ka qenë kolegj e më shumë se kolegj. Lexoni ç'thonë ish-nxënësit për konviktin, për nëndrejtorët e konviktit, për kujdestarët, për mensën, për mbrëmjet e dëfrimit, për orën gazmore dhe me siguri, do të jeni i një mendjeje me ne.

Nga këto kujtime mëson për vlerat e vërteta të mësimit e të edukimit në këtë shkollë. Brenda programit të një shkolle të mesme me profil mësuesinë shpalosej shkenca. Në të gjitha lëndët. Mësohej edhe muzikë. Nga muzika e pedagogjikes dolën disa muzikantë. Në fizkulturën e universitetit nuk kemi parë më shumë sesa ora e saj në Peshkopi. Nga kjo shkollë e nga këto orë fizkulture dolën sportistë. Për këta ka kujtime të bukura në libër. Po praktika pedagogjike? Ajo bëhej me seriozitetin maksimal. Aty e ndieje veten mësues pa u bërë ende mësues. Në libër ka shumë kujtime të bukura për atë praktikën pedagogjike. Në tërë procesin mësimor, gjithçka ishte me synime të qarta e të sakta. Dhe me metoda të kristalizuara pedagogjike.

Libri është edhe historiko-pedagogjik. I një lloji të veçantë. Themi i një lloji të veçantë ngaqë është me kujtime. Por në rreshta e midis rreshtave të këtyre kujtimeve janë edhe historia e kësaj shkolle e pedagogjia në këtë shkollë. Në to ka edhe një psikologji të përbashkët dhe një mënyrë të përbashkët gjykimi.

Të gjitha shkollat kanë vendin dhe rolin e tyre në sistemin tonë arsimor. Shkolla pedagogjike është e veçantë. E veçanta e saj është se ajo riprodhon vetveten. Ajo shtohet. Ajo zgjerohet. Me mësues, sigurisht. Dhe Viktor Hygo thotë: Dy janë nëpunësit kryesorë të shtetit – nëna dhe mësuesi. Vlerësim më të madh nuk mund të ketë. Diku në këto kujtime thuhet kjo. Dhe kushedi sa të tjerë e kanë lakmuar këtë detyrë. Edhe unë e kam lakmuar.

Një zë më vete në libër janë takimet në përvjetorë. Shumë emocionuese. Aty vijnë përqafimet. Edhe shakatë. Janë shaka të rriturish, por si të ishin të vegjël. Këmbehen fotografi. Dilet në fotografi. Ulen nëpër banka. Si atëherë. Tregohen ngjarje e ndodhi. Këto janë, vërtet të bukurat e takimeve.

Në fund të librit janë fotografitë. Ato janë si një film i bukur dokumentar. Do t'i shohim e do t'i rishohim me kënaqësi e me mall. Ndoshta, edhe me habi. Ndoshta do të themi edhe: A jemi ne?! Sepse motet bëjnë të veten.

Çdo libër është një ngjarje në jetën tonë kulturore. Edhe ky libër do të jetë ngjarje. U tha se ka shumë autorë shkrimesh. Shkrimet janë tubuar mirë. Sipas një organizimi të përzgjedhur. Kujtimet ndjekin e plotësojnë njëri-tjetrin. Dhe kështu zgjerohen e zgjerohen, si ato valëzimet bashkëqendrore (koncentrike) në një liqen të qetë, kur e trazon me një guralec. Dhe në fund sheh shkollën pedagogjike. Përmbajtjes së librit i shkon forma, mënyra e të thënit – tregimi, narracioni. Dhe libri do të zërë me siguri vendin e merituar në botime të këtij lloji në vendin tonë.

Të gjitha kujtimet janë të bukura. Janë të çiltra. Ato më të hershmet – edhe si të moshës adoleshente. Dhe të gjitha vijnë me mirënjohjen për shkollën e për mësuesit e shkollës. Edhe për të tjerë që kanë punuar në shkollë e për shkollën. Këto na i thotë bukur libri i Xhavit Lashit. Dhe mirënjohja shkon edhe për këtë libër e për Xhavitin. Libri na i zgjon edhe më shumë kujtimet e mirënjohjet. Dhe na bën të mendojmë. Dhe na bën të duam të jemi edhe një herë nxënës. Libri na çon te rinia e tek adoleshenca jonë. Na bën të mos i shohim flokët tanë të thinjur.

Koha është armiku më i egër i njeriut. Ajo ikën. Ajo të lë. Ajo nuk të vjen më. Shekspiri ka gjashtë tingëllima (sonete) për tiraninë e kohës. Por takime përvjetorësh dhe libra si ky i Xhavit Lashit na bëjnë që ta mposhtim tiraninë e kohës. Janë përvjetorë e libra që kujtojnë e përkujtojnë. Ata kujtojnë e përkujtojnë pjesë të jetës sonë. Më të bukurën e jetës sonë.

** Titulli është i redaksisë. Marrë nga parathënia e librit "Shkolla pedagogjike e Peshkopisë".*

intervistë

MIMOZA LEKA, dibrania mësuese e shqipes në Gjermani

Bisedoi: **ABDURAHIM ASHIKU**



Zanatin tim të muzikës e kam ushtruar në një fshat të Dibrës, në Zogje dhe Grevë si mësuese e muzikës. Kurse tani e ushtroj në mësimin e gjuhës shqipe nëpërmjet këngës. Unë kam mësuar në shkollën e muzikës të luaj dhe në fizarmonikë, të cilën sot e përdor në shoqërimin e këngëve për fëmijë. Ne jemi një familje mësuesësh, ku kemi gjithsej 6 mësues të lëndëve të ndryshme në familje. Mësuesja jonë më e shquar është Bardhyle Leka (bashkëshortja e xhaxhait tim, Ramizit), mësuese e shquar e shkollës "Demir Gashi", që ka mësuar dhe edukuar sa e sa breza në Dibër.

Mimoza Leka: Kryesisht nxënësit e mi shqiptarë vijnë nga Kosova, më pak nxënës kam nga Maqedonia dhe shumë pak nxënës nga Shqipëria. Fëmijët nga Shqipëria, më saktë prindërit e tyre, nuk tregojnë aspak interes për mësimin e gjuhës amtare dhe ruajtjen e identitetit të tyre.

Ashiku: Si quheni dhe nga vini?

Leka: Emri im është Mimoza Leka dhe vij nga Dibra. U largova nga Dibra në moshën 13 vjeç ku unë fitova konkursin e liceut artistik te shkolla artistike „Onufri" në Elbasan dhe aty fillova shkollën e mesme të muzikës për degën „Kanto".

Më pas po në Elbasan fillova studimet te Instituti "Aleksandër Xhuvani" për degën "Cikli i Ulët".

Në vitet 1996-97 filluan trazirat në Shqipëri dhe unë vendosa së bashku me familjen time të largohem nga Shqipëria dhe ashtu dhe bëmë. Në momentin e largimit kisha dy fëmijë, dy vajza në moshën 7 vjeç dhe 2 vjeç.

Ashiku: Cila është rruga juaj në Gjermani?

Leka: Si fillim me vendimin e Ministrisë së Migracionit (Bundesamt), unë vendosem në një qytet që quhej Gelsenkirchen. Këtu filloi jeta jonë si refugjatë. Pra unë me familjen time kemi bërë në shtator të vitit 1998 kërkesë për azil në Gjermani. Siç e dimë, në atë kohë edhe pse Shqipëria kishte probleme civile, megjithatë ne shqiptarët e Shqipërisë nuk kishim arsye politike për të fituar azil politik. Në këtë pikëpamje rruga ime për të fituar lejen e qëndrimit në Gjermani ka qenë shumë e gjatë dhe shumë e vështirë dhe më ka kushtuar 9 vjet e gjysmë. Në vitin 2007 kam fituar për herë të parë lejen e qëndrimit dhe kam vizituar për herë të parë Shqipërinë pas 9 vjet e gjysmë.

Ashiku: Me çfarë jeni marre gjatë kësaj kohe që s`kishit leje qëndrimi në Gjermani?

Leka: Unë përfitova nga koha si e papunë që isha në fillim dhe mësova në mënyre intensive gjuhën gjermane. Domosdoshmëria e mësimit të gjuhës bëhet akoma më e madhe, kur ke dhe fëmijë në shkollë si puna ime atëherë me vajzën e madhe.

Pasi unë dhashë provimet dhe u pajisa me certifikatën e një niveli shumë të lartë të gjuhës gjermane (C2), punësohem për herë të parë në qytetin që unë jetoja në një organizatë grash, ku unë fillova të jap mësim gjermanisht për gratë që shkonin të kërkonin ndihmë në këtë organizatë. Këtu është zanafilla e profesionit tim në Gjermani. Pas shumë orësh praktike dhe kualifikimesh, pajisem në vitin 2008 me një diplomë nga ministria e Migracionit si Docente për të dhënë mësim gjermanisht në shkolla të ndryshme, ku bëhen kurse integrimi për të huaj, që vijnë nga vende të ndryshme, ndër to kam pasur dhe refugjatë shqiptarë si nxënës.

Vazhdova të jap mësim gjermanisht për vite me radhë derisa në vitin 2011 konkurrova në Bergisch Gladbach, një qytet në afërsi të Këlnit për tu punësuar si mësuese e mësimit plotësues shqip në këtë qytet dhe në rrethinë. Këtë konkurs të këtij vendi pune unë e fitova dhe kështu në gusht të vitit 2011 fillova punën si mësuese e gjuhës shqipe këtu në diasporë. Tek unë vijnë fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e dhjetë, ose deri në klasën e nëntë gjimnaz. Mësimi vizitohet nga çdo nxënës një herë në javë dhe ky mësim është i inkuadruar në shkollat e mësimit të rregullt, vetëm që ne e bëjmë mësimin kryesisht pasdite, pasi nxënësit kanë mbaruar mësimin e rregullt në shkollat gjermane.

Paralel me këtë punë unë bëj dhe punën si mësuese e gjuhës gjermane. Pra për momentin unë i ushtroj të dy punët e mija.

Ashiku: Nga çfarë vendesh vijnë nxënësit që juve ju jepni mësim shqip?

Leka: Kryesisht nxënësit e mi shqiptarë vijnë nga Kosova, më pak nxënës kam nga Maqedonia dhe shumë pak nxënës nga Shqipëria. Fëmijët nga Shqipëria , më saktë prindërit e tyre, nuk tregojnë aspak interes për mësimin e gjuhës amtare dhe ruajtjen e identitetit të tyre.

Ashiku: Ne njihemi që në takimin e seminarit të Prishtinës para 7 viteve, pastaj jemi takuar po në seminar ne Korçë para 3 viteve dhe tani këtu në Tiranë. Çfarë ka ndryshuar te ju gjatë këtyre viteve?

Leka: që në takimin tonë të parë në Prishtinë, te dytin në Korçë dhe i treti tani në Tiranë, që është një kohë 7-vjeçare, takime këto që i përkasin seminarit mbarëkombëtar të mësuesve të diasporës për mësimin plotësues në gjuhën shqipe, e deri tani unë kam fituar një pjekuri më të madhe në profesionin tim si mësuese e mësimit plotësues në diasporë. Mësimdhënia e gjuhës shqipe në diasporë ndryshon shumë nga ajo këtu në vendlindje. Një nxënës vjen në mësim te unë vetëm një herë në javë më 3 orë mësimi, në një kohë që në vendlindje atij i duhet ta vizitojë atë përditë . Plus asaj klasat i kemi shumë kolektive, nga klasa e parë deri në të katërtën, e pesta deri në të shtatën dhe nga e teta deri në të dhjetën.

Ne mësueset në Gjermani, pas punësimit kemi një kualifikim 6- mujor të detyruar, në të cilin mësojmë më konkretisht metodat e mësimdhënies në diasporë. Ne jemi të punësuar nga organet gjermane dhe paguhemi po nga to.



Përveç kësaj dhe seminaret që organizohen nga zoti Nuhi Gashi në vende të ndryshme të vendlindjes janë për tu lavdëruar dhe na shërbejnë goxha në punën tonë. Shkëmbimi i përvojave me mësues të shteteve të tjera janë një vlerë shumë e madhe për ne.

Ashiku: Ju përmendet mbiemrin tuaj Leka. Kush janë Leket e tu?

Leka: Leket e mi janë në radhë të parë dy prindërit e mi, Esma dhe Sami Leka, për të cilët jam shumë krenarë sepse me punën e tyre të palodhur dhe në kushte të vështira të asaj kohe, na kanë shkolluar me arsim të lartë dhe na kanë bërë këto që jemi neve fëmijëve të tyre.

Së dyti familja Leka ka dy burra që i njeh shumë mire Dibra, janë dy xhaxhallarët e mi: Nazif Leka, që fatkeqësisht nuk jeton me dhe Ramiz Leka, që shquhen për punën e tyre si intelektualë të palodhur të Dibrës dhe kanë dhënë shumë për Dibrën.

Ramizi jeton në Tiranë me djalin e tij të dytë Abazin dhe familjen e tij.

Së treti krenaria e familjes Leka janë pasardhësit e vëllezërve Leka. Ndër to mund të përmend: Baftie Leka, një ndër studentet e para që mbaroi në atë kohë shkollën e partisë, Barie Leka, një ndër oficeret e para dhe të devotshme të Dibrës, e cila ka kryer detyra shumë të larta në profesionin e saj, Zihni Leka dhe ky një ekonomist shumë i njohur në Dibër.

Ne jemi dhe tre muzikantë në familje, dy klarinetistë, Abaz dhe Elton Leka, të cilët njihen shumë në Dibrën tonë të dashur si dhe unë që mbarova në Elbasan për Kanto.

Zanatin tim të muzikës e kam ushtruar në një fshat të Dibrës, në Zogje dhe Grevë si mësuese e muzikës. Kurse tani e ushtroj në mësimin e gjuhës shqipe nëpërmjet këngës. Unë kam mësuar në shkollën e muzikës të luaj dhe në fizarmonikë, të cilën sot e përdor në shoqërimin e këngëve për fëmijë.

Ne jemi një familje mësuesësh, ku kemi gjithsej 6 mësues të lëndëve të ndryshme në familje. Mësuesja jonë më e shquar është Bardhyle Leka (bashkëshortja e xhaxhait tim, Ramizit), mësuese e shquar e shkollës "Demir Gashi", që ka mësuar dhe edukuar sa e sa breza në Dibër.

Ashiku: Çfarë mesazhi ke për dibranët?

Leka: E para jam shumë krenare që jam dibrane dhe këtë ndjenjë e edukoj edhe tek fëmijët e mi edhe pse nuk e kanë përjetuar Dibrën sepse djali më ka lindur në Gjermani dhe dy vajzat janë rritur në Gjermani. Unë i kam dërguar fëmijët në Dibër kur kemi ardhur me pushime në Shqipëri për t'ju treguar vendin e bukur ku është rritur nëna e tyre.

Dibranët kanë cilësi shumë të larta siç është besa dhe mbajtja e fjalës. Ato shquhen si njerëz të traditës dhe nga mikpritja dhe bujaria është pjesë e çdo familje dibrane.

Uroj që dibranët t'i ruajnë këto cilësi të larta.

Rruga e Arbërit nr. 149

kujtime

Në fund të semestrit më nxorën në grupin e nxënësve të dalluar të shkollës që do të shkonin për të festuar Vitin e Ri 1959 tek Pallati i Pionierëve në Tiranë...

Duke kujtuar Pedagogjiken e Peshkopisë

Nga prof.dr**. Bajram XHAFA**

(vijon nga numri i kaluar)

Në fund të semestrit më nxorën në grupin e nxënësve të dalluar të shkollës që do të shkonin për të festuar Vitin e Ri 1959 tek Pallati i Pionierëve në Tiranë së bashku me udhëheqësin e partisë. Ishte një praktikë që bëhej çdo vit të ri. Për atë vit, nga rrethi i Dibrës u caktuan nga Shkolla 7 vjeçare "Demir Gashi" katër nxënës: për dy klasat e 7-ta, Bashkim Lleshi e Xhelal Xhika; për klasat e 6-ta, Bajram Xhafa, për klasat e 5-ta, Zymbyle Zhulali dhe, Garip Dani për shkollën e Dovalanit. Udhëheqës i grupit të pionierëve të Dibrës ishte Hysen Lushi, një mësues i ri nga Boroviani. Flinim në hotel "Durrësi", një ndërtesë e vjetër dykatëshe aty ku sot është 15 katëshi. Kundruall saj ishte një kishë ortodokse me këmbanat e saj e cila më vonë u shemb për t'ia lënë vendin Hotelit 15 katësh. Në vitin 1967 kur tashmë isha student dhe në të gjithë vendin u mbyllën kishat dhe xhamijat, në vend të saj u ngrit një tjetër kishë ortodokse e re edhe më e madhe se ajo në rrugën e Kavajës, ku është edhe sot, e madjemë pas u zgjerua një "kompleks kishtar". Kjo nuk shkonte në linjën e Fjalës së 6 shkurtit 1967 të sh. Enver, por thuhej se e ndërtuan për ambasadat e huaja. Nuk na dukej bindëse por edhe nuk i dinim punët e fesë. Mbase ata luteshin alla "grekçe".

Në mbrëmjen e Natës së vitit të ri, Enver Hoxha erdhi dhe festoi bashkë me ne. Na dhanë edhe nga një pako me dhurata, nga udhëheqësi, ndër ta edhe një çantë librash, të kuqe. E flaka tutje atë torbën e librave prej pëlhure të hollë të fshatit me ushkurin (baçin) që e hidhja krahaqafë. Tani në shkollë do të shkoja me çantë librash në dorë siç i ka hije një shkollari të vërtetë.

Rrezet e forta të verës i lanë vendin diellit të ëmbël të vjeshtës. Ushqimi i mirë, pushimi i trupit, jeta me regjim sollën dryshime edhe në pamjen e jashtme. Faqet e hequra me lëkurë të pjekur filluan të mbushen e të çelen, madje të marrin një të kuq si ai i mollës, gjitë ndriçim, jo si disa që u thonë kuqo. Pas afro 60 vjetësh m'i përmendi në një takim të rastit në Shkodër një ish shok klase i asaj kohe, të cilit nuk i ishin shqitur nga kujtesa. Përtëritje, rilindje?

Vitin tjetër vazhdova klasën VII. E ruajta ritmin. Algjebrën dhe gjeometrinë na i bënte mësues Xhili (Kulejmani). Edhe me atë e kisha "grurë". Lëndët matematike më vinin të lehta. Problem kisha të lexuarit e librave, lexoja ngadalë, 25-30 faqe në orë dhe me sforco. Kjo më brengoste. Në klasën tonë, Esat Musliu nga Stebleva, rrinte me romane në dorë dhe qysh atëherë numëronte mbi 25 romane të lexuara. Mësonte mirë dhe ishte i sjellshëm, nuk sugjestionohej para mësuesit si puna ime. Njëherë mësuesi i gjuhës e nxorri para klasës të qendrojë në këmbë, si dënim pse bëri zhurmë. Duke qenë pranë dritares, atij iu hapen horizonte të reja pamjeje dhe mendja i mori arratinë. Harroi se ku ishte. Ndërsa vazhdonte mësimi, ai papritmas shpërtheu në të qeshura me zë të lartë. T'iu lëshua zotni Dini. Tru peshk, tru krap (edhe pse krapi në Dibër nuk kishte mdonjë popullaritet) dhe e kapi fort tek basetat me dy gishtat e dorës duke ia tërhequr lartë. Përjashta! Dhe e tërhoqi deri tek dera me qafën shtrembëruar në 45 gradë pjerrtësi. Por atij nuk i bëhej shumë vonë dhe i merrte dhe i komentonte gjërat me gas. Më pas e pyeta se pse qeshi. Larg në rrugë po shihja një makinë që sipër në karroceri disa njerëz po luanin me një qen i cili ngrihej mbi dy këmbët e pasme, qendronte drejt si njeri dhe bënte gjithëfarë akrobacirash. Nuk di ç'bëri qeni që e bëri atë, dhe pastaj edhe neve, të shkuleshim së qeshuri. Esati ishte i talentuar dhe kishte premisa për të gjitha llojet e arteve. Vazhdoi Liceun Artistik në Tiranë për pikturë, pastaj Institutin e Arteve dhe u bë regjisor i suksesshëm filmash.

NË SHTËPINË TONË TË PËRBASHKËT

Konvikti ishte shtëpia jonë në kuptimin e plotë të fjalës. Për të fjetur më caktuan në dhomën nr. 5. Krevatet prej druri, tip marinari, poshtë e lartë. Të vegjëlit poshtë, më të mëdhenjtë, lartë. Dyshekë pambuku dhe nga dy jorgana pambuku, kur vinte dimri. Flinim të përzjerë me nxënës të pedagogjikes. Më takoi që lart të ishte një nxënës i klasës III pedagogjike, Hasan Leka, një djalosh fisnik, i urtë e gojëmbël. Me mua sillej me një familjaritet të natyrshëm, më pyeste e më këshillonte me një interesim tamam si e vëllait të madh. Mbase kështu sillej edhe me të tjerët, por mua më dukej "i imi". Me pas morëm rrugë të ndryshme. Shiheshim rrallë, rastësisht. Ndiqnim nga larg ecurinë e njëri tjetrit. Ishte i kulturuar dhe me prirje letrare. E dëgjonin me vemendje. Më pas lëvroi në fushën e letrave. Para ca muajsh, ndërsa po lexoja një vjershë në formë elegjie të Mevdud Bucit, mësova se kishte vdekur. Sikur m'u ndal fryma. E lexova edhe njëherë, edhe njëherë, se mos ishte ndonjë alegori. Nuk desha ta besoja. Paskeshim qenë miq, thashë. Edhe fort besa. Të vjetër. Pse nuk ia thamë njëri tjetrit ndonjëherë?





Dibranët rezervohen të thonë fjalë të mëdha e të bëjnë deklarata miqësie.

Në konvikt standardi ishte: Larje e trupit, që më së shumti bëhej tek llixhat, ndërrimi i të bredshmeve dhe i çarçafeve, njëherë në dy javë. Çdo dy javë na shpinin në kinemá, a më rrallë. Por filmat që shihja nuk i kuptoja sepse nuk arrija të lexoja titrat. Kjo më mundonte shumë kur dëgjoja të tjerët të bisedonin për përmbajtjen e tyre. Në klasën VII e më pas, u bëra "ekspert" filmash dhe artistësh. Mësuesi kujdestar, që ishte jabanxhi dhe flinte në një dhomë të vogël brenda shkollës, më tha një ditë të shkoja në dhomën e tij e të fikja radion, të cilën e kishte harruar të ndezur. Nuk di ta fik, i them dhe u skuqa në fytyrë. Dikush desh të qeshë, por mësuesi shpejt nisi një "qytetar" dhe unë e kalova ngerçin. Një kolegut tim në Universitetin e Shkodrës, vonë, shumë vonë, në prag të pensionit tim i kam treguar, dhe jo pa hezitim, se për herë të parë në telefon kam folur në vitin e katërt të universitetit, pas një thirrjeje telefonike që më kishte bërë im vëlla nga Kukësi, ku ai kishte filluar punën në Uzinë. Në Shkodër këto gjëra nuk guxon t'i tregosh, pa llogaritur të merresh nëpër gojë. Një miku im në Shkodër, me origjinë nga Gjakova më tregonte se gjakovarët e kanë edhe më të fortë këtë "punën e katundarit" dhe më tregoi një anekdotë. M'asht m□rzit vajza, tha gjakovari. – Pse, e pyeti miku i tij, a ta ka marr□ ndonji magjup. – Jo bre, jo. – Ndonji shkja? – Jo, jo. – Ndonji ashkali, a...- Jo bre, jo, ma keq. – Po kush pra, ndonji katundar? – Katundar bre. A ka ma keq ma?

Në konvikt shumica e nxënësve kishin blerë nga një palë nallane të cilat i përdornin për higjienën e mëngjesit dhe të darkës para se të binim me fjetë. Dhe të dëgjoje pastaj trokitjen e tyre mbi pllakat e korridoreve dhe shkallëve deri poshtë me një zhurmë që vinte në ulje, dekreshndo dhe ritëm të ç'akorduar, si kuajt mbi kalldrëm. Në fshat nallanet konsideroheshin si zakon qyteti, si ato sheherlijet që shkonin me nallane nëpër sokak. Pantoflat janë një "mirëqenie" që erdhi nga fundi i të '60-ve. Ishte gjë e bukur të shihje këta djem e vajza fshati kur, në mëngjes dhe darkë zbrisnin drejt çezmave dhe pastaj ngjisnin shkallët si në një pasarelë, me furçë dhëmbësh, kolinoz e peshqir hedhur mbi sup me njëfarë tangarlleku. Edhe unë isha njëri nga ata.

Zilja e fundit lajmëronte pushimin, por, të shtrirë mbi dyshek fillonin muhabetet, debatet, diskutimet. Më së shumti për letërsinë, për autorë e personazhe të ndryshëm, kryesisht nga ato "jashtë klase e jashtë shkolle". Flisnin edhe për autorë të ndaluar, për Pader Gjergj Fishtën e për Lahutën e Malësisë. Dëgjoja komente për Shekspirin e Hamletin, Tolstoin e Ana Kareninën që u hodh nën shinat e trenit, Demonin e Lermontovit, Balzakun, Servatesin, Majakovskin dhe Eseninin. Këta të fundit i recitonin shumë. Ndërsa bëmat dhe thënmat e Don Kishotit e të Sanço Panços disa i përdornin si batuta; Arsyeja e mos arsyes sime, m'a trullos aq shumë arsyen time, sa me arsye mund të arsyetoj se…Pordhi kali në derë të hanit. Por edhe për Khajamin, që ishte shumë popullor dhe recitohej me endje, Sadiun e për autorë të ndaluar e libra të verdhë. Citonin e recitonin pjesë me komente gjithfarëlloji. Flisnin edhe për jetë shkenctarësh, për sportin dhe sportistët, dhe, të mos harrojmë, edhe për vajzat. Pak thashetheme, por jo vulgaritete. Interesa kulturore të shumanëshme. I strukur poshtë në krevatim tim, ngrija veshët dhe dëgjoja plotë kureshtje. Më hapej një dritare e madhe, si atëherë kur kullosja mushkën natën dhe më shpalosej hapësira e pafund e plot mister e qiellit mbushur me yje. Një nxitje për lexim, për libra.

Lakoheshin në këto diskutime dhe emra nxënësish për zotësinë e tyre, për nivele të larta njohurish, si lexues librash, që dinin përmendësh shumë vargje. Kryesisht nga matura, por edhe të tjerë, sipas viteve. Abdi Baleta nga Guri i Bardhë-Mati vlerësohej si autoritet. Më pas punoi në sektorin e ministrisë së Jashtme deri ambasador i Shqipërisë në OKB, politolog i shquar dhe themelues i nacionalizmit bashkëkohor shqiptar. Fran Lena nga zona e Ulzës-Mat, student i mirë dhe futbollist. Tefta Cami, që më vonë arriti të bëhet ministrja më jetëgjatë e Arsimit dhe e Kulturës dhe një dorë vajzash të tjera si Fanije Hoxha, Bukurije Lleshi (më vonë deputete), Sabiré Cami, Sanije Zeneli-Sula (që u martua me drejtorin e shkollës), Kumrije Lahi, Selvie Lusha që u dashurua dhe më pas u martua me Fran Lenën. Kjo e fundit bëri bujë atëherë sepse paskesh qenë e fejuar qysh në djep dhe se mori një person të fesë tjetër. Pavarësisht një "drame", ajo nuk hoqi dorë nga fati që zgjodhi dhe ata shkuan jetën bashkë. Tani jetojnë në Paris. Lakohej për zotësi emri i Xhelil Gjonit që kish mbaruar një vit më parë, tani student në B. S. dhe që më vonë arriti deri në majat më të larta të nomenklaturës shtetërore. Nuk po zgjatem me pedagogjikas të tjerë që bënë emër dhe karrierë më vonë në shkallët e administratës shtetërore, dhe nuk janë pak, sepse ajo kërkon një studim më vete.

USHQIMI

Mburrej njëri me djalin e tij që kishte shkuar ushtar se atje në ushtri shumë shpejt ai paskesh bërë karrierë dhe kishte marrë gradën më të lartë. Mos e kanë graduar kapter, pyeti njëri. Jo, thoshte i ati, është më i madh. Nëntoger? Jo përsëriste ai. Kështu vazhdoi muhabeti me jerarkinë e gradave deri tek gjenerali. I ati u thoshte se djali i tij ishte aq i madh në pozitë sa që i gjithë reparti ishte i detyruar të paraqitej e të bënte temená para tij tri herë në ditë, që nga i vogli e deri tek më i madhi. Atëherë qenka kuzhinier, tha dikush. Hë more se, tamam ashtu është. Mbase nuk ishte nevoja për gjithë këtë hyrje, por në instancë të fundit, gjithë luftat për gojën bëhen, për bukën. Aty mblidheshim tre herë në ditë edhe né, ku bëhej "lufta e madhe"…në mencë.

Në klasifikimin e normave të ushqimit, konviktet e shkollave të mesme gëzonin normën 2, e barabartë me 59 lekë në ditë. Tavolinat e mencës ishin për tetë vetë me nga një përgjegjës. Tavolina jonë kishte përgjegjegjës kishte Zef Mrishën, maturant nga Nikaj Mërturi, që doli edhe kryetar i këshillit të konviktit. Mbaj mend se në tavolinën tonë ishte edhe Dodë Progni, klasa III, po nga Nikaj Mërturi. Larmia gjeografike e pasuronte gjeografinë dhe etnografinë tonë. Për çdo tavolinë llogaritej nga një bukë (GRURI) dy kilogramshe. Në mëngjes, bukë e qumësht; në drekë dy gjellë, mish me lëng ose turli (domate fërguar me qepë, speca) dhe makarona; ditën tjetër kishte kishte fasule dhe pilaf. Ky ishte alternimi i zakonshëm. Në darkë nga një gjellë. Si rregull, gjellë me mish tre ditë në javë, tre herë në javë fruta, dhe të dielën në drekë edhe ëmbëlsirë: biskota me sherbet, që Shukri i bënte shumë të shijshme, hallvë, ashtu siç dijnë ta bëjnë dibranët dhe, ajo mrekullia vetë, kadaif (Stambolli?). Darka e së dielës përcillej me bukë e çaj.

Njëherë na sollën mish derri. Nuk di se si do ta ketë mundur ta gatuante Shukriu, por atë ditë e paten festë mirditorët, të Nikaj Mërturit që ishin katolikë dhe Gjorçeja, ortodoks nga Kërçishti. Pak, shumë pak hëngrën nga myslimanët. Ata morën bukën në dorë, blenë nga një hallvë pesë lekshe (sham i thonë në Shkodër) dhe kaluan vaktin.

A ngopeshim? Racioni ishte optimal. Uria shekullore nuk mund të kapërcehej si një shkurre e ulët, megjithëse Shqipëria mbeti më shkurre se ç'qe më parë. Shokët e fshatit më pyesnin, për kureshtje a për zili, s'mund ta them. A u del buka? Po, u thosha, megjithëse nuk isha krejt i sinqertë. Sepse edhe ata nuk ishin të sinqertë; e bënin nga marazi nga që unë tashmë kisha ra në bukë gruri e në makaronat të qeverisë.

Përpara ngrënies së çdo vakti bëhej rreshtimi. Kryetari këshhillit të konviktit, që zgjidhej njëri nga maturantët e shkollës dhe disa anëtarë të këshillit, delnin në krye. Pas kontrollit të dhomave të fjetjes nga dy anëtarë të këshillit, thirreshin emrat atyre që nuk kishin rregulluar shtratin. Një ditë më doli emri edhe mua. Mbiemri im i tërhoqi vemendjen një anëtari të këshillit, Abdi Baletës, maturant. Ç'farë e ke Mersim Xhafën, më pyeti. Është mixha im, i thashë dhe u nisa me vrap të rregulloj krevatin për të kapur kohën, mos më ikën mëngjesi.

Kur shkova në shtëpi i tregova babës. Oo, qenka djali i Can Buletës, tha i gëzuar. Me babën e tij jemi byrazera. Kemi qenë ushtarë bashkë në kohë të Zogut, në një çadër (3 muaj më duket) dhe, kur luanim qiraxhillëkun me Tiranën, shtëpinë e tij në Gur' të Bardhë e kishim si stacion. Ktheheshim për pushim, haja ndonji tas me pshesh a bukë me gjizë me tlynë (fërguar) dhe vazhdonim rrugën kah Qafa e Murrizës, Shkalla e Tujanit e tek Rrapi i Treshit në Tiranë. Ose në kthim nga Tirana në Dibër. Mbetëm miq. Qoftë për atë kohë! I thuaj, më ka thanë baba hajde një natë dhe hajdeni bashkë.

POLITEKNIKUMI "7 NËNTOR": NGRITJA DHE...

Gjërat po ecnin në rrjedhën normale. Në mbarim të klasës VII vinte lutja për shkollën e mesme. Shkolla të preferuara atëherë ishin Teknikumi Mjeksor, Politeknikumi "7 Nëntor" dhe Teknikumi i Ndërtimit, të gjitha në Tiranë. Plan bursash kishte edhe në pedagogjiken e Peshkopisë, të Shkodrës, Gjimnazin e Shkodrës, mbase të Kukësit. Baba më kishte ushqyer shumë punën e mekanikut sepse, çdo javë që delte në pazarin e Shupenzës, shihte me lakmi punën e një llamarinisti a kallajxhiu nga Përmeti të quajtur Taqi, që baba e gradonte në mekanik. Taqi dinte të grinte pare katundarësh me kallaisjet e riparimet e tij dhe, shtrohej pastaj të hante drekë, mish me fasule në "Restaurant-in" e Shupenzës. Taqi kishte standard. Për mësuesi mbaj mend se nuk kam bërë kërkesë. Sepse gjithë propabiliteti aty ishte fshati, i cili kishte të sigurtë baltën dhe kandilin. Ishte viti 1960.

Shkolla e mesme, kuptohet, edhe bursa, më doli në Politeknikumin "7 Nëntori" në Tiranë. Biletat e autobusit për Tiranë i porosiste seksioni i arsimit. Shkova vetë pa patur nevojë për shoqërues. Në rrugët e Tiranës kishte disa shigjeta që të drejtonin për tek shkolla. Në të djathtë të vendit ku më pas u ngrit një pallat i njohur si "Flora", një shigjetë të drejtonte kah "Rruga e Shkodrës", kështu quhej atëherë, kaloje Burgun e Vjetër, ktheje në këndë të drejtë djathtas për t'u futur nëpërmjet një dere nga prapa (nga ofiçina) në "mbretërinë" e Politeknikumit. Porta e sotme e Shkollës së Fulcit është shumë më e vonë, ndoshta pas 1990-ës.

Politeknikumi kishte tri degë: Elektrike, Mekanike dhe Minerale. Secila kishte një godinë më vete. Ishte edhe Shkolla e Rezervave të Punës me afat 2 vjeçar; kishte ofiçinën me repartet e saj model (farkëtari, axhusteri) – një kompleks më vete; dy ndërtesa të mëdha për konvikte; mencën e madhe njëkatëshe në mes. E gjitha rrethuar me mure të larta. Brenda saj kishte edhe fusha sportive për orët e kulturës fizike, rrugë që lidhnin mbientet, lulishte dhe një kioskë me fletore, lapsa, gurabije 5 lekshe (ingranazhe) etj. Ishte shkollë klasi. Ndjehej e gjallë fryma dhe kërkesa e Shkollës Teknike Amerikane të Fulcit. Në sallonin e katit të dytë të degës Elektrike, endé ishte një pllakë mermeri i zi me emrat e skalitur të nxënësve excellent (të shkëlqyer) ndër vite. Besoj se duhet të jetë hequr më vonë.

Me shumë mundim u regjistrova në degën Mekanike, klasa I D. Regjistrimi është histori më vete, një aventurë. Të Veriut ishin të detinuar për degën Minerale. Pas nja tre ditësh më takuan edhe me drejtorin Gjergji Canco. Sapo ishte kthyer nga Rumania, ku kishte qenë për pushime, vend ku dikur para çlirimit, kishte kryer studimet për kimi. Ishte një burrë i rëndë, i shëndoshë, me bark, me autoritet dhe prestigj të lartë. I vetmi në Republikë nga drejtorët e shkollave të mesme që kishte makinë në dispozicion, një xhip. Edhe ai nuk lëshoi pe, të regjistrohesh në Minerale më tha, atje është vend për ty. Dola nga drejtori por unë e zgjata regjistrimin derisa ia arrita Mekanikes. Puna edhe priste sepse shkollat u shtynë 12 ditë për shkak të të nxehtit. Menca ishte e hapur dhe, derisa të fillonte mësimi, vërdallisu nëpër Tiranë.

Me shkollën u ambientova shpejt. Me orarin dhe disiplinën isha i mësuar. Mësimet nuk i kisha problem. Shpejt u mësuam me njëri tjetrin. Zura shok e miq nga Berati, Korça, që flinim në një dhomë. Midis tyre fillova të marr "sifatet" e tyre, të flas si ata. "O po qy, nashti, qysh do t'i bëhet" etj. Kishte ambicje, dhe xhelozira, por të natyrshe e pa probleme. Kishte edhe solidaritet. Klasa C dhe D kishin vetëm djem. Kjo e bënte grupin më të përkorë. Më duket se A dhe B kishin ndopak vajza, por ato bënin mësim tek dega Elektrike e nuk njiheshim.

Në shkollë bëheshin të forta matematika, fizika dhe kimia. Në klasën II shtoheshin lendët teknike. Rëndësi kishte edhe vizatimi teknik, dy vite me 15 detyra në vitin e parë. Në katin III kishte një sallë mbushur me detale makinash të hedhura përtokë, të cilat përzgjidheshin për t'i projektuar në tre pamjet në formatin A4. Detalet duheshin projektuar në tre pamje dhe pastaj në aksonometri. Shpesh detalet jepeshin në dy pamje dhe duhej gjetur i treti. Ishte, në s'gaboj, njëlloj gjeometrie deskriptive.

Profesorët ishin të përgatitur dhe kërkues. Lëndët teknike i jepnin inxinierë të zottë. Por edhe lëndët e tjera, jo teknike, folklor-letërsi, histori e re, fizikë etj. Në letërsi bënim edhe Tolstoin dhe libërthin e tij "Robi i Kaukazit" që më pëlqente shumë. Pastaj "Ata nuk ishin vetëm" të Sterio Spasses. Një profesori, që ishte inxhinier i kishin vënë nofkën "Torre" sepse gjatë shpjegimit të temës me bullona, vida e torre, zilja e mbarimit të mësimit e zuri tek rrokja e parë e fjalës së fundit "to". *(vijon në faqen....)*

Duke kujtuar Pedagogjiken e Peshkopisë

(vijon nga faqja ...)

Ai ndaloi shpjegimin dhe e la fjalën përgjysëm. Rrokjen tjetër "rre" e plotësoi orën tjetër të mësimit dhe vazhdoi më tej. Kështu i mbeti "Torre", profesor Torre-ja.

Një ditë në javë, ditën e shtunë, e kishim praktikë në ofiçinë. Semestrin I e bënim në repartin e farkëtarisë. Mbaj mend se çdo nxënës arriti të bëjë një çekiç dhe një palë pinca, të pa përfunduara. Për t'i dhënë formë detalit, aty përdornim farkën, por edhe çekiçin pneumatik. Kur mbaronim orarin e punës në orën 1. oo a 1. 5, sidomos ditën kur kishim radhën e pastrimit të repartit, bëheshim të tillë që nuk kishte autoklavë që të na e hiqte blozën që na kishte depërtuar në grykë, në flegrat e hundës, në rrobat dhe në lëkurë.

INTERMEXO

Njëherë instruktori i praktikës, një Uran a Orhan m'u drejtua në të folmen e zonës time për lezet, si për të më "përqeshur": "do t'marr nji gjur dhe do t'ta çajë krajt" (kryet, kokën). Tani pas afro 60 vjetësh, kjo shprehje e thënë për humor më bëri të mendohem emri "krajt"ë anën perëndimore të Shkodrës shtrihet malësia e Krajës. Kraja e Shkodrës i kanë thënë, tani është pjesë e aneksuar e Malit të Zi. Kraja është emërtesë vendi, toponim dhe shpesh gjahëtarët i mbahen tezës se prejardhjen e ka nga sllavishtja kraj, që do të fund. Fund i kujt qenka Kraja? "Fund" i Malit të Zi? Mali i Zi është krijuar shumë vonë, në fund të shek. XIX. Kur ka ekzistuar Kraja Shqiptare, Mali të Zi nuk ka pasë as për emër, as si "bërthamë gjenetike" mbë faqe të dheut. Se, Dhimitër Pasko nga Pogradeci shkruan: "Mal i Zi / ja un, / ja ti! / Po un – jo ti, / se jam këtu kur s'kish njeri / dhe as kufi / as fqinjëri. / Un jam këtu kur Mal i Zi / Më Shumadi, / Me Dallmati / Sa mban e gjitha Shqeheri / Ish Iliri! / Kur nga një det në tjetrin det / Isha Zot vet! / Se jam këtu nga moti / kur vet zoti / e bëri fushën fushë / e malin mal / Un jam këtu / e do të jem / den baba den / Sa mali të bëhet hi / E hiri mal përsëri!"

Kraja është një krahinë shqiptare 100%. Nuk ka se si bëhet më e pastër. Kështu ka mbetur edhe tani, mbas 140 vjetësh. Është pjesa e afërt e Shkodrës, që i rrin asaj mbi krye pra kreu i Shkodrës, kryet e Shkodrës, krajt e Shkodrës, pra, KRAJA. Në Dibër, Mat, Krurë, Mirditë dhe thuajse në gjithë Shqipërinë Veriore përdoren shprehjet: u ul në "kraj t' venit"; "qite (nxirre) ni punë me krajë" (me krye); krajt (kryet) e arës; n'kraj t'zabelit, dmth në krye të zabelit; krajt(kryet) e gjurrës dmth-burimi; krajt(kryet) e vendit; krajetar-kryetar, jo kokëtar por kokëtar; "mos ma çaj krajt(kokën) me llafe kot", "Hajredin Pasha ni kraje (kokë) shanajk, / nuk asht Dibra Selenajk" etj. etj. plotë shembuj pa fund. Kraja ka qenë dhe është "krajt" (kryet) e Shkodrës. Qafa është Liqeni i Shkodrës që e ndan. Mbiemrin Kraja e kanë pothuase gjysma e Shkodrës. Para pak vjetësh thuhesh se vetëm Fadil Kraja numroheshin 17 vetë. Por Kraja ishte krye, krajt, kokë edhe për Stambolli. Krajanët kanë qenë me nam në garden e Sulltanit, të njohur si trima dhe besnikë. Për këtë pyeteni Eqrem bej Vlorën tek "Kujtimet". E mos na e çajnë ma krajt me gjithëfarë fundesh e bishtash sllavistike Cvijiçat, Ballukxhiçat, Jastrebovat etj.

* * *

Faza e dytë e punimit të detalit kryhej në repartin e axhusterisë gjatë semestrit II, ku përdornim limat, gur e letërzmerilet, trapanon, frezat etj. Aty punohej më e pastër. Ishte gati si laborator. Punët tona aty merrnin formën përfundimtare. Ishte kënaqësi kur në përfundim, para syve kishim çekiçin dhe pincat "tona", njësoj si ato që shiteshin në dyqan.

Mbarova klasën e parë. Mësuesi kujdestar, një burrë fisnik që na jepte histori, më deshte shumë. Kisha rënë në shkollën e prirjeve të mia. Do të bëhesha si Taqi, shpresa e babës, mbase edhe "inxhiner". Babës i çoja letra ku i tregoja për Fletëlavdërimet që merrja dhe ai ia jepte letrën kryetarit të kooperativës së fshatit që t'ia lexonte, kurse ai i thoshte, sa shkrim të bukur që paska. Dhe mbushej baba, dhe fjala hapej.

Për mua Politeknikumi ishte një universitet edhe në një kuptim tjetër, në kuptimin etnopsikologjik dhe etnokulturologjik. Kishte aty nxënës nga Tirana dhe Durrësi, Shkodra dhe Vlora, Dibra dhe Berati, Korça dhe Qyteti Stalin (Kuçova), Saranda dhe Kukësi. Vetë përbërja ishte një etnologji dhe etnografi më vete. Njihje dhe mësoje plot gjëra të nevojshme: dialekte, të folme, zakone, kultura, historira, sjellje, temperamente. Gjithë "Raca Shqiptare" ishte aty. Në mësim e në studim, në kohën e lirë e në kohën e zënë, në dhomën e fjetjes e në kinema, në bukë e në lojë. Aty ishte gjeografia dhe etnologjia e Shqipërisë, Gegëria dhe Toskëria, Malësia dhe Topalltia, qyteti dhe fshati. Për mua Politeknikumi ishte më shumë se politeknik, ishte multikulturor. Mishi i derrit, as që diskutohej. Besoj, e përlanin të gjithë, pa qibër.

Jetën në konvikt e bënte të frikshme n/drejtori i konviktit, Pandeli Malo. Burrë serioz, i gjatë dhe i veshur shik, por shpirt katran. Në rrethimin e shkollës, ai i dinte mirë shtigjet nga hynin dhe dilnin në qytet nxënësit pa leje. Kjo ishte normale. Aksionin e "kapjes" e bënte vetë. Para orës 20, kur ktheheshin për darkë, zinte pritë në vendet që i dinte dhe "lepuri binte në çark". Pastaj...përjashtim. Ishte kompetencë e tij. Nuk kishte paralajmërim, as instancë tjetër gjykimi apo apeli. Kjo më së shumti ndodhte me nxënësit nga Veriu, sidomos me "malokët". Me të "pagdhendurit" bëhej "dhjetimi" (decimacioni). Ishin edhe kujdestarët e konviktit, kujdestar Mahsar Topulli, Thanas Meksi, Fehmi Kodra, vëllau i Siri Kodrës që u vra vetë i dhjeti në Pojskë më 1943 dhe kujdestar Agimi; edhe këta ishin kërkues, korrekt, mirëkuptues, edukatorë të mirë.

Me të parë e me të bërë, të shtunën dhe të dielën pasdite, që kishim liridalje, zumë një marifet. U zgjua shpirti i aventurës. Në kinematë kryesore filluan të shfaqen filma të bukur si "Konti i Monte Kristos", "Të mjerët", "Duel në xhungël" etj. Biletat për llozhë ishin 20 lekëshe, në platé - 15 lekëshe për kinematë "Partizani" dhe "17 Nëntori", por edhe në "Republika" kur po shfaqej "Zotnia 420". Çiftet që vinin minutat e fundit nuk pyesnin për çmimin i cili bëhej dyfishi, kur biletat tashmë ishin shitur. Disa prej nesh blenim 5-6 bileta dhe i shisnim me 10, 15 dhe 20 lekë më shumë. Kështu na dilte ta shihnim filmin pa lekë dhe të hanim ndonjë nga ato ingranazhet.

Një mbrëmje më kapi një polic me bileta në dorë dhe më çoi tek biletaria, një ambient 2x2, që m'u bë edhe më i vogël. Vdiqa në këmbë. Kush të ka mësuar të bësh kështu? Pse? Si? Jo po unë, jo more vëllaçko, unë nuk desha, nuk...s'dija ç'thosha. Flisja kllapina, përsërisja herë pas here fjalë pa lidhje, ashtu kot "jo more vëllaçko", një shprehje parazitare që atëherë ishte zhargon, huazuar nga filmat sovjetikë dhe përpëlitesha i tmerruar nga pasojat. Unë nuk di, si, por...një konfuzion i gjallë. Mëndja drejt e tek n/drejtori, xhagai (ishte nofka që i kishin vënë nxënësit, një personazh filmash sovjetikë). Fundi dihej: me "vdekje". Shyqyr nuk më hetoi shumë, nuk pyeti as për emrin, as për shkollën, madje as edhe se çfarë isha. Isha lepur që bija me lehtësi drejt e në tavë të pjekjes. Nuk e zgjati. Më lëshoi. Shpëtova. Zoti ia numëroftë! Më nuk shkela në atë dërrasë të kalbur.

RËNIA E..."TAQIT"

Kur u paraqitëm në shtator për të vazhduar klasën e dytë, u ndodhëm para një të papriture. Ristrukturimi i Politeknikumit. Degën Minierale e transferuan në Prrenjas. Nga viti i parë i degës Mekanike që kishte katër klasa paralele, dhe që tashmë përbënin klasat e dyta, formuan një klasë dhe e çuan në Durrës (Shkozet) për të vazhduar atje, si pjesë e Shkollës Mekanike Bujqësore të sapo çelur. Mua më ra shorti (krejt i pa fat) të shkoja atje. U mundova ta ndryshoj për të ndenjur aty, por mësuesi kujdestar, që ishte engjelli mbrojtës i klasës dhe veçanërisht i imi, Rrapo Baxhuli nga Vlora, mësues i historisë dhe njeri prej njeriu, ishte shtruar në spital dhe me klasën D bënë si deshën. E hëngra unë.

Klasa e re ishte një përzieje (konglomerat) nga të katër klasat, pothuajse të panjohur me njëri tjetrin. Ndërtesa e shkollës në Shkozet, një shtëpi e vjetër, mbase e sekuestruar, kishte qenë përdorur ndoshta si shkollë për rezervat e punës, kurset për traktoristë e zetoristë. Të vetmen gjë serioze që kishte, ishin zilet elektrike. Klasa kishte ca banka të vjetra. Nxënësit ishin të panjohur me trupën mësimore endé të pa kompletuar, me edukatorin (kujdestarin) dhe n/drejtorin e koniktit. Filluam të bëjmë ndonjë orë mësimi në lëndët që kishtin mësues. Bëmë një orë mësimi në fizikë me një mësues të ri. Për sherr tim kisha lexuar në "Zëri i Rinisë" një shkrim për bionikën dhe e pyes mësuesin, në shenjë interesimi. Dhe ai vërtet më pa me interesim, por, duket zgjoi edhe smirë. Bëmë dhe një a dy orë të tjera, teknologji metalesh, të zeza a me ngjyra, nuk më kujtohet dhe kaq. Shkolla ende nuk kishte as drejtorin e saj. Mesa duket pritej të emërohej. Gjithçka ishte rrëmujë, në kompletim e sipër. Një burrë (kish qenë kujdestari i konviktit) na na mblodhi në klasë për të filluar studimin. Si pa njërin që kishte më pranë tij, e pyeti, si quhesh ti? Jani (mbiemrin e kam harruar). Nga je ti Jani? Nga Fieri. Ti do të mbash studimin dhe doli. Jani u sistemua në karrike mbi pod me tavolinën dhe klasën përpara për të mbajtur qetësinë. Nuk njiheshim sepse ishte i klasës A apo B të cilat e kishin bërë mësimin tek godina e degës Elektrike. Filloi studimi.

U ula në bankën e parafundit nga e majta. Në bankë isha vetëm. Ndërsa po lexoja plot kureshtje parathënien e një teknologjie metalesh, një dispencë e shaptilografuar, përkthyer nga rusishtja, ku shkruhej për arritjet sovjetike në industrinë metalurgjike, për qendrat e saj në Bashkimin Sovjetik dhe mësoja gjëra kurioze për gjeografinë, dy nxënës në fund të bankave, fill pas meje, nga Fieri a Mallakastra, edhe me ata ende nuk njiheshim, flisnin e qeshnin gjithë kohën, pa pushim. Libra para nuk kishin. Për të mbushur kohën me gallatë, njëri bëri edhe një veprim të paedukatë dhe filluan të zgërdhihen, sikur çoç bënë. I neveritur nga veprimi i tyre, madje i fyer, marr librin dhe dal një bankë më përpara që ishte bosh. Klasa kishte mjaft banka bosh. Shumë nga nxënësit nuk kishin ardhur fare në studim por sorollateshin nëpër Durrës derisa vinte darka kur hapej menca.

I rënduar fort nga përgjegjësia e re dhe pesha e "pushtetit" që iu dha, Jani u çart në fytyrë dhe sikur e kërkoi këtë çast. Pse ndërrove vend, çou dil jashtë! Nuk dal, pse p. e tyre do të dëgjoj unë? Nxirr këta që e bënë sherrin, jo mua. Ka gjithë orën që s'pushojnë duke bërë zhurmë e nuk u thua një fjalë. I kreshpëruar nga kundërshtimi, brofi nga karrigia dhe u vërsul si re e zezë drejt meje, më zuri për krahu për të më flakur përjashta, sikur t'i kasha shkelur domenin. Ia kapa dorën qetësisht për t'ia hequr. Nxirr jashtë këta jo mua! Këta...Në këtë çast hapet dera e klasës dhe bën ballë kujdestari i konviktit. Shikon "skenën e krimit". Pikërisht në këtë çast bie zilja (elektrike) për përfundimin e studimit.

Jani kujdestari i tha se unë kisha ndryshuar bankën pa leje (a thua se kisha kaluar klonin) dhe nuk po zbatoja urdhërin e tij për të dalë jashtë. Unë nuk u pyeta fare si qe puna. Kujdestari i konviktit nuk priti t'ia sqaroj problemin, por iku. Epo, do të më thërrasin në drejtori, mendova, mbase do ta lënë fare këtë punë. Prita, por atë mbrëmje nuk ndodhi gjë. Në konvikt nuk kishte asnjë nga "titullarët" a drejtuesit. Ç'drejtues thua, veç një n/drejtor konvikti kishte, njëfarë Vesim Toto. Kaq. Vetëm kaq. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Ju betohem, PËR KËTË ZOT që është një e s'ka tjetër. Betohem sot, pas afro 60 vjetësh kur po përgatitemi për dynjanë tjetër, sepse gjithë jetën i jam kthyer shumë herë kësaj "historie", vrastare të shpirtit të njeriut që më mbeti si gjyle hekuri në ndërgjegjen time. Punë fëmijësh është, por vrastare? Që përgatit edhe kriminelë.

Të nesërmen u rreshuam për të ngrënë mëngjesin dhe n/drejtori i konviktit më thirri të dal para nxënësve. Mori pozicion dhe tha: kemi një komunikim. B. Xh. përjashtohet nga shkolla për....Fjala "përjashtohet" më erdhi si plumb pushke, nga prapa kokës a prapa ferrës. Kalova në gjendje afektive, jermi, somnambulizmi. Nuk arrita të dëgjoj fjalë tjetër më. M'u errësuan sytë e m'u këput fryma, bota m'u suall vërdallë. Qielli më ra mbi kokë. Si nuk u shemba përdhé. As më thirrën e as më pyetën si qe puna; çfarë kisha bërë dhe pse. I ta kishin pritur a kërkuar rastin. Kush isha e kush s'isha. As motivacion (një fjalë punë disipline) e as vendim të shkruar nga "instanca vendimmarrëse". Ç'ti thuash kësaj? Pa qenë një urdhër nga qielli, zbritë nga zefiri a ngjit nga nadiri, nuk ka se si të zbulohet e të shpjegohet kjo ndodhi paradoksale, enigmatike. Në fakt jo dhe krejt enigmatike.

Aty për aty u shndërrova në hiç, i paqenë, një frymor pa frymë mbi tokë. Cilës tokë? Toka më kishte ikur nën këmbë. U shkëputa prej saj, u ndjeva në hava, në gjendje suspensioni. Humbe, i thashë vetes, humbe. E pate. Kaq paska qenë puna jote. Ty të çuan edhe tek Enver Hoxha s ii dalluar. Shkove pa gjykim, pa pushkë të shtime,...si shurra e pulës, i thonë një fjale në Dibër. Mbi kokë më kishte rënë topuzi: "kompleksi i malokut". Enigma? Komunikimi mbaroi, rreshtat e nxënësve u nisën drejt mencës. Jeta vazhdon. Disiplina u vendos. Detyra shtetërore u krye. Shteti në këmbë.

Nga dëshpërimi me gjysëm zëri thashë një fjalë (me dy kuptime) si ata trimaloçët mburravecë e çapaçulë, një zhargon që e kisha dëgjuar nga të mëdhenjtë, por që e dëgjoi vetëm një bashkëkrahinar i imi që ishte në kursin për traktorist. Ç'të bëja? Ku të shkoja? Mora strjcën ku veç ndërresave kisha endé një grusht lajthia që i pata mbledhur me dashuri në malin e Tem si kujtime fshati për fillimin e shkollës, i hypa trenit dhe u nisa për Tiranë. Nuk di pse këmbët më çuan tek "shtëpia e vjetër", Politeknikumi. S'kisha arsye, por instinkti, dëshpërimi, mbase ndonjë fije kashte për t'u kapur në detin me tallaz. Ndoshta akoma nuk ishin mbyllur letrat e ndarjes. Disa shokë të klasës që e kishin rregulluar për të ndejt në Tiranë, më nxorrën një racion në mencë, për drekë, por unë nuk kisha më emër aty. Isha bimë e shkulur. S'kisha se ku të mbahesha. Lavdërimet dhe fletë-lavdërimet e dikurshme nuk hynin në punë, u bënë nul bashkë me mua. Isha ilegal. S'kisha derë.

S'më mbeti tjetër, veç të gjej ndonjë makinë e të nisem për Dibër. Si do t'i dal përpara babës? Me emrin tim ai kishte ngritur një kështjellë të tërë. Ajo kështjellë tashmë më kishte zënë brenda. Të mbytem? Kush merakoset për ty? Ndoshta... ndonjë kurs për shofer. Se unë tashmë e kisha një klasë të mesme, mbi 7 vjeçaren. Ra piaca, pikiatë. Bafti i Zotit. Ndihmo, Zot e dita e Bajramit, / Dit' e madhe ke qillue. Të pjekt Zoti me njerëz të mirë, o bir! Kësaj radhe më kishte ra për hise pjesa e dytë e alternativës së fatit "Ëngjej dhe djaj". E paçin për vete, në të dy botët, kujt t'i takojë.

* * *

INTERMEXO

Dymbëdhjetë vjetë më vonë, më 1973, kur prapë më zuri një tjetër e pabërë, tamam si në ato mallkimet e shtrigave, m'u ngjit fort dhe u bë si "shibe", si lajtmotiv i jetës një shprehje e një kolegu në Institutin Pedagogjik të Shkodrës, Arif Gashit, ku shorti më ra të jem pedagog i ri në përfundim të studimeve të larta. Ai e përdorte shpesh shprejen: Gurë fshati të rrokullisur nga revolucioni. M'u duk se unë isha tamam nj'aj gurë, tipiku. Nuk vonoi shumë dhe atë që e kishte formuluar këtë sentencë urtësie revolucioni e zuri brenda duke ia shembur mbi kokë jo gurët por shkrepat e partisë.

Aty nga viti 1993 më ra në dorë një libër i Tahir Kolgjinit që kishte si kredo një thënie me burim popullor shkruar në hyrje të parathënies: "Në këtë botë s'ka gjâ mâ t'idhtë se me të vumë të pábâmen". Nuk e kisha dëgjuar më parë. A tua se e kishin thënë enkas për rastin tim. I ka provuar njerëzimi me kohë, prandaj edhe i ka dalë nga shpirti. Eshtë anonime. Eshtë marrëzi dhe do të konsiderohej si sindrom paranoje kur shkon nëpër mend t'i kujtosh e t'u japësh rëndësi këtyre trilleve të fatit, por mendja e njeriut nuk shqitet kollaj nga e keqja, ashtu siç nuk mund të harrojë as edhe të mirën. Edhe po të duash t'i kapërcesh e t'i marrësh me gas, që do të ishte më e mira, por nuk mundesh kurrsesi, sepse edhe gazi ka ligjësitë e veta. Nuk mund t'i bësh tradhëti shpirtit tend. Po edhe ta quash fitim përvoje e pasurim të jetës emocionale, kurrë, kurrë mos i raftë kujt. Jeta vritet gjithësesi. Nëmos vritet, helmatiset. Helmatiset shpirti i njeriut.

Por ka edhe ma keq. Duhet mbledhur mendja. Më 1973 unë vetë iu afrova fare pranë më të keqes. Asht ma mirë me nxanë në shpinë të tjerëve se në kurrizin e vet, thotë i urti. Një tjetër rast erdhi përsëri, nga qielli e nga toka, nga nadiri a zefiri, që mua m'u desht të bahem kurban, jo për të mësuar e nxanë nga rasti i të tjerëve por "për të nxanë të tjerët nga rasti im e në shpinën time". E sheh njeriu lojën që bëhet mbi fatin e tij si në ekran dhe nuk mund t'i ikë. Mos rafsh tek syri i ciklonit. Bie në fatalitet. Por, faleminderit Zotit që më ruajti nga më e madhja, nga më e keqja do të thosha, po, vetëm Ai dhe, mbase edhe...ndonjë bukë e dhanme.

* * *

KTHIMI NË SHTËPI

U ktheva në fshat si bilbil; si bilbil? Si hajdut pulash thuaj, me kryet përdhé e shikimin majtas e djathtas. S'desha të më shohë njeri. Më dukej se gjithë fshati kishte dalë në çdo kthesë rruge e në çdo pod dheu të më shihnin mua. Dikush me dorën mbi ballë si strehë. Kolomanat (manaferrat) e zes kullonin mjaltë por unë tashmë tek ferrat shihja vetëm gjëmbat që më kanoseshin.

Kur mbërrita në shtëpi, plasi e madhja. Aty gjeta nanën, streha e parë dhe e fundit e dobësisë dhe zemrës së njeriut. Thikat zemrës. Ja mbërrini baba, si rrëmeti. Valët endé të nxehta të fundverës e kishin shpërndarë lajmin. Lëshoi një zë si gjëmim. Nga natyra ishte edhe zâmadh dhe hovmadh. Pse ke ardhë, ku asht kmesa dhe mori hov të kapë atë. Do të të pres. Por ja "mbajtën" hovin dhe nuk e lanë të bënte hatanë. Po të donte vërtet, në atë gjendje që ishte, një lëvizje e krahut të tij edhe lisin do ta hidhte tutje jo më njeriun.

Shkoi në Durrës e Tiranë; u përpëlit sa mundi edhe ai, por, ç'të bënte? Shteti ishte i fortë, xheverí e fortë, vendimi "i fortë" i pakthyeshëm. Nuk di çfarë i kishin thënë babës, por pas disa muajsh, kur tashmë kisha filluar në Pedagogjike, po në klasën e dytë, si i jashtëm, kur sapo kishim filluar mësimin njëri nga profesorët iu drejtua klasës me një ton hakërryes duke vështruar nga unë në stilin e komunikimit të veprave kriminale. A e dini ç'farë ka ba ky? Ka rrah kujdestarin e konviktit. Dhe i mështoi zërit që të ngjisë fort. Nuk e di pse e pati gjithë atë mllef. Ndoshta kështu duhet ta kishin formuluar "akuzën" në mazbatën që më kishin përcjellë nga pas. Të vërtetën se mora vesh kurrë. As kam pyetur e as jam interesuar ndonjëherë për ta marrë vesh. Para klasës më prezantoi si të isha Al Kapone. Ky ishte rasti i vetëm i prezantimit tim në "publik", natyrisht, jo zyrtarisht. Megjithatë, në klasë të gjithë më njihnin mirë. Shumica ishin të 7 vjeçares sime, të "Demir Gashit" dhe disa edhe të Shupenzës, të klasës së pestë, me dy prej të cilëve rrinim në tavolinën e fundit nga mesi.

Ç'është e vërteta askush tjetër në Pedagogjike, as zyrtarisht, as "shoqërisht", as serizisht as me shaká nuk ma ka zënë a pyetur ndonjëherë atë "histori". As atëherë dhe as më vonë, kurrë. E morën të paqenë, mbase si një incident a keqkuptim. Për këtë, veçanësrisht për këtë, por edhe për të tjerat që erdhën më pas, u jam shumë e shumë mirënjohës; për këtë më shumë se për gjithçka jam falenderues. Shpejt më bënë vend edhe në konvikt, në "shtëpinë time", duke i shkurtuar fort etapat. Në mbarim të klasës së dytë kisha qenë diskutuar në këshillin pedagogjik që vitin e tretë ta përfundoja gjatë pushimeve të verës e të kaloja pastaj direkt në klasën e katër, por pas provimit të fundit unë isha larguar shpejt nga shkolla për të punuar në Kunorë Dardhë të Pukës në Rruga – Ura. Kur mbarova maturën, isha i vetmi që fitova të drejtën e studimit në Universitet direkt nga shkolla. Atëherë kishte shumë pak të drejta studimi dhe bursa për Universitet. Kandidatura tjetër direkt nga shkolla erdhi më vonë, nga "rezervat". "Biografia e Durrësit" ishte "fshirë", sikur nuk kishte ekzistuar fare. Fati dhe mirësia, që zbresin nga Providenca, dhe, përmjet Tij nga njerëzia, kompensojnë. Njeriu është në provë para Zotit, para Njeriut, gjithë jetën.

Bajram XHAFA, *Shkodër, 28 gusht 2018*

Rruga e Arbërit nr. 149

arsim

Zona e Bellovës është një zone malore, që përbëhet nga 4 fshatra: Bellova, Cerjani, Zagradi e Rabdishti. Largësia e këtyre fshatrave nga qyteti i Peshkopisë varion nga 4-6 km. Ajo shtrihet në grykën e përroit të Llixhave ose të Bellovës.

90-VJETORI I SHKOLLËS SË BELLOVËS

***Nga* Besnik LAMI**

Zona e Bellovës është një zone malore, që përbëhet nga 4 fshatra: Bellova, Cerjani, Zagradi e Rabdishti. Largësia e këtyre fshatrave nga qyteti i Peshkopisë varion nga 4-6 km. Ajo shtrihet në grykën e përroit të Llixhave ose të Bellovës. Fshatrat e saj: Cerjani, Zagradi e Rabdishti shtrihen në gryka malesh, që ndahen nga njëri-tjetri nga qafa malesh të thepisura apo të veshura me pyje ahu e lajthie, siç janë Qafa e Malit (Zimur), mali i Mushavecit dhe mali i Shpiravendit, që ndodhen në lartësi 1000-1300 m mbi nivelin e detit, në juglindje të vargmaleve të Korabit ose më saktë në këmbë të malit të Skërtecit e të malit të Deshatit. Kjo zonë malore e varfër e me pak tokë, por e veshur me pyje e kullota alpine, është marrë vazhdimisht me bujqësi e blegtori. Toka e pakët dhe varfëria i ka detyruar shumë banorë të zonës, sidomos të fshatrave Cerjan, Zagrad e Bellovë, të marrin rrugët e kurbetit për në Turqi, Greqi e Bullgari që në agimet e shek. XX e pas viteve 1990.

Si të gjitha trevat e Shqipërisë, edhe kjo zonë ka qenë e etur për dije e arsim, që sundimi shekullor turk ua pati privuar shqiptarëve për rreth 500 vjet, duke na lënë në errësirë e mjerim. Sipas të moshuarve, shkolla e parë shqipe në zonën tonë u hap në vitin 1928 në fshatin Bellovë (qendra e zonës), ku vijonin mësimet dhe të rinj nga fshatrat e tjera të zonës, duke ecur më këmbë deri në një orë. Sipas dëshmive të moshuarve, mësuesit e parë të kësaj shkollë ishin Abdulla Bazhdari, burrë i moshuar nga Dibra e Madhe, Halil Bazhdari, i biri. Pas tyre punuan në këtë shkollë mësues Sejdi Vyshka nga Elbasani, Halil Golja nga Dibra e Madhe etj., etj. Ekzaktësisht se sa vite shërbyen mësuesit e sipërpërmendur në shkollën e Bellovës dhe kush ishin mësuesit e tjerë që punuan në këtë shkollë deri në vitin 1940 kur shkolla u mbyll pas pushtimit fashist të vendit e nuk punoi për 5 vjet rresht në vitet e luftës NÇL, nuk dihen. Kjo gjë mbetet për t'u verifikuar më saktë nëpër arkivat e shtetit të qarkut Dibër apo në Tiranë.

Sipas dëshmive të të moshuarve shkolla fetare të sektit mysliman, me pak nxënës ose kursantë kanë funksionuar në fshatrat Bellovë, Cerjan e Rabdisht që në vitin 1901 e në vazhdim deri në vitet 1940, ku si mësues apo referues të mësimeve fetare e të gjuhës arabe shërbyen njerëz të mësuar me këtë kulturë fetare nga zona jonë, siç ishin Zabit Paci, Osman Lami, Xhelil Xhelili, Rexhep Sela etj.

Në vitet e Luftës NÇL, siç thamë më lart, edhe shkolla e Bellovës u mbyll, se ishin vite lufte, ku kishte krisma armësh, tmerr e terror, frikë e pasiguri, tym e flakë. Sipas dëshmive të të moshuarit 75-vjeçar Halil Shahu, shkolla e Bellovës u rihap në shtator të vitit 1946. Në dy vitet e para të rihapjes, në këtë shkollë vijonin mësimin edhe fëmijë 10-vjeçarë nga fshati Cerjan e Zagrad, si p.sh., Emin Lami, Xhemal Paci, Shaqir Xhelili, Sefedin Feta etj., etj., sepse në fshatrat Cerjan, Zagrad e Rabdisht shkolla fillore për herë të parë u hap në vitet 1947 e 1948. Sipas dëshmitarëve okularë të kohës, fëmijët shkonin me gëzim në shkollë nga etja për dituri. Shkonin në shkollë me opinga të grisura e pantallona me arna, se atëherë ishte varfëri e madhe, njerëzit vuanin për bukën e gojës, por dhe për veshmbathje.

Në vitet e para të çlirimit fëmijët mësonin shkrim e këndim dhe aritmetikë në një fletore bakalli e me gjysmë lapsi, me pak libra ose pa asnjë libër, se s'kishte libra, por dhe fletore e lapsa me shumicë si sot. Që të kursenin fletoret e pakta që kishin, fëmijët e asaj kohe ushtroheshin të shkruanin shkronjat apo numrat në rasa guri apo me shkopinj të mprehur druri shkruanin në truallin e tokës së ngjeshur. E tillë ishte koha atëherë. Shqipëria sapo kishte dalë nga lufta dhe ishte e varfër dhe e prapambetur. Sipas dëshmive të pensionistit Halil Shahu, por dhe të dokumenteve të arkivit të shtetit, shkolla fillore në Bellovë u rihap në shtator të vitit 1946. Atëherë shkolla kishte pak nxënës dhe të katërta klasat e ciklit të ulët i mësonte një mësues. Sipas dëshmitarëve të kohës dhe dokumenteve arkivore, në Bellovë kanë punuar këta mësues deri në vitin 1958:

- Në vitin shkollor 1946-1947 shërbeu si mësues Vangjel Sqapi nga Elbasani
- Në vitin shkollor1947-1948 shërbeu si mësues po Vangjel Sqapi



Si të gjitha trevat e Shqipërisë, edhe kjo zonë ka qenë e etur për dije e arsim, që sundimi shekullor turk ua pati privuar shqiptarëve për rreth 500 vjet, duke na lënë në errësirë e mjerim. Sipas të moshuarve, shkolla e parë shqipe në zonën tonë u hap në vitin 1928 në fshatin Bellovë (qendra e zonës).

- Ne vitin shkollor 1948-1949 shërbeu si mësues Hasan Dervishi nga Elbasani.
- Në vitin shkollor 1949-1950 shërbeu si mësues Mislim Shehu nga Peshkopia.
- Në vitin shkollor 1950-1951 shërbeu si mësues Mislim Shehu nga Peshkopia
- Në vitin shkollor 1951-1952 shërbeu si mësues Minella Dhima nga Elbasani
- Në vitin shkollor 1952-1953 shërbeu si mësues Rexhep Kadria nga Bellova
- Në vitin shkollor 1953 -1954 shërbeu si mësues po Rexhep Kadrie nga Bellova
- Në vitin shkollor 1954-1955 shërbeu si mësues Mislim Shehu nga Peshkopia
- Në vitin shkollor 1955-1956 shërbeu si mësues po Mislim Shehu nga Peshkopia
- Në vitin shkollor 1956-1957 shërbeu si mësues Rexhep Kadria nga Bellova
- Në vitin shkollor 1957-1958 shërbeu si mësues Zeqir Prapa nga Cerjani.

Shkolla fillore e Bellovës e hapur që më 1928 ka funksionuar në një ndërtesë në qendër të fshatit, buzë krojeve të fshatit, deri në vitin shkollor 1950-1951. Mësimi zhvillohej në një dhomë të madhe të katit të parë. Të katër klasat e ciklit të ulët mësoheshin nga një mësues, ulur në banka dërrase e numri i nxënësve varionte në atë kohë nga 30 deri në 40. Kati i dytë i ndërtesës shërbente si xhami dhe në vitin 1950-1951 ndërtohet në Bellovë në krye të fshatit, shkolla e re me dy klasa në tokë të Zeqir Saraçit. Kjo ndërtesë shkolle funksionoi për ciklin e ulët të Bellovës deri në vitin 1998, kur u amortizua dhe u shkatërrua si ndërtese. Që në vitin shkollor 1950-1951 shkolla e ciklit të ulët të Bellovës u bë me dy fuqi mësimore nga shtimi i numrit të nxënësve. Kështu, si mësues të fillores në këtë shkollë kanë punuar përveç Mislim Shehut, Minella Dhimos e Rexhep Kadrisë, edhe Xhelil Saraçi në vitet 1950-1952 dhe Zeqir Prapa në vitet 1953 e në vazhdim deri nga viti 1960. Në këto vite bashkë me Zeqir Prapën ka punuar si mësues për 3-4 vjet rresht edhe Selman Biba. Në vitin shkollor 1961-1962 ka punuar për një kohë të shkurtër në ciklin e ulët Bellovë dhe Dervish Biba, sot aktor i teatrit Fier dhe Safet Zhulali, ish-ministër i Mbrojtjes në vitet 1995-1997. Në vitet 1962-1965 ka punuar për 3 vjet rresht si mësues në Bellovë dhe Atnan Shehu, djali i pedagogut Munir Shehu. Deri në vitin 1964 nxënësit e klasave të katërta jepnin provime lirimi në lëndët gjuhë-shqipe e matematikë. Provimet për të katër fshatrat e zonës zhvilloheshin në shkollën e Bellovës në prani të komisionit të provimit. Deri në vitin 1964 shkollat fillore e katër fshatrave tona vareshin ligjërisht e kontrolloheshin nga drejtoria e shkollës 7-vjeçare "Demir Gashi", Peshkopi, si dhe nga inspektori i zonës të Seksionit të Arsimit në rreth. Mësuesit e viteve të para pas çlirimit e deri në vitin 1955, përveç punës për konsolidimin e shkollës, bënë dhe një punë të madhe në luftën për zhdukjen e analfabetizmit në shkollë.

Në vitin 1964 në Bellovë hapet për herë të parë në zonë shkolla 8-vjeçare. Pranë shkollës së ciklit të ulët Bellovë, në krye të fshatit ndërtohet një ndërtesë e re e ngritur në xuklaturë ngjitur me ndërtesën e ciklit të ulët me katër klasa mësimore (sot e shkatërruar). Në bazë të ligjit të shtetit për arsimin e detyruar 8-vjeçar, në këtë shkollë vijonin mësimin të gjithë fëmijët e 4 fshatrave të zonës, që mbaronin klasën e katërt dhe udhëtonin deri në një orë më këmbë nga fshati Rabdisht. Kjo ndërtesë funksionoi si shkollë deri në vitin 1974, pra për afro 10 vjet, pasi më pas u ndërtua lokali i ri në përrua të Bellovës, ngjitur me zyrat e ish-kooperativës bujqësore. Ky lokal u ndërtua nga kooperativa bujqësore me fondet e shtetit. Shkolla u ndërtua me 8 klasa, me drejtori e dhoma mësuesish, me bibliotekë e ngjitur me të edhe një palestër e vogël për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik gjatë stinës së dimrit. Poshtë shkollës u ndërtua këndi i kalitjes fizike bashkë me fushën e volejbollit e basketbollit. Tashme zona u pajis me një drejtori shkolle, që administronte e kontrollonte edhe shkollat e fshatrave për rreth.

Drejtori i parë i shkollës 8-vjeçare "Shemsi Haka" në Bellovë, ishte Hysni Çipuri në vitin shkollor 1964-'65, kurse si mësues të ciklit të lartë shërbyen Nexhmi Tomçini, Mithat Hoxha, Idriz Bulku, Islam Hysa nga Zerqani dhe Fari Hysa nga Vlesh,a që shërbyen si mësues 1-2 vjet në këtë shkollë.

Në vitin shkollor 1965-1966 drejtor shkolle në Bellovë ishte Islam Hysa.

Në vitin shkollor 1966-1967 shërbeu si drejtor shkolle z. Musa Bulku.

Në vitin shkollor 1967-1968 shërbeu si drejtor shkolle znj. Fatmira Zenuni.

Në vitin shkollor 1968-1969 shërbeu si drejtor shkolle z. Idriz Bulku.

Në vitet shkollore nga 1 shtatori 1969 deri më 1 shtator 1976 shërbeu si drejtor shkolle për 7 vjet rresht z. Tahir Cara nga Dohoshisht. Nga 1 shtatori 1976 e deri në gusht të vitit 1990 shërbeu si drejtoreshë shkolle z. Behije Sefa, e diplomuar në Shkodër për biokimi. Behija e filloi punën në shkollën e Bellovës që në shtator të 1974, si mësuese dhe pastaj shërbeu si drejtoreshë shkolle për 14 vjet rresht. Ajo sot është në pension e pajisur me një eksperiencë pune 35-vjeçare. Në vitet 1985-30 dhe qershor 1990 zëvendësdrejtor shkolle ishte z. Myrteza Mera. Në vitet 1 shtator 1990 - 30 gusht 1994 shërbeu si drejtor shkolle z. Myrteza Mera.

Në vitin shkollor 1994-1995 shërbeu si drejtor shkolle, z Nuri Sefa.

Në vitin shkollor 1995-1997 shërbeu si drejtor, z. Rami Istrefi.

Në vitin shkollor 1997-1998 e deri më 30 gusht 1999 shërbeu si drejtor shkolle z. Besnik Lami. Në vitin shkollor 1999-2000 drejtor shkolle ishte Ali Nesimi e zëvendësdrejtor ishte Imer Saraçi. Pas tij drejtor shkolle u bë Astrit Shahu, mësues i gjuhës dhe letërsisë. Pas Astrit Shahut drejtor u vu Osman Majmari, mësues gjuhë-letërsie deri në mars të vitit 2014. Pas kësaj date DAR-i caktoi drejtorë të shkollës persona sipas përkatësisë partiake, njerëz pa përvoje pune e përgatitje pedagogjike.

Imer Saraçi ishte drejtor nga nëntori i vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2005. Nga dhjetori i vitit 2005 e deri më 30 dhjetor 2010 drejton shkollën si drejtor z. Astrit Shahu. Sejfulla Sefa ka punuar si mësues i ciklit dhe ciklit të lartë që nga janari i 1975 e deri në pranverën e vitit 2013, kur doli në pension. Në periudhën 1 shtator 1975 - 30 gusht 1979 punon si mësues i ciklit të lartë në Bellovë. Në vitet shkollore 1979-1982 punon si mësues i ciklit të ulët në Cerjan. Në vitet shkollore 1982-1992 punon si mësues i ciklit të ulët në Zagrad. Nga 1 shtatori i 1992 ka punuar në ciklit e lartë dh ciklin e ulët në Bellovë e Rabdisht për disa vjet rresht. Në vitet 2000-2006 Sefa ka shërbyer dhe si zëvendësdrejtor. Besnik Lami e ka filluar punën në këtë zonë më 1 shtator 1970 e deri në mars të vitit 2014, kur doli në pension. Në vitet 1970-1971 shërbeu si mësues për një vit e gjysmë për ciklin e lartë në Rabdisht, pastaj shkon ushtar për 2 vjet e nga 1 dhjetori i 974 e deri në qershor të vitit 1984 punon si mësues në ciklin e ulët, Cerjan. Më 1 shtator 1984 e deri më 1 shtator 1997 punon si mësues në ciklin e lartë Bellovë e Rabdisht. Punoi 2 vjet si drejtor shkolle e pastaj punoi si mësues i ciklit të lartë në Rabdisht derisa doli në pension. Nexhbedin Paci e fillon punën si mësues në vendlindjen e tij, Cerjan, më 1 shtator 1967 e vazhdon në këtë fshat deri në nëntor të vitit 1973 kur shkoi ushtar. Pas lirimit nga ushtria punon si mësues në fshatin Mustafë për 4 vjet rresht. Nexhbedini rikthehet në Cerjan më 1 shtator të vitit 1979 e punon këtu i mësues i ciklit të ulët deri në dhjetor të vitit 2005. Nga janari i 2006 e derisa doli në pension në shtator të vitit 2015 punon si mësues i ciklit të ulët në Rabdisht. Abedin Sefa e fillon karrierën më 1967, duke punuar si mësues i ciklit të ulët në fshatin Rabdsht bashkë me Bajram Brahën deri në shtator të vitit 1970. Pastaj punon për dy vjet në fshatin e lindjes, Zagrad. Pasi mbaroi ushtrinë, në dhjetor 1975 rifillon punën në fshatin e lindjes më 1976 e deri në 2008, ku shërbeu si mësues i ciklit të ulët Zagrad. Nga shtatori i vitit 2008 e derisa doli në pension, në prill 2014, punoi si mësues i ciklit të ulët Rabdisht. Nuri Sefa e fillon punën si mësues i ciklit të lartë për histori-gjeografi në shtator të vitit 1970 në Bellovë dhe mbaron në këtë shkollë karrierën pedagogjike derisa vdes më 21 korrik 1999. Para 1970, Nuriu punoi 2-3 vjet si mësues në zonën e Reçit e në fshatin Sahadoll dhe gjatë gjithë periudhës tjetër ka punuar në ciklin e lartë, Bellovë.

Myrteza Mera i datëlindjes 1945 ka mbaruar shkollën "Shejnaze Juka" në Shkodër më 1963. Në vitin shkollor 1964-1965 shërben si mësues i ciklit të lartë në Bellovë. Në vitet 1965-1967 mbaron Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër e kthehet përsëri për një vit si mësues matematike në Bellovë e pastaj shkon ushtar. Myrtezai rikthehet në zonën e Bellovës si mësues i ciklit të lartë më 1975 e punon këtu për 30 vjet rresht, deri në shtator të vitit 2005, fillimisht si mësues i thjeshtë e pastaj për 5 vjet si nëndrejtor. Më vonë për 4 vite rresht si drejtor shkollë deri në gusht të vitit 2005. Imer Saraçi, mësues biologjie, ka punuar në zonën e Bellovës në ciklin e lartë Bellovë e Rabdisht që nga viti 1984 e deri në gusht të vitit 2005 kur u largua nga kjo zonë. Para vitit 1984 ai ka punuar si mësues për 7-8 vjet në Lurë. Në vitet 1998-2000 ka shërbyer për 2 vjet si zëvendësdrejtor e pastaj për 5 vjet rresht si drejtor shkolle në vitet 200-2005. Lule Saraçi ka punuar si mësues e ciklit të lartë Rabdisht për 7 vjet rresht në vitet: shtator 1998 - shtator 2005. Ismet Nesimi ka punuar si mësues matematike në ciklin e lartë Bellovë për 13 vjet rresht gjatë viteve 1975-1988. Si mësues matematike në Bellovë ka shërbyer në vitet 1977-1980 edhe Rina Sinjari. Enver Zeneli

I urojmë nga zemra shkollës “Shemsi Haka” gëzuar 90-vjetorin dhe ditë më të bukura ardhshin për ty dhe brezat që do të mësosh!



Duke qenë afër qytetit të Peshkopisë, në shkollën 8-vjeçare Bellovë kanë qarkulluar shumë mësues, disa nga të cilët disa kanë punuar me periudha të shkurtra e disa me periudha të gjata pune.

ka punuar në shkollën e Bellovës si mësues gjuhe në vitet 1978-1994 ose 16 vjet rresht.

Shkëlqim Koltraka ka punuar si mësues gjuhë-letërsie në ciklin e lartë Bellovë për 10 vjet rresht në vitet 1981-1991. Myrteza Baboçi ka shërbyer në ciklin e lartë Bellovë si mësues gjuhe e muzike nga shtatori i vitit 1976 e deri në shkurt të vitit 1992, kur doli në pension, afro 16 vjet punë. Në vitet 1978-1981 ka shërbyer si mësues gjuhe në ciklin e lartë Bellovë dhe znj. Fëllanxa Llagaci. Zenepe Baboçi shërbeu si mësuese e ciklit të ulët Bellovë për 4 vjet rresht në vitet shtator 1975 - gusht 1979. Haxhere Allushi shërbeu në mesin e viteve ‘70 si mësuese e ciklit të ulët Bellovë për 3 vjet rresht. Lavdrim Shehu ka punuar si mësues gjuhë-letërsie në ciklin e lartë në Bellovë gjatë viteve 1971-1975 për 4 vjet rresht.

Astrit Kodra ka punuar në vitet 1966-1972 si mësues matematike në ciklin e lartë Bellovë për 6 vjet rresht. Gëzim Shatku ka punuar në zonën e Bellovës për 16 vjet me radhë që nga shtatori i 1980 e deri me 15 janar 1996 si mësues i cikli i ulët Bellovë. Mefat Lazimi ka punuar si mësues i ciklit të ulët në fshatrat Zagrad e Rabdisht për 22 vjet rresht që nga shtatori i 1974 e deri në shtator të 1996, 2 vjet në Zagrad e 20 vjet në Rabdisht.

Mahmut Xhembulla i datëlindjes 1946 nga qyteti i Peshkopisë ka punuar në zonën e Bellovës si mësues i ciklit të lartë për histori-gjeografi në fshatrat Bellovë e Rabdisht për 23 vjet rresht nga 1969 e deri më 1992. Vera Xhembulla ka punuar në ciklin e ulët Bellovë gjatë viteve shkollore 1977 e deri në dhjetor të 1982, afro 5 vjet e ca. Kudret Hoxha e Xhile Hoxha tashmë emigrantë në SHBA kanë punuar në Bellovë nga fundi i viteve ‘70 e deri në mesin e viteve 1980 për 7-8 vjet rresht. Kudreti jepte matematike e Xhilja gjuhë të huaj (frëngjisht). Xhile Hoxhën e zëvendësoi më 1985 për gjuhë të huaj mësuesja Zamira Saraçi, e cila edhe kjo punoi në këtë shkollë për 10 vjet rresht deri më 1995. Zamirën e zëvendëson për këtë lëndë ish-nxënësi i saj Pajtim Sela në vitet 1995-1999. Pas largimit të Pajtimit në emigracion gjuhën e huaj vazhdoi dhe vazhdon ta japë mësuese Semiha Haka.

Pas vitit 1999, shkolla e Bellovës ngeli për 4-5 vite rresht pa mësues të gjuhës së huaj për mungesë kuadri. Nëvitet 2005 0 2008 gjuhën e huaj (anglisht) në ciklin e lartë Bellovë e Rabdisht e dha Anita Lami e pas largimit të saj, këtë lëndë vazhdon ta japë mësuesja Semiha Haka.

Astrit Shahu ka filluar punën në vendlindjen e vet në shtator të vitit 1969 si mësues i ciklit të lartë Bellovë. Këtu punon 5 vjet rresht si mësues gjuhë-letërsie dhe në shtator të vitit 1974 vete për studime të larta në Shkodër e rikthehet si mësues në shkollën 8-vjeçare të Rabdishtit në shtator të vitit 1979, ku punon deri në vitin 1994 për 15 vjet rresht. Në shkollën e Rabdishtit Astriti kryen për 3-4 vite dhe detyrën e zëvendësdrejtorit. Në dhjetor të vitit 2005 Astriti emërohet nga DAR e rrethit drejtor i shkollës 9-vjeçare Bellovë. Ai e kryen këtë detyrë deri në fund të vitit 2010, kur ndahet nga jeta para kohe nga një sëmundje e rëndë. Rufa Shahu e fillon punën në drejtorinë e Bellovës si edukatore kopshti në Bellovë në shtator të vitit 1979. Në këtë punë ajo qendrën deri në gusht të vitin 1993 . Në shtator të vitit 1993 Rufaja fillon punën si mësues e ciklit të ulët në Bellovë, ku vazhdon punën si mësuese për 20 e ca vjet rresht, derisa doli në pension në vjeshtën e vitit 2016. Punën e Rufasë si edukatore kopshti në Bellovë e kryen znj. Sadete Kadriu, e cila e vazhdon këtë punë edhe sot e kësaj dite. Sadetja para së të vijë në Bellovë ka punuar si edukatore për 5 vjet rresht në fshatin Zagrad. Në fshatin Rabdisht shërben si edukatore kopshti Najete Nesimi që nga viti 1994 e deri sot.

Flora Lami e ka filluar punën si mësuese e ciklit të ulët në fshatin Cerjan në shtator të vitit 1975, krahas mësuesve Ylber Sela, Sefë Sefa, Lavdrim Feta e Perviz Mera. Që nga viti 1975 Cerjani u bë me katër fuqi mësimore, prandaj më 1979 në Cerjan u ndërtua shkolla e re. U rrit numri i nxënësve që shkonte deri në 80-86 nxënës, kurse sot me 2018 Cerjani ka një fuqi mësimore me 6-7 nxënës për 5 klasat e shkollës fillore. Kjo ka ardhur nga migrimi masiv i fshatarëve drejt qytetit dhe lëvizja e lirë e njerëzve. Në fillim të viteve ‘80 Flora punon si edukatore kopshti në Cerjan, duke zëvendësuar znj. Lirie Paci, e cila martohet. Për 3-4 vite Florën e zëvendëson si mësuese e ciklit të ulët shoqja Fiqirete Haka. Më 1985 Flora rikthehet prapë në shkollë si mësuese, duke punuar deri në gusht të vitit 1995. Në shtator të vitit 1995 e deri në gusht të vitit 1998 ajo punon si mësues e ciklit të ulët në fshatin Rabdisht krahas mësueseve Bukurie Dumani, Majlinda Kadriu e Perviz Mera. Në shtator të vitit 1998 ajo transferohet si mësuese pranë shkollës “Demir Gashi” Peshkopi.

Ylber Sela fillon punën si mësues i ciklit të ulët në dhjetor të vitit 1971 në fshatin Bellovë deri në gusht të vitit 1973. Më 16 gusht të vitit 1973 transferohet në fshatin Cerjan, ku punon afro 5 vjet deri në gusht të vitit 1978 . Në shtator të vitit 1978 zbret për një vit në Bellovë e vitin tjetër shkollor 1979-1980 e kryen në fshatin Rabdisht. Rikthehet në ciklin e ulët Bellovë në gusht të 1980 e punon deri në tetor të vitit 1985, kur transferohet nga zona e Bellovës. Gjatë viteve 1976-1978 bashkë me Ylberin punon si mësues në Cerjan edhe Rustan Sela për 2 vjet. Perviz Mera i datëlindjes 1953 ka punuar si mësues në ciklin e ulët Cerjan në vitet 1983-1993 dhe pastaj nga shtatori i vitit 1993 e deri në gusht të vitit 2005 si mësues i cikli i ulët në fshatin Rabdisht, pra 22 vjet punë në këtë zonë.

Lavdrim Feta i datëlindjes 1954 e fillon punën në zonën tonë si mësues aty nga 1985 në ciklin e ulët në Cerjan, ku vazhdon punën deri në gusht të vitit 1995, kur transferohet me punë në fshatin Rabdisht. Nga mesi i viteve 2000 punon për 3-4 vjet në ciklin e ulët Bellovë dhe aty nga 2007-2007 punon për një vit në ciklin e lartë Rabdisht e pastaj në ciklin e ulët Bellovë. Në vitin shkollor 2009-2010 punon në ciklin e ulët Zagrad, ku vazhdon dhe sot. Ruzie Feta punon si edukatore kopshti në fshatin Zagrad që nga shtatori i vitit 1993 e në vazhdim deri sot. Menduh Basha ka filluar punën si mësues i ciklit të ulët në shkollën

Gjatë këtyre 90 viteve, që nga hapja e shkollës së parë shqipe në Bellovë dhe nga ato të hapura pas çlirimit në fshatrat e tjera kanë dalë nga bankat e kësaj shkolle dhjetëra e qindra nxënës, djem e vajza, me dije e kulturë për jetën. Nga bankat e këtyre shkollave kanë dalë punëtorë të zotë e bujq të dalluar në kultivimin e patates e mbarështimin e blegtorisë, dhjetëra zanatçinj duarartë e tregtarë të zotë dhe dhjetëra e qindra kuadro në fushën e arsimit e të kulturës, në fushën e ekonomisë e të shkencës si mësues, mjekë, ushtarakë, ekonomistë e inxhinierë të zotë në shumë fusha, që me punën e tyre të madhe i kanë shërbyer zonës, rrethit dhe gjithë Shqipërisë.

e Bellovës në shtator të vitit 1992. Punon në këtë shkollë deri në gusht të vitit 1996 dhe pastaj nga shtatori i vitit 1996 e deri sot punon si mësues histori gjeografie në ciklin e lartë në Rabdisht. Nga viti 2014 punon në ciklin e ulët.

Shemsi Saraçi me UT ka punuar në shkollën e Bellovës si mësues gjuhë-letërsie nga shtatori i vitit 1993 deri në gusht të vitit 1999. Lavdosh Sela ka punuar si mësues i ciklit të lartë në Bellovë nga viti 1994 e deri në vitin 2000, duke dhënë lëndët vizatim, muzikë e gjuhë. Ibrahim Bulku, mësues i edukimit fizik ka punuar në shkollën e Bellovës gjatë viteve 1977 deri më 30 gusht të 1986.

Sabedin Xhelili ka punuar si mësues i ciklit të ulët Bellovë për 3-4 vjet e pastaj si mësues në shkollën fillore Cerjan gjatë viteve 1989-2003, kurse e shoqja, Liljana Xhelili, ka punuar si mësuese e ciklit të ulët Cerjan në vitet 1993-1998. Servete Saraçi me arsim të lartë punon si mësuese e ciklit të ulët në Bellovë në vitet 1989-2010. Xhilka Mera ka punuar si mësuese matematike në Bellovë gjatë viteve 2005 - gusht 2007. Lume Uka ka filluar punën si mësuese e ciklit të ulët Rabdisht e pastaj në Bellovë që nga shtatori i vitit 2002 e deri më 2010. Arian Shahini ka punuar si mësues matematike në ciklin e lartë Rabdisht nga shtatori i vitit 1994 e deri në gusht të vitit 2004, kur iku në emigracion. Ali Nesimi me arsim të lartë UT si mësues matematike e fizike ka punuar në zonën e Bellovës në ciklin e lartë në Rabdisht e Bellovë në vitet shtator 1996- gusht 2000, pra 4 vjet. Rozina Shkurta, mësuese e edukimit fizik, ka punuar në ciklin e lartë Bellovë e Rabdisht, duke marrë dhe lëndë plotësuese nga shtatori i vitit 1992 e deri më 15 mars 2010.

Në vitet 1964-1975 kanë punuar si mësues në ciklin e lartë dhe të ulët në Bellovë përveç mësuesve lartpërmendur, edhe mësues të tjerë me periudha të shkurtra, si Fatmira Zenuni, Afërdita Zenuni, Lirie Kadria në vitet 1967-1975. Muhamet Arapi për 3-4 vjet deri më 1968, Hiqmet Hoxha për një vit, Halim Lami në vitet 1970- 1975 si mësues biologjie, Kujtim Neli, Fiqirete Stojku, Elvana Malecka, Donika Hyseni etj.

Duke qenë afër qytetit të Peshkopisë, në shkollën 8-vjeçare Bellovë kanë qarkulluar shumë mësues, disa nga të cilët disa kanë punuar me periudha të shkurtra e disa me periudha të gjata pune. Hysnie Dumani, ish-nxënësja jonë ka punuar në ciklin e lartë Bellovë si mësuese gjuhe nga viti 2004 e deri me 2014 për 10 vjet rresht. Pas largimit të Ibrahim Bulkut nga shkolla jonë, në gusht të 1986 vjen për 3-4 vjet si mësues i edukimit fizik mësuesi Njiazi Dani nga qyteti i Peshkopisë.

Shkolla e re e ndërtuar më 1974 nga kooperativa bujqësore njëkatëshe me gur e me 10 klasa funksionoi deri në fund të vitit 2005. Sot ajo është amortizuar e shkatërruar, por krahas saj, ngrihet shkolla e re dykatëshe e me 10 klasa mësimore e ndërtuar me 2005 nga shteti sipas standardeve të kohës dhe e pajisur me tavolina të reja e mjete të ndryshme mësimore e kabinet informatike.

Gjate viteve 1970-1990 numri i nxënësve në shkollë rritej vazhdimisht si rezultat i lindjeve të larta e përqendrimit të popullsisë. Si drejtori shkollë numri i nxënësve në këto vite vente në rreth 500 nxënës në të katër fshatrat me rreth 3000 banore, kurse në ditët e sotme në zonën e Bellovës numërohen rreth 1000 banore, kurse si nxënës në rang drejtorie vene rreth 100 nxënës. Stafi pedagogjik i shkollës përbëhej nga 34 mësues, kurse sot me 12-14 vet. Kuptohet nga shifrat së çfarë regresi ka pësuar zona në këto 30 vjet demokraci. U zbrazen fshatrat nga emigrimi i popullsisë brenda e jashtë vendit. U boshatisen shkollat nga mungesa e nxënësve si rezultat i migrimit masiv të popullsisë dhe lindjeve të pakta. Fshati Cerjan dhe Bellovë dikur në vitet ‘80 kishin nga 4 fuqi mësimore, kurse sot kanë nga një fuqi mësimore me nga 6-7 nxënës. Fshati Zagrad kishte dy fuqi mësimore me mbi 40 nxënës, kurse sot ka vetëm një fuqi mësimore me 5-6 nxënës. Jo vetëm në ciklin e ulët punohet me nga 4 klasa së bashku, por edhe në ciklin e lartë Bellovë e Rabdisht në 10 vitet e fundit punohet me klasa kolektive, nga rënia e numrit të nxënësve. Kuptohet dhe nga këto të dhëna se çfarë cilësie mësimore e rezultate mund të kenë mësuesit në procesin mësimor. Në vitet 70-80 të shek. të kaluar niveli arsimor i personelit mësimdhënës ka qenë në gjendje shumë më të mirë sesa në dy dekadat e fundit. Në vitet ‘70-‘80 të shek. të kaluar 70% e mësuesve të Bellovës ishin me arsim përkatës, kurse sot ky raport është i kundërt.

Gjatë këtyre 90 viteve, që nga hapja e shkollës së parë shqipe në Bellovë dhe nga ato të hapura pas çlirimit në fshatrat e tjera kanë dalë nga bankat e kësaj shkolle dhjetëra e qindra nxënës, djem e vajza, të mësuar e të armatosur me dije e kulturë për jetën. Nga bankat e këtyre shkollave kanë dalë punëtorë të zotë e bujq të dalluar në kultivimin e patates e mbarështimin e blegtorisë, dhjetëra zanatçinj duarartë e tregtarë të zotë dhe dhjetëra e qindra kuadro në fushën e arsimit e të kulturës, në fushën e ekonomisë e të shkencës si mësues, mjekë, ushtarakë, ekonomistë e inxhinierë të zotë në shumë fusha, që me punën e tyre të madhe i kanë shërbyer zonës, rrethit dhe gjithë Shqipërisë. Ashtu si në luftën NÇL, bijtë e kësaj krahine kontribuuan për çlirimin e vendit, duke u radhitur si partizane në njësitë e formacionet e ushtrisë NÇL, një ndihmë të madhe dhanë bijtë e kësaj krahine dhe në ndërtimin e jetës së re. Bellova është një zonë punëtore dhe arsimdashëse. Më poshtë po përmendim disa nga kuadrot e arsimuar në shkollat e vendit nga krahina e Bellovës:

Në fushën e arsimit: prof. Qazim Xhelili, Mahmut Dumani, Zeqir Prapa, Myrteza Mera, Sejfulla Sefa. Nuri Sefa, Abedin Sefa, Besnik Lami, Nexhbedin Paci, Kujtim Neli, Halim Lami, Bajram Braha, Imer Saraçi, Behije Saraçi, Astrit Shahu, Mehmet Saraçi, Fetah Dumani, Shemsi Saraçi, Ali Nesimi, Arjan Shahini, Perviz Mera, Lavdrim Feta, Ylber Sela, Hysnie Dumani, Shazimete Goleci, Miranda Goleci, Sevi Lami, Fatmir Paci, Sejdi Halimi, Qani Kadria, Ismet Nesimi, Kumrie Haka, Redife Shahu, Jeton Lami, Selami Kaza, Gëzim Ismaili, Xhemile Haka, Liljana Prapa etj.

- Në fushën e mjekësisë: Dr. Ismail Feta, Jusuf Mera, Luftime Goleci (Bruka), Dr. Selman Dumani, Mufit Saraçi, Evisa Imer Saraçi, Festime Saraçi (Vranici), Izet Dumani, Bardha Mera, etj.

- Në fushën e ekonomisë: Agim Shahu, Ali Kaza, Xhelil Paci, Safet Saraçi, Lami Ismaili, Qatip Mera, Taxhedin Saraçi, Teuta Ismaili, Alfred Sefa, Njazi Elezi, Agron Xhelili, Pëllumb Haka, Mevlan Meda, Hazbie Xhelili, Lavdrim Haka, Luan Haka, Idajete Braha, Arshi Haka etj.

- Në fushën inxhinierisë: Bajram Kadria, Safet Saraçi, Selami Shuip Saraçi, Selim Kadria, Edvin Shahu, Bedri Saraçi, Hamdi Haka, Lavdrim Saraçi, Maksut Saraçi, Hakik Paci, Rustem Paci, Zaudin Kadria, Myrteza Kadria, Ramazan Nesimi, Ramazan Hysa etj.

- Në fushën ushtarake: Abdulla Selim Elezi, Mefat Kadria, Bahkim Feta, Fedai Manga, Ajet Haka, Lulzim Xhelili, Emin Saraçi, Shkelqim Saraçi, Benik Saraçi, Afrim Braha, Eqerem Lami, Nexhat Feta, Bektash Prapa, Sadri Seferi, Selami Feta, Vesel Prapa etj.

- Në fushën e agronomisë: Nexhbedin Dumani, Mehmet Kadria, Selami Xhelili, Jonuz Paci etj.

- Në fushën e juridikut: Metush Sinan Saraçi, Albert Kazia, Flora Ismaili etj.

I urojmë nga zemra shkollës “Shemsi Haka” gëzuar 90-vjetorin dhe ditë më të bukura ardhshin për ty dhe brezat që do të mësosh!

Ky material u punua në mars të vitit 2010 dhe u përpunua në gusht të vitit 2018.

31 gusht 2018

Rruga e Arbërit nr. 149

Adoleshenti nga Dibra Geraldo Genc Hoxha qe konkuroi ne Genius Olympiad 2018 ne New York të Amerikes.

Të lumtë Geraldo Hoxha!





Të zbulosh, nuk është fatësi, ndërsa rastësi sigurisht. Ana tjetër e problemit qëndron se duhet të dish shumë, por, edhe shumë herë të kesh mëndje të holl. Rastësisht në një bisedë, degjova se nje djalosh nga Muhurri i Dibërës kishte garuar ne Genius Olympiad 2018 ne New York te Amerikes. Dashuria e madhe qe kam per arsimin me shtyu qe te shkoj ta takoj këtë djalosh nga Muhurri. Ishte nje djal i ri, fytyrë bardhë, me ca sy të zes dhe ballin pak sa të ngritur ku qetësisht i shtonin bukurinë flokët e zituar. Dukej lehtësisht se nuk i kalonte te shtatëmbedhjetat.

Kishte mbaruar vitin e dytë në gjimnazin‘‘Hafiz Ali Korça”,, në qytetin e Kavajes. Qetësia e tijë fshihte pas nje zjarr të brendshem vullneti e pasioni për të studiuar. Prandaj ai së bashku me shokun e tij Saimir Lufo krijuan një projekt me temë: ‘‘Toka e vetmia shtëpi që kemi.,,. Megjithëse ne ambiente konvikti Geraldo dhe shoku i tij vendosën te punonin seriozisht. Punuan gjithë natën me orë të tëra në ambientet e konviktit për të arritur dicka që i qonte shumë larg. Megjithëse profesori Tasim Çarku që i ndiqte herë pas here punën e tyre ishte shumë pesimist në realizimin e projektit pasi ishte shumë e vështirë të arrihej një gjë e tillë pa nderhyrjen e profesionisteve. Pas nje stërmundimi te madh Geraldo dhe shoku i tij kishin realizuar projektin. Profesori Tasim Çarku dhe i gjithë stafi pedagogjik I kesaj shkolle mbetën mjaftë të kenaqur dhe vendosën që Geraldo bashke me shokun e tij të garojnë në Shqipëri në konkursin ‘‘Asef,, ku morën çmim te dytë.

Duke parë e kuptuar pregatitjen e Geraldos dhe Saimirit, stacioni televiziv privat shqiptar ‘‘Vizion plus,, i ftoi në emisionin ‘‘Oktapod,, ku ato shpjeguan me plote dinjitet, zgjuarsi qëllimin dhe përmbajtjen e projektit.

Duke parë në You Tube këtë emision me erdhi në kujtes një shprehje J.V. Gëte i cili thotë : ‘‘Këtë tokë të gjorë, ka mijëra vjet që e shfrytëzojnë, e megjithatë forcat e saj kanë mbetur po ato. Pak shi, pak diell dhe ajo vishet me blerim në çdo pranverë dhe kështu do të vazhdoi për jetë.,, (11 prill 1827 në faqen 166 ‘‘ Gëte,, Vepra të zgj., Vol 4. Tiranë 1987) Por kohët kanë ndryshuar, njeriu po e shfrytëzon tokën marrëzisht dhe po sillet me natyren pa kultur dhe me harbutëri. E prandaj lindin, shkruhen e duhet të zbatohen projekte të tilla për të përmirësuar cilësinë e ujit të ajrit, rruajtur e shtuar gjelbërimin e mbrojtur tokën nga kërcënimet e njeriut dhe faktorëve klimatik.

Përsëri në një nga televizionet private më të fuqishme në Shqipëri Top Channell ishin të ftuar Geraldo dhe Saimiri pikërisht me 6 prill 2018, në emisionin ‘‘Wake Up,, në të cilin u paraqitën mjaft mirë në shpejgimin e përmbajtjes e detyrave që zgjidhte projekti ‘‘Toka e vetmia shtëpi që kemi.,,

Energjitë rinore, puna plote mençuri i ketyre djemve i shtyu ato të kërkonin pjesmarrjen e tyre me projekt në ‘‘Genius Olympiad 2018,, nëNew York të Ameriks.U pranuan dhe konkuruan më 11 Qërshor para një komisioni mjaftë dinjitoz ku u vlerësuan me medalje të argjendt ndër 1285 projekte nga vende të ndryshme të botës.

Pak e njohin në krahinën e Muhurrit, po kaq pak ne Dibrën e Poshtme, djaloshin, të riun Gerardo Hoxhën, i cili konkuron deri në kontinentin Amerikan. Prandaj duhet të njihen të tillë të rinj, që janë modest, të urt, fjalë pak, por që brenda tyre flakërojn energji të pashtershme mendimesh, projektesh. Duhet ta administrojmë, mbrojmë, zbukurojmë tokën tonë si djepi i miliona e miliona jetë njerëzish e miliarda qëniesh të gjalla. Respekt per tokën për njerëzit, e luftë e pandërpre edukimi brezash dhe persosje teknologjike per mbrojtjen e saj.

Shqipëria jonë ka nevojë për nxënës të tillë si Gerardo Hoxha, të cilët dinë të idejojnë e bëjnë projekte cilësisht të mira për mbrojtjen e tokës, mbulesës së gjelbërt dhe mbrojtjen me të gjitha format të saj, si djep të jetës e të prodhimit të të mirave materiale.

Dr. Selman MEZIU

OPINION

A po shkon Shqipëria në krize të rinjsh?

Nga **SAMET ZAGRADI**

Vitet e fundit Shqipëria po përballet me ikjen masive të të rinjve në shtetet më të zhvilluara europiane ndikuar dhe nxitur kjo nga faktorë të ndryshëm ekonomik dhe social. Të rinjtë shqiptarë tashmë të zhgënjyer nga realiteti ku jetojmë preferojnë që të largohen nga Shqipëria sapo atyre tu jepet mundësia e parë pa e menduar atë dy herë. Kjo ikje masive e këtyre të rinjve na bën të rikthehemi dhe të kujtojmë vitin 1990 ku Shqipëria përjetoi eksodin më të madh në historinë e saj fill pas prishjes së sistemit komunist ku në rrugë nga më të ndryshmet njerëzit u shpërndanë ngado.

Ikja e këtyre të rinjve jashtë të shtynë të mendosh se çfarë i shtyn këto të rinj të largohen. Politikat e gabuara të vendimmarrësve , papunësia dhe mentaliteti i ngurtë i detyrojnë këto të rinj të ikin të jetojnë dhe të punojnë jashtë kufijve tona. Rrogat mjaftë të ulta, kosto e papërballueshme, mungesa e kushteve të punës detyrojnë të rinjtë shqiptarë të marrin vendime drastike për veten dhe vendin e tyre.

Edhe përse të rinjtë investuan shumë në shkollimin e tyre vendi dhe politikat e ndjekura gabimisht nuk u lejon atyre qëndrimin apo punësimin në Shqipëri. Eksodi masiv i “trurit” në vendet që ofrojnë kushtet me të mira pune dhe jetese, bën që vendi jonë të humbasë shumë nga çdo shërbim që këto të rinj janë të specializuar të japin. Hemorragjia demografike e shqiptarëve po bën që pasojat të ndihen në shumë aspekte jetësore. Plakja e popullsisë, ringjallja e emigracionit, dëshira për të studiuar apo për të jetuar jashtë ka bërë që të ketë rënie të fortë në numrin e nxënësve apo studentëve në vitin akademik 2018-2019. Në shumë qytete dhe fshatra të thellë të vendit tonë si problematikë e ikjes së të rinjve janë mbyllur disa shkolla me arsyen e mungesës së numrit të nxënësve. Klasat kolektive apo transporti i nxënësve në shkollat më të afërta ka qenë zgjidhja e Drejtorive Arsimore përkatëse. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, numri i regjistruar këtë vit akademik ka qenë 653 mijë persona dhe në krahasim me vitin akademik 2013-2014 janë 134 mijë nxënës të regjistruar më pak. Rënie, sipas INSTAT ka pasur në të gjitha ciklet por më e forta është në arsimin e lartë rreth 34 mijë studentë më pak.

Emigracioni i të rinjve të shkolluar sidomos atyre të shërbimit mjekësor apo mjekëve po dëmton rëndë shërbimin mjekësor në Shqipëri. Sipas të dhënave nga urdhrit të mjekut në tre vitet e fundit janë larguar nga vendi më shumë se 600 mjekë, ku vetëm në vitin 2017 kanë kërkuar referencë largimi 167 të tillë, kryesisht pediatër, ortoped, kardiolog etj. Një numër mjaftë i madh infermierësh po përfitojnë kontrata pune nga spitalet Gjermane duke bërë që spitalet tona të jenë pothuajse pa staf të specializuar mjekësor që sigurisht është një dëm i madh për ne.

Nga të dhënat e Eurostat gjatë vitit 2015-2018 rreth 32 mijë shqiptarë kanë kërkuar azil politik në vendet e Bashkimit Europian. Por për të mos mjaftuar kjo një numër mjaftë i madh të rinjsh shqiptarë janë larguar nga vendi ynë me kontrata pune, studime, me Lotarinë Amerikane, nëpërmjet të afërmve të tyre teksa emigracioni i paligjshëm po shkon deri larg në Australinë e largët. Problemi thellohet më shumë kur mendon se edhe këto të rinj që janë aktualisht në punë apo studime në Shqipëri dita ditës po mendojnë dhe po bëhen gati të emigrojnë për të pasur një jetë më të mirë.

Anglia mbetet një vend mjaftë i lakmuar për një pjesë të madhe të të rinjve që nuk kanë një arsim të lartë. Nuk dihet një numër i saktë i personave që kanë emigruar por me siguri numri është me të vërtetë i lartë. Mungesa e punës detyron këto të rinj të ndërmarrin veprime të rrezikshme për jetën e tyre me qëllim e vetëm për të arritur në shtetin Anglez. Ditë të tëra qëndrimi në Francë apo Spanjë me shpresën e shpëtimit nga kontrolli policor. Ditë-netë të tëra nën kamion duke rrezikuar seriozisht jetën e tyre apo kostoja prej 12 mijë paund që për familjet shqiptare janë një kosto e madhe mbetet zgjidhja apo zgjedhja për tu larguar nga Shqipëria plot halle dhe probleme. Familjet shqiptare duhet të marrin borxhe për të çuar me duart e tyre fëmijët në një rrezik të madh por të detyrueshëm.

Sipas ekspertëve të ekonomisë ikja e të rinjve përbën një problem serioz në uljen e forcës punëtore në kompani, në bizneset e sektorit callcenter në fushën e teknologjisë ku është e vështirë të gjenden profesionistë, inxhinier apo menaxher të fushave të ndryshme. Sektori bujqësor ka rënie të dukshme si rrjedhojë e ikjes së të rinjve duke lënë djerr tokat që ato posedojnë në Shqipëri. Sipas tyre krijimi i vendeve të punës me paga të pëlqyeshme do të jetë një sfidë që nuk ka ndonjë adresim të posacëm nga autoritetet publike edhe për vitin 2018. Edhe për këtë arsye problematikat ekonomike dhe sociale do mbeten të mprehta dhe serioze. Për këtë arsye shqiptarët do të kërkojnë sërish të ikin jashtë për mundësi më të mira .

Shifrat janë të frikshme për një popullsi kaq e vogël sa e jonë. Shqipëria dalëngadalë po shkon drejt një krize për të rinj gjë që si rrjedhojë na çon në plakjen dhe uljen e ndjeshme të popullsisë. Mungesa e profesionistëve që mund të themi janë koka e shoqërisë dhe mungesa e forcës punëtore që janë duar na çojnë të mendojmë se procesi përmirësimit në vendin tonë do të mbetet i papërfillshëm. Në shkollat tona do të shikojmë më pak të rinj të aftë për të arsimuar një fëmijët tonë, po ashtu edhe në spitalet tona do kemi më pak personel të aftë për të marrë shërbimin bazë të nevojave. Përgatitja e një mjeku duhen së paku njëzet vite për tu shërbyer njerëzve dhe ikja e tyre për të punuar diku tjetër do të ishte me të vërtetë një dëm shumë i madh për ne. Bujqësia, blegtoria duket sikur nuk do të lulëzojnë me këto ritme të cilat po shohim dita ditës. Shqipëria nuk do të jetë vetëm në krizë për të rinj por do të mbetet në krizë edhe për fushat e tjera të jetës njerëzore.




Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Botimet M&B dhe Librari Fleta XXI në Peshkopi, në bashkëpunim me Qendrën e Edukimit dhe Komunikimit do të organizojnë në Peshkopi në datat 4-6 Tetor 2018, PANAIRIN E LIBRIT TË AUTORËVE DIBRANË.

PANAIRI I LIBRIT I AUTOREVE DIBRANE

... DHE BOTIMEVE MBI DIBRËN

Gjatë ditëve të Panairit do të ketë promovime librash. E gjithë veprimtaria gjatë këtyre ditëve, në kuadër të Festës së të Vjelave dhe Odës Dibrane është kontribut vullnetar i organizatoravë dhe, në këtë kuadër, është menduar që në një kënd të panairit të vendoset një kuti ku do të mblidhen libra për t'iu dhuruar një shkollë në rrethin e Dibrës



Për porosi: mbbotime@gmail.com ose fletaxxi@gmail.com

Rruga e Arbërit nr. 149

Batakçiu fiton gjyqin

Nga **XHAFER MARTINI**

Njëri i jep një tjetri një shumë paresh borxh. Caktuan edhe afatin kur duhej t'i kthehej shuma të zotit. Ajo ditë kaloi, kaluan dhe shumë të tjera, por huamarrësi nuk po dukej. Huadhënësi i shkon në shtëpi dhe i thotë:

– U bënë gjashtë muaj që kur duhej të më ktheje paret. Jo vetëm që këtë nuk e bëre, por as nuk erdhe ta shtysh afatin, si bën njeriu i ndershëm në këtë rast.

– Nuk kuptoj për çfarë paresh e ke fjalën, – i tha tjetri me një ton bezdisës.

Nuk thonë kot që huadhënësi e ka kujtesën më të fortë se huamarrësi. Po këtu nuk ishte punë kujtese.

– Për ato njëqind lirat që t'i dhashë, kur ti e kishe litarin në fyt, si u shprehe atëherë, – i tha huadhënësi me ironi të dukshme.

Tjetri bëri sikur u mendua; vuri gishtin tregues në tëmthin e majtë dhe po fiqirosej me veten. I dha fytyrës një shprehje habie dhe moskuptimi.

– Paske fjetur keq mbrëmë dhe paske parë ëndërr sikur më ke dhënë njëqind lira. Dhe tashti të duket sikur ajo është ngjarje e vërtetë. Nganjëherë më ndodh edhe mua kështu, por jo të më mbajë aq gjatë sa të shkoj e t'i zë tjetrit derën …Po qetësohu dhe kujtohu se unë nuk të kam marrë pare ty, – tha me një ton të shtruar dhe të qetë, ku në çdo fjalë ndihej siguria.

– Me gjithë mend e ke?!– pyeti huadhënësi i habitur me një zemërim ende të dobët. – Me siguri don të bësh shaka, se nuk besoj të jesh aq i poshtër sa të mohosh paret që të dhashë në ditën më të vështirë.

– Me ëndërrat që shikon në shtëpinë tënde, mos eja të më shqetësosh dhe të më fyesh në shtëpinë time, se, për nur të Pejkamberit, nuk ndahemi mirë bashkë, – i tha prerë zoti i shtëpisë duke i treguar derën.

Huadhënësit i hipi gjaku në kokë dhe nuk e deshi më veten. Një herë mendoi të luftonte për jetë ja për vdekje me këtë të poshtër, por e mbajti veten se e kuptoi se me të rrahura nuk do t'i merrte kurrë paret. Kur po ikte, i tha:

– Mendohu mirë, o batakçi, se nuk jam nga ata që mund t'u mbash paret ti.

Po nuk pati ç'të bënte tjetër dhe iku tek kadiu. Ia qau hallin që e kishte gjetur dhe i dha të kuptonte se, po ta zgjidhte çështjen me drejtësi, një pjesë të atyre parave do t'i merrte kadiu. Vetëm batakçiut nuk donte t'ia linte. "Nuk më kalb dheu, po të më mbajë ai paret", i tha kadiut.

– Ma sill nesër në zyrë borxhliun tënd se bisedoj unë me të.

Po kjo ishte një fjalë goje, se një batakçi si ai nuk shkonte tek kadiu edhe sikur t'i vinin litarin në qafë.

– Kadi efendi, po ti dërgo xhandarët ta marrin, se ai nuk vjen pse i them unë. Do ta njohësh vetë: nuk ka më batakçi se ai.

– Unë nuk kam ndonjë padi me shkrim për të. Ti vetëm thua se të ka marrë pare borxh, por nuk je në gjendje ta vërtetosh me asgjë. Po e kandise të vijë, unë do ta kuptoj se me cilin kam të bëj. Kur të bindem se është, si po thua ti, përdorë mënyra të tjera për ta nxjerrë të vërtetën në shesh.

Huadhënësi i shkoi edhe një herë në shtëpi huamarrësit dhe me një ton të prerë, i tha:

– Për ato paret që më ke marrë dhe i mohon, eja të hahemi tek kadiu. Ky është edhe urdhëri i tij. Vishu e mbathu se jemi për udhë.

– More, nuk do më komandosh ti mua se ku duhet të shkoj dhe çfarë duhet të bëj.

– Të thashë bëju gati se njëra bëhet sot: o vjen tek kadiu, o ta marr shpirtin mu këtu ku je.

Me t'i thënë këto fjalë, huadhënësi i tregoi një fije nga gërshërët që përdoren për qethjen e dhenve. Ajo ishte kamë e vërtetë çeliku, dyzet centimetra e gjatë. E kishte vendosur t'ia fuste në gurmaz dhe ta linte të vdekur në vend. Huadhënësi dukej i vendosur. Ai që nuk e përfill jetën e vetë, bëhet zot i jetëve të të tjerëve. Huamarrësi ishte nuhatës i jashtëzakonshëm. Ai e kuptoi se të keqen e kishte afër, por nuk i vinte të dorëzohej dhe nuk u dorëzua, sepse dredhitë ishin në strategjinë e mosshkuarjes tek kadiu. Tha:

– Unë, derisa nuk të kam asnjë borxh, vij ke kadiu e tek kadiavica, por jam pa këpucë. Këmbëzbathur nuk shkohet para tij.

– Të jap të miat, veç eja.

Huadhënësi nxori këpucët e veta dhe ia dha huamarrësit. Ai i mbathi dhe i erdhën tamam. Por luajti kartën tjetër:

– Nuk kam as xhaketë, se kjo që kam veshur, siç e shikon, është copë – copë. Nuk shkohet me këtë xhaketë tek kadiu.

– Të japë xhaketën time, veç hajde, – i tha huadhënësi dhe qiti xhaketën dhe ia dha.

Huamarrësi veshi xhaketën dhe ajo i erdhi për trupi. Po hilet e tija nuk kishin të mbaruar.

– Me veshje tashti nuk jam keq, – tha, – por mua nuk më bëjnë këmbët të shkoj deri tek kadiu, tri orë rrugë. Mezi çapitem nëpër oborr të shtëpisë. Dëshirë kam, por nuk mund të vij…

E dinte që këmbët nuk mund t'ia jepte huadhënësi, prandaj doli aty. Kuptoi që kishte gjetur diçka që funksiononte tamam, por tjetri i tha:

– Po shkoj të marr kalin, po shiko, mos bësh dredha prapë, se për nur të Allahut, thikën në fyt e ke, do të të ther si berr.

U nis me vrap, pa xhaketë dhe këmbëzbathur e shkoi në shtëpi të vetë. U vesh e u mbath, bëri gati kalin dhe sosi me vrap në shtëpi të batakçiut. Ky nuk bëri më naze, hipi në kalë dhe u nisën.

Ndërsa huadhënësi hyri në zyrën e kadiut, huamarrësi ende ishte në rrugë. Ai e kishte marrë javash. Zbriti nga kali dhe e lidhi atë pas një peme aty në oborr. Mori jonxhën e butë nga samari dhe ia vuri kafshës para. Kali filloi të hajë dhe "i zoti" e përkëdhelte me kaq dashuri sa nuk ka nënë që e përkëdhel të birin. I afroi kokën tek jelet dhe e përqafoi. U nda nga kali si me një njeri të dashur, të cilin nuk do ta shikonte më kurrë dhe ngjiti ngadalë shkallët për të hipur tek zyra e kadiut. Kadiu i kishte vënë re veprimet e këtij njeriu dhe priste të kuptonte "ç'mall ishte". Dera ishte gjysmë e hapur, se bënte vapë e madhe, por ai, për respekt, trokiti lehtë. Veç kur kadiu i tha "Hyr!", kapërceu pragun. Nga veprimet e ngadalta dhe si të qëllimshme, dukej si një aventurier katundi, si njeri mosbegenisës, por me përshëndetjen "Mirëdita, zoti kadi!" e me qëndrimin e matur në çdo gjë, e paraqiti veten me dinjitet, si një njeri që vetëm një ndërlikim rrethanash e ka çuar në dyert e drejtësisë, prej ku, si tregonte shprehja e fytyrës së tij, do të dilte faqebardhë, mbasi ishte në të drejtën e Zotit. Qëndroi në këmbë në pritje të fjalës së kadiut dhe nuk u ul "bëlldum" në kolltukun e lirë, si bënin ca kokëtrashë të tjerë. Huadhënësi ishte ulur në kolltukun tjetër, përballë, dhe priste me padurim të fillonte "beteja", të cilën nuk e parashikonte të vështirë, pasi ky njeri, sipas tij, i kishte shumë të qarta shenjat e batakçiut dhe se kadiu do ta "ta zbërthente" shpejt.

– Ulu, ulu, – i tha kadiu duke treguar kolltukun bosh dhe duke e vështruar me vëmendje të sapoardhurin.

Nuk e kishte paracaktuar se si do të sillej me këtë njeri: si me një batakçi, si me një horr që mohon huanë që ka marrë, apo si me një njeri të ndershëm që i kanë rënë në qafë. Me të parë e me të bërë, tha me vete kadiu dhe iu drejtua huadhënësit:

– Çfarë pretendimesh keni ju ndaj këtij personi?

Ai tha se një vit më parë ky burrë që tashti po rrinte i qetë në kolltuk, i kishte kërkuar hua njëqind lira dhe ai ja kishte dhënë. Duhej t'ia kthente pas gjashtë muajsh, por ai nuk u duk fare. "Ky, – vazhdoi akuzuesi, – jo vetëm nuk m'i ktheu paret në afatin e caktuar, por nuk erdhi as të më thoshte t'ia shtyja afatin, se njerëz jemi, nuk do ja vemë tjetrit litarin në fyt. Por ajo që më habiti e më tronditi pa masë dhe më bëri të vij këtu është se, kur i shkova në shtëpi dhe i kërkova shpjegime për sa thashë, pati pafytyrësinë të thoshte se nuk më kishte marrë pare. Ja, kjo është e gjitha, zoti kadi".

– Qartë, qartë, – tha kadiu dhe ia nguli sytë huamarrësit. – Po ti ç'ke për të thënë për gjithë këto që dëgjove?

– Kadi efendi, – filloi të flasë ngadalë i akuzuari. – Këtij personi nuk i kam asnjë borxh. Jam gati të betohem me njëzet e katër vetë përmbrapa, sipas zakonit, po qe se ky kërkon zgjidhje kanunore. Por, meqë më solli tek zotëria juaj për zgjidhje ligjore, unë jam gati ta mbroj veten dhe ta nxjerr kundërshtarin tim në rrenë… Më falni, zoti kadi, për shprehjen e fundit, se ky burrë nuk është rrenacak, përkundrazi njihet si njeri i ndershëm në gjithë katundin. Nuk ka njeri me mend në kokë të flas një fjalë të keqe për të…

Kadiut, deri në atë çast, nuk i kishte ndodhur që i akuzuari të fliste mirë për akuzuesin e tij.

– Meqë ky njeri është burrë i ndershëm dhe i drejtë, si the vetë, pse duhet të të bjerë në qafë? – e pyeti kadiu atë.


– Kjo, sipas meje, e ka një shpjegim. Ka disa muaj që ky njeri ka lajthitur. Ashtu si është sjellë me mua, vetëm një i çmendur mund të sillet, vetëm i çmenduri ngrihet një mëngjes dhe të vjen në derë me hanxhar në dorë dhe të kërkon njëqind lira që thotë se ja ke marrë… Kur ti i thua se nuk i ke asnjë borxh, nxjerr hanxharin dhe të vë para e drejt e tek kadiu. Unë nuk erdha me dëshirën time para jush, por më detyroi, le ta thotë vetë, nëse i ka mbetur një fije logjike.

Kadiu i hodhi një shikim huadhënësit sikur donte ta pyeste: është e vërtetë kjo që po thotë ky apo jo?

– E kam sjellë me zor, zoti kadi, si do ta shpjegoj më vonë.

E mori prapë fjalën huamarrësi që ishte i akuzuar:

– Shkurt fjala, zoti kadi, ky ka lajthitur dhe prej marrëzisë i bën të gjitha. Por, sidoqoftë, jeni ju ai që do ta ndani të drejtën dhe që me siguri do të vërtetoni këto që thashë unë.



Huadhënësi u prek kaq shumë nga fjalët që sapo tha huamarrësi, sa grafulloi si qumështi në zjarr dhe hovi përpjetë, u ngrit në këmbë dhe i foli kadiut jo me fisnikëri dhe respekt si kundërshtari i tij, por me harbutëri:

– Zoti kadi, mos e lejoni këtë batakçi të poshtër të përrallis në këtë mënyrë. Ky është i pafytyrë, i pander dhe pa burrëri, këtij nuk i skuqet faqja për asgjë, pasi në damarë nuk ka gjak të kuq, të pastër, por ka qelb.

U bë një heshtje e shkurtër e nevojshme për kadiun, pasi nuk dinte si të vepronte. Ky gjyq ishte pesë me hiq në krahasim me shumë të tjerë që ai i kishte përballuar me sukses, por në disa tregues ishte më i vështirë. Për të parën herë tek i akuzuari shihte të mishëruar ëngjëllin. Kadiu vendosi të ruante gjakftohtësinë dhe të tregohej i paanshëm, megjithëse, i jepte më shumë të drejtë të akuzuarit se sa akuzuesit. Iu drejtua edhe një herë atij që konsiderohej huamarrës dhe e pyeti:

– Keni gjë për të shtuar?

– Kadi – efendi, më falni, por ky i lajthitur, kështu si e ka nisur, mund të thotë që edhe këpucët që kam mbathur janë të tijat.

– Pse, nuk janë të miat këpucët, mor i poshtër?

I akuzuari ruante gjakftohtësinë dhe nuk i dha përgjigje për pyetjen që iu bë. Vështronte nga kadiu sikur donte t'i thoshte: "Ju thashë unë, kemi të bëjmë me një të çmendur". Po me gojë tha tjetër gjë:

– E shikoni, zoti kadi, ky tashti mund të thotë që edhe xhaketa që kam veshur, është e tija.

– Edhe për xhaketën do të thuash se nuk është imja?! – tha me pëllitje akuzuesi duke nxjerrë bashkë me frymën dhe fjalët grimca të shumta pështyme që iu përplasën kundërshtarit në fytyrë.

Huamarrësi, që zotëronte një qetësi të admirueshme, nxori me kujdes nga xhepi i xhaketës një shami të bardhë, të pastër, dhe fshiu me të grimcat e pështymës që i lëshoi akuzatori i tij. Pasi futi shaminë në xhep, iu drejtua kadiut dhe i tha:

– Zoti kadi, më falni, por me këtë krizë që ka kapur akuzuesin tim, duhet të bëheni gati të dëgjoni që edhe kali, me të cilin erdha deri këtu, është i tij.

– I poshtër!– nuk u përmbajt fare huadhënësi dhe brofi në këmbë t'ia fuste kundërshtarit duart në fyt. – Edhe kalin don ta bësh tëndin!?

Ai donte ta kapte nga jakat e xhaketës mashtruesin, t'ia shtrëngonte rreth qafës dhe ta linte të lirë vetëm kur të jepte frymë. Kështu e meritonte një njeri i pacipë si ai. Po tjetri, përkundrazi, rrinte i qetë, me një buzagaz të lehtë në fytyrë, i dëshiruar që kundërshtari ta kapte për fyti ndër sy të kadiut, që ky, më në fund, ta kuptonte se kishte të bënte me një të çmendur… Po nuk qe nevoja se, edhe pa bërë atë veprim, kadiu i tha akuzuesit:

– Ti vërtet qenke i çmendur!Paguaj gjashtë lira për akuzë të rreme dhe mbathja saora që të mos urdhëroj të të fusin në burg.

Pastaj i hodhi një shikim të akuzuarit dhe i tha me qetësi:

– Jeni i lirë.


(Marrë nga libri "Kanuni i Dibrës", Botimet M&B, Tiranë, 2016.)

Shkrimtari i fshatit tonë

Nga **AGRON TUFA**

A sokohe më pati përpirë kureshtja për shkrimtarin e fshatit tonë. Nuk kishte botuar ndonjë libër dhe, me sa duket, as kishte për të botuar ndonjëherë, sepse i përkiste një shtrese të deklasuar. Kjo shpjegonte gjithçka, por fakti që nuk kishin për t'i botuar kurrë, nuk e shkurajonte shkrimtarin tonë: ai shkruantë, siç thoshnin, vazhdimisht. E kjo ma ndizte edhe më fort imagjinatën, ndaj nuk ngopesha duke e parë... jo atë vetë, por më saktë, diç që fshihej përtej tij, apo më saktë - përthellë tij.

Kishte dy sy të kaltër, tepër të mëdhenj, të mos themi të shqyer (nga habia a nga ndonjë ndjenjë tjetër), një trup të lidhur, shpatullgjerë, krahë leshatakë e muskulozë, a thua ta kishte gdhendur vetë Mikelanxhelo, ndërsa flokët, të verdha e me krrela si susta, i rrinin mbi kokë si brerore. E mban mend gjithë fshati çfarë tmerri shtinë vikamat e hakërrimat e ndërkryera të tij kur deshën t'ia qethnin me përdhunë atë kurorë kaçurrelash! Të shokuar, grupi i "të fortëve" që ia mbërriti pas propagandës fshatçe mbi shfaqjet e huaja, u shpërnda si tufë zhgabash kur pret të cofë ndonjë kafshë e plagosur.



- Epo lëre halenë, t'i mbajë vakëf, gjersa ta tërheqin rrëshqanë në Degën e Punëve të Brendshme! – tha sekretari i Partisë, një meit i mbaruar me emrin e shkurtuar "shoku Kuk".

Nuk e dinim me saktësi se çfarë shkruan shkrimtari ynë, Kiu, dhe shumë vonë mësova se emrin e kishte Haki. Kur u martua, Kiu ndërtoi një shtëpi përtrollëz me qerpiçë prej balte, disi të shmangur nga lagjja dhe shpinëkthyer fshatit. Natyrisht, shtëpinë e tij e rrethoi me gardhe të dyfishta me thupra të larta e tela, mbolli pemë në oborr dhe hapi vetë një pus. Për një farë kohe arrita të jem ndër të vetmit që lidha nja dy fije të kalbëta miqësie me Kiun, por s'ma mbante të rrija shumë gjatë vetëm për vetëm me të: sytë e tij shndrisin prej njëfarë etheje të kaltër çmendurie, bëheshin të lëngshëm nga lot djegës, por shumë shpejt ndërronin, zbuteshin, madje edhe qeshte, duke shpaluar ca dhëmbë të fortë, të mëdhenj e të rregullt, si krëhera fishekësh.

Kiu dilte rregullisht në punë bashkë me nusen e tij të re, të ardhur nga një fshat e i largët midis Dibrës dhe Kukësit, nga një familje e prekur. Gjithmonë punonin bashkë dhe gjithmonë dilnin e ktheheshin bashkë në shtëpi, gjerkur do t'i lindnin njëri pas tjetrit fëmijtë dhe Kiu të dilte në kooperativë i vetmuar, i heshtur, si një jetim. Shumë pak kujt i jepej të ndërronte ndonjë bisedë të sipërfaqshme me Kiun, edhe në ato raste, e kam ndjerë se njerëzit që shtyheshin t'i flisnin, e bënin jo nga dëshira, por o nga kureshtja e kontaktit me një të çmendur, o nga dëshira perverse për t'u tallur, sikundër kishte dhe raste që e provokonin të fliste kundra Partisë. Por, siç e thamë, Kiu ishte shkrimtar dhe nuk ua zgjaste shumë, duke u thënë shkurt: "Hajt, thyeni qafën, injorantë, hafije! S'ia ka kujt nevojën Kiu, atij i mjafton vetvetja".

E mbaj mend se si kthehej i rraskapitur nga puna bashkë me të shoqen dhe e imagjinoj tani sfidën që i bënte ai njerëzisë. Pas një dië ditë të rëndë pune, për shembull, prashitje misri ku norma me kultivator ishte 800 m katror dhe pa kultivator – 400 m. Në pushimin e drekës, pasi lahej e freskohej ndanë pusit, ndërsa gruas së tij i binte bretku duke u marrë me punë të ndryshme shtëpi, Kiu-shkrimtar, tërhiqej si një viç i ngazëllyer në njërën nga dhomat e posaçme dhe merrej me krijimtari.

Kështu bënte pranverës, verës, vjeshtës dhe akoma më fort kur zinte dëbora e dimrit. Ne gjithnjë, sa shihnim tymtarin e çatisë në shtëpinë e veçuar të të tij, thoshim: "Ja dhe Kiu atje... ndërsa ne luajmë futboll, ai shkruan". Po çfarë shkruante shkrimtari ynë, i tërhequr në shmang nga njerëzia? Për inat të kujt? Shumë kohë kam ëndërruar se Kiu i mbyllur po bënte hatanë, se njerëzit e fshatit tonë të madh do të krenoheshin me të, lapangjozët e provokatorët të plasnin nga zilia, ndërsa të tjerë që e kishin nënvleftësuar Kiun, do të vinin t'i binin ndër këmbë duke derdhur lotë të nxehtë pendimi mbi çizmet e tij të përbaltura. Dukej se heroi im shkrimtar as ia kishte ngenë se ç'mendonin të tjerët për të. Njëherë, teksa brigada e tij po hapte një kanal ujësjellësi, iu turr brigadierit me lopatë në dorë, deri sa e zuri dhe këputi në dru, duke shfryrë: "Mos guxo të marrësh nëpër gojë të parët e mi, ti, dhëmbëkrimbur, se s'ka kandar që na barabit me racën tuaj. Unë jam shkrimtar, kurse ti – qelbanik!"

Shumë kohë më vonë, familja e shkrimtarit u shpërngul, si shumë familje të tjera, por nuk qeshë interesuar se ku ishin zhvendosur. Ndoshta kishin emigruar në ndonjë shtet perëndimor tek të afërmit e arratisur.


Megjithatë rasti do ta sillte disa vite më parë, të njihesha me një "kryevepër" të Kiut. Në një shtëpi botuese jo aq të njohur, më dhuruan një libër voluminoz me autorësinë e tij, me titull të çuditshëm: "Kryqi, Kuku dhe Kukura". E hapa librin sa ktheva në shtëpi, i përfshirë nga një mister i lashtë që s'më kishte lëshuar gjithë jetës. Libri ishte historik dhe përfshinte një periudhë trembëdhjetëmijë vjet para Krishtit gjer në ditët tona. Ishte një libër për fisin e tij. Po ç'mund të thoshte shkrimtari ynë Kiu për një periudhë aq të errët? Kiu vetëm me tetëvjeçare? Kiu që nuk lexonte libra? Ndërsa lexoja paragrafët, faqet, kapitujt e atij libri të vëllimshëm, mendja bridhte paralel në vitet e një varfërie dhe rraskapitjeje të madhe kur Kiu, si një luan i plagosur, tërhiqej në strofkë dhe merrej me lëpirjen e plagëve të veta. Shkruante duke iu kundërvënë gjithë njerëzisë jashtë derës së tij, hymnizonte fisin e vet të lavdishëm me bëmat e një kohe të parrokshme nga asnjë kujtesë, krijonte identitetin e tij, të ndryshëm nga masa prozaike e fshatarëve dinakë. Ja si e realizonte kundërvënien e madhe shkrimtari i fshatit tonë, Kiu, i mbyllur me vite të gjata në dhomën e tij, pas një pune rraskapitëse në kooperativë:

"...Kur erdhi në këto vise i pari i fisit tonë, Kuku, ka qenë viti 13000 para Krishtit (lëvdue qoftë!). Pati kaluar një fëmijëri jetime qysh kërthi, i braktisur nga prindër e të afërm, pasi në atë vis të Trakisë kishte kaluar një nga fiset e forta hetite dhe pati shuar me zjarr e hekur gjithë çfarë gjallonte asaj ane. Fëmija ishte më pak se dy vjeç dhe duke kërkuar bar e rrënjë për ushqim, u fut thellë në pyll. Një ditë drejt tij u avit një arushë e vogël, si një topth leshi. Kuku e përqafoi, ndërsa arusha e vogël e lëpiu në fytyrë. Gjithë paradites ata lozën bashkë, gjersa i zuri gjumi të përqafuar në lëndinë. Në mbrëmje ai e pa veten në një shpellë, duke ndjerë mbi vete vështrimin e dy syve të butë e të dhembshur. Ishte e ëma e arushës së vogël. Gjatë gjithë asaj vere e vjeshte, arusha e madhe e ushqeu Kukun me qumështin e saj, e rriti njësoj si këlyshin e vet. Kështu u rrit Kuku, mes natyrës së pakufi me mëmë-arushën dhe motër – arushën e vogël, gjersa një ditë, zëri i të parëve do ta thërriste për ripërtëritjen e genit të shuar. Sa e sa hëna, sa e sa diej këmbeu Kuku në udhëtime të gjata, gjersa mbërriti në një vend të bukur që përshkohej nga një lumë i madh: ishte fusha e Kastriotit. Kuku atëherë ishte dy metër e gjysmë i gjatë dhe me një bri në ballë. Për dy-tre ditë ai arriti të ngrinte kullën më të lartë në atë krahinë, për çka njerëzia erdhën, e përshëndetën dhe i uruan mirëseardhjen, duke e quajtur, për nder të viseve nga vinte, Kuk Traka.

Kuku ishte një njeri me fuqi mbinatyrore dhe një luftëtar i pashoq në trimëri. Thonë se fuqia e mendimeve të tij ishte aq e madhe, sa njerëzit përreth tij shihnin me sy se si shtilleshin përreth kokës së Kukut shiritat e mendimeve. Vendasit ia kishin drojen të ardhurit dhe energjisë së tij të brendshme, prandaj përpiqeshin me sa mund t'i largonin gratë dhe vajzat e tyre kur ndihej se po kalonte andejpari Kuku. Njëherë Kukut i ra rruga të kalojë nga kroi i fshatit. Gratë që mbushin enët dhe lanin u ndanë në dy rreshta për t'i hapur rrugë Kukut. Teksa kalonte midis rreshtave të tyre, Kuku ua shtiu sytë me rend nuseve, grave e vajzave të fshatit, dhe vetëm me atë vështrim, i la të gjitha me barrë...".

Libri vazhdonte në këtë frymë, gjithnjë duke u rënduar me ngjarje që vetëm historike nuk mund të ishin. Në çdo rast tjetër, do të shkulesha se qeshuri, do të zbavitesha jashtëzakonshëm, por, ndryshe nga ç'mund t'i shkaktojë kjo lexuesit të panjohur që nuk e ka njohur shkrimtarin e fshatit tonë, Kiun, unë ndjeva të më shkapetet si një bojë e zezë nëpër gjak, trishtimi. Pikëllimi prej një vepre të tillë, ngase e dija që ishte krijuar në rrethana të caktuara nga një njeri i pashkolluar që i kundërvinte gjithë botës përjashta, shkrimtarin.

(Marrë nga libri "Thembra e Akcilit", Botimet M&B, Tiranë, 2016)









Xhaketa e Aliut

RAMIZ GJINI

Është ditë e hënë. Ora shënon tetë e mëngjesit dhe kafeneja e Lal Pogës ende nuk është hapur! Zakonisht Lala çel në orën shtatë, por hajde merre vesh pse sot e ka thyer këtë rregull. Tani sapo erdhi edhe Aliu dhe u bëmë gjashtë vetë që presim të hapet dera e lokalit. Jemi ngulur përballë tij dhe pyesim njëri-tjetrin: di gjë ti Servet, ç'ka ndodhur me Lalën, që sot nuk ka çelur si gjithëherë në orar? Si i thua kësaj vonese ti Lavdosh? Po ti, Pëllumb, si e shpjegon këtë hata? Mos ndoshta Lala ka dhënë berihanë qysh dje, që nuk do të çelë sot dhe ne, që nuk dimë gjë prej gjëje presim kot së koti? Përse Lala nuk ka vendosur të paktën një copëz letër-lajmërim në derë?

Të gjithë ngrenë supet; nuk ka as edhe një lajm, që të marrim vesh pse ende nuk është hapur porta e strofullës sonë të përditëshme. Dhe kjo, sigurisht, që është një hata e madhe për ne të gjithë, sepse kafen dhe muhabetin ne i kemi mu si frymëmarrjen. Ku të shkojmë tani? Ku të mbytemi?

Kësisoj, ne bëjmë një farë kuvendi duke hamendësuar ngjarjet që mund të kenë përfshirë të zotin e kafes, Lal Pogën. Kuvend i thënçin sepse me thënë të drejtën nuk ecën hiç. Janë thjeshtë hamendësime që bëhen në këmbë, në mes të rrugës, pa pikë lezeti. Sepse ne, që ta dini ju, jemi mësuar me muhabet rrafsh në tavolinë; muhabetin ne e kemi lojë bigjozi ku për orë të tëra fjalët hidhen e kërcasin si gurë dominoje. Ndërsa presim e presim, na duhet se s'bën t'i mveshim një arsye mungesës së Lalës.

Mos është sëmurë dhe e kanë çuar natën me urgjencë në spital?! Po si ndodhi, xhanëm, që u sëmur?! Ai dje ishte shume mirë. Piu konjak bashkë me ne si dhe hëngri shtatë petulla bajagi të mëdha. Madje edhe u llafosëm një çikëz me të për shkak se në fletoren ku mban shënim lojët që bëjmë me letra, pati shënuar rrufjani dy lojë më tepër. Ne sigurisht e paguajmë për çdo lojë që bëjmë, por jo të na e hedhë e të na marrë për budallenj. Edhe pse betohej që ishte i saktë me shënimet e tij, ne nuk i besuam. Si t'i besonim kur e dinim mirë sa lojë kishim bërë? Ju nuk e njihni çfarë mashtruesi është Lala. Kurse ne e njohim atë mu siç njohim xhepat tanë. Dhe nëse është sëmurë, mirë t'i bëhet... Por ndoshta nuk është sëmurë. Sepse ka qindra rrethana e shkaqe të tjera, që mund ta kenë detyruar Lalën, që sot të mos çelë në orarin e përditshëm. Ndoshta ka rënë të flejë në një orë të vonë dhe nuk është ngopur ende me gjumë; ndoshta është vonuar autobuzi që i merr fëmijët për t'i dërguar në shkollë; ndosha mund të ketë humbur çelësat e kafenesë, nuk mban mend ku i ka lënë dhe po i kërkon; ose ka pasur ndonjë bujtës mbrëmë dhe i ka ardhë zor ta përcjellë në pikë të mëngjesit. Ec e merre vesh çfarë ka ndodhur me Lalën!

I vetmi që nuk flet është Aliu. Është ulur kacipup rrëzë murit dhe rri në heshtje mu si ai njeriu, që i di të gjitha dhe nuk ka nevojë të dëgjojë e mësojë asgjë. Xhaketën që vesh përditë, sot nuk e ka në trup. E ka lënë në shtëpi qysh dje në mesditë, pasi qe ngrohtë kur doli i veshur vetëm me trikon e hollë prej pambuku dhe u nis të shkonte në qytet për të marrë pasaportën e re. Nga e vona i pati telefonuar të shoqes e i pati thënë se qe rrekur shumë duke bredhur lart e poshtë dhe se atë natë do të flinte në hotel pasi nuk kishte mundur dot ta kapte autobuzin e orës së fundit. Tani që është veshur hollë, flladi i mëngjesit e bën të tkurrë supet e të mblidhet kutullaq nën vehte. Duket shumë i lodhur, sytë i janë vokur dhe qepallat i janë rënduar. E pyesim:

- Di gjë ti, Ali, përse nuk ka çelur ende Lala?

Aliu kruan një herë fytin, luan nga vendi e disi i mikluar, gjithë përtesë thotë:

- Përse më pyesni mua? Lala do të vijë... Do presim edhe ca kohë, sa t'i hajë rruga dhe veç kur ta shikoni këtu...

- Cila rrugë?! - habitemi ne. - Sepse zakonisht ai çel në orën shtatë, kurse tani ora vajti tetë...! Sa kohë, mendon ti i duhet Lalës të vijë që nga shtëpia e tij, e cila nuk ndodhet më shumë se dy litarë kali larg?

- Do të vijë që nga Dodona, - thotë Aliu. - Mbrëmë nuk ka fjetur në shtëpi. Ka qenë i ftuar te motra e tij në Dodonë.

- Nga e di ti, Ali, që Lala nuk ka fjetur mbrëmë në shtëpinë e tij? - e cytim ne edhe më tej.

- E-huuu...! – nervozohet Aliu. – Ju e dini mire nga e di unë...

Sytë e tij gjysëm të përgjumur, shkartisja deri në kufinjtë e kotjes dhe lëvizjet e tij të rralla e të plogështa na japin të kuptojmë, qe mbrëmë Aliu nuk ka vënë gjumë në sy. Ndaj rrimë dhe e kqyrim me një dhimshuri të shtirur mu si të qe një krijesë në pikë të hallit. Kurse Aliu buzëqesh me zoritje, lëviz kokën si të dojë të thotë "s'po më lini rehat", mbyll sytë e kotet i mbledhur galuc nën vehte në pritje të vijë Lal Poga e të hapë kafenenë. Por ne nuk e lëmë.

- Ali, - e ngucim sërish, - Na thuaj drejt si të shkoi nata mbrëmë? Sa herë ja kërkove thesaret asaj? A e vole, zhvoshke dhe shkërmoqe mirë? A ia thithe krejt nektarin e ëmbël të buzës...?

Aliu buzëqesh. E di që nuk ia kemi me të keq. Thjeshtë e gicilojmë me fjalë, bëjmë shaka me një të vërtetë, që e dinë të gjithë.

- Lëre-lëre, - dorëzohet më në fund Aliu. – Mbrëmë jam bërë për spital. Ajo shejtane nuk ka të ngopur... Por edhe unë nuk ngopem me të gjithashtu...

Pas këtyre fjalëve, e qeshura jonë gjëmon si dallga kur rreh një breg shkëmbor. Bashkë me ne qesh edhe Aliu, i kënaqur që më në fund kurioziteti ynë është fashitur në të njëjtën kohë me shkulmin e gazmendit, dhe se pas kësaj, nuk ka më vend për të tjera pyetje giciluese.

Ndërsa rrimë e presim Lalën të vijë e të hapë kafenenë, minutat kalojnë e padurimi ynë shtohet edhe më tepër. Atëherë nisim e hedhim romuze në adresë të Lalës. E shajmë ndyrë me rroc e koc me një gjuhë gazepe, nuk lëmë fjalë pa thënë. Tekembramja e lëmë në shmang Aliun dhe teksa folim me zë të vogël, marrim nëpër gojë gruan e bukur të Lalës, atë sykaltrën me gjoksin e kërcyer e korpin krekcar, me shpresën se asnjëri nga ne nuk do t'i fryjë më pas në vesh Lalës për ndyrësitë që nxjerrim nga goja.

Tekembramja i japim karar muhabetit, që vetëm Aliu i vjen hakut Lal Pogës, vetëm ai dhe askush tjetër ia bën paq; prandaj Lala do të bënte mirë të shkonte e të flinte më shpesh te motra e tij në Dodonë.

I mbledhur galuc aty rrëzë murit, Aliu ka nisur të kotet. Ne duam ta ngremë prej aty, ndaj i thërrasim; në fillim me zë të vogël, pastaj gjithnjë e më fort; një herë, dy, tre... Aliu nuk përgjigjet. E tundim nga supet, i themi të shkojë në shtëpi e të veshë xhaketën sepse do të bëhet kallkan prej të ftohtit. Por ai, rras duart në mëngët e trikos së hollë prej pambuku, kutullohet edhe më tepër nën vehte, nëpërdhëmb përgjumësh e thotë:

- Jo tani, jo... Edhe pak dhe vjen Ai e hap kafenenë...


Tek-tuk, në rrugë shikohet ndonjë kalimtar, që nxiton kushedi për ku. Qielli është murrëtyer, duket si një mapë e lagur e nderë skaj më skaj. Jemi në të hyrë të vjeshtës dhe moti po ndryshon çdo ditë e më tepër. Mëngjezeve fryn një rribë e ftohtë ere. Shumë shpejt mund të nisë ndonjë shtrëngatë shiu dhe po nuk erdhi të çelë Lal Poga, do na duhet të nxitojmë për të gjetur tjetër strehë ku të futemi.


Ora tashmë shënon tetë e tridhjetë minuta dhe padurimi ynë ia ka lënë vendin një lloj nervozizmi qesharak. Romuzet dhe sharjet në adresë të Lalës janë bërë më të thekura. Hamendësimet, gjithashtu qesharake. Tekevona, Aliu, nuk i ka rezistuar dot më tepër thëllimit të mëngjesit. Eshtë përmendur nga kotja dhe është ngritur në këmbë disi hutueshëm. Çuditërisht, tashmë edhe ai duket i nervozuar. Bën dy tre hapa, ndalon, kthen kokën andej nga pritet të vijë Lal Poga, mërmërit vetmëvete nëpër dhëmbë dhe shkon e zë vend sërish aty ku ishte më parë.

- Si dreqin u vonua kaq shumë ky, - kërcen e thotë më në fund i nervozuar Aliu.

Nervozimi i tij na habit të gjithëve. Pyesim vehten si ka mundësi, që Ali durimtari, më i urti, paqësori, ai që i di të gjitha dhe që nuk ka nevojë të dëgjojë e mësojë asgjë, nis e nervozohet për vonesën e Lalës?!

Pikërisht ato çaste, shfaqet në rrugë Lal Poga. Silueta e tij sa vjen e afrohet. Ne shquajmë si avitet i zgërlaqur e me hapa të përtuar. Duket ashiqare, që është shumë i lodhur. Ashtu si Aliut, edhe atij, sytë i janë vokur dhe qepallat i janë rënduar nga pagjumësia. Nëpërdhëmb kalimthi një "mirëmëngjes", fut dorën në xhepin e pantallonave, nxjerr celësat, hap portën e kafenesë, dhe vetëm kur ndodhet përballë pasqyrës së vitrinës prapa banakut, vë re se si, në nxitim e sipër, gabimisht ka veshur xhaketën e Aliut.







printime dixhitale
DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Funeral

Fragment nga romani

Nga **ARTAN GJYZEL HASANI**

Maries iu duk vetja edhe më lakuriq kur veshi xhubletën. Ngjeshi kraholin e Korbës dhe ndjeu t'i përvëlonin gjinjtë e thithat t'i forcoheshin. Xhubleta po i rëndonte sikur nga çasti në çast do i rrëshqiste nga trupi. U mbështet në anë të oxhakut dhe zgjati dorën drejt buzëve të Nana Uranës. Ia mori cigaren dhe e thithi thellë me afsh. Preku barkun dhe mbylli sytë. Iu shfaq Marko. Lakuriq dhe i sapodalë nga prushi. Lëvizi me vështirësi urët e djegura, doli nga oxhaku zvarritur, ia vuri duart në bel, ia uli dhunshëm xhubletën dhe, pasi afroi trupin e saj të vogël pranë fytyrës, ia puthi butë kashmirin dhe ajo rënkoi.

Kur e nxori tymin, Marko ishte zhbërë.

Nana Urana ndezi një cigare tjetër.

Një çast më pas Maries iu duk vetja shumë e vogël brenda xhubletës. E vogël si një zog brenda kështjellës ku nuk banon më njeri.

Nana Urana, si quhej i ati i Markos?

Martin.

Sytë e Maries kërkuan Markon mes urëve të zjarrit. Kur nuk e gjetën, u drejtuan nga Nana Urana. U zmadhuan, u shqyen, diçka ra prej tyre dhe plakës iu duk sikur dy lakuriqë nate fluturuan jashtë zgavrave duke i lënë bosh kangjellat e syve…

Pa folur asnjë fjalë Maria u vërsul drejt derës së madhe dhe iu ngjit përpjetë shtegut që çonte për te shkëmbi ku dikur ngrihej shtëpia e Korbës. U kacavjerr mbi shkëmbin dhe kur arriti mbi të, qëndroi e shtangur, pothuajse e padukshme mes xhubletës së rëndë, me kokën e varur në gjoks, krahët e hapur dhe kraholin e zbërthyer.

Kishte dashur vallë ndonjëherë Marko të gdhendte një xhubletë në gur?

Poshtë, nën gjinjtë e saj të vegjël, si një fëmijë shtrihej Kullnaja. Aq e vogël mes thithkave. Ushqyer me qumësht mjegullash.

Vetëtiu. Më pas një gjëmim që Maries i erdhi në vesh si e qarë fëmijësh.

Ngriti kokën drejt qiellit. Ishte aq afër tij, sa ai e humbi kuptimin. Dhe ajo e puthi.

Edhe qielli i ngjasoi me një foshnje. Të plakur nga vitet e të vdekurve. E puthi prapë. Prapë. Sa më shumë e puthte, aq më shumë shëmtohej e plakej foshnja. Dikur buzët nuk iu bindën dhe u rrëzuan mbi njëra-tjetrën si dashnorë të lodhur. Papritmas syri mavi i gojës u hap dhe Maria volli. Një lot stërmadh ngjyrë gjaku u përplas në qerpikët e bardhë të dhëmbëve dhe foshnja e plakur u thinj krejt. Nuk kish qenë lot, por kambanarja e thyer e zemrës. Maria volli edhe katedralen e fundit të shpirtit ku ruante librat e shenjtë, nën vështrimin gjithnjë e më të egër të foshnjes plak të shëmtuar. Kur nuk kishte çfarë të nxirrte më ndjeu një uri të tmerrshme. E gëlltiti ishqiellin.

Dhe si për ta mëshiruar, të papërtypur.

Klithma në fillim u përplas mbi kataraktin duke trembur troftat e kuqe që përpiqeshin t'i ngjiteshin rrjedhës. U përplas pas shkëmbinjve, u derdh ndër mriza e rudina dhe pushtoi tërë bjeshkën si një e qeshur e stërmadhe. Pastaj u kthye në një kujë të cilën e mori me vete një korbë që për një çast humbi mes mjegullës dhe pastaj e lëshoi gjahun e saj mbi Kullnajën.

Kur preku dëborën, klithma ngriu.

Maria ndjeu një zhurmë të llahtarshme brenda kokës, ku mijëra korba uleshin e ngriheshin mbi urët e djegura të trurit, në një krokatje që u ngjante zërave të njohur, pa e lënë të qartë nëse kishin frikë se do nxiroseshin më keq a do të përzhiteshin…

Mendja është oxhaku i shpirtit, Mariaaaaa … Mariiiiii… Mar… ko… Mar… tin… oh ç'marri…

Ndjeu zjarrin t'i digjte gjuhën. Flaka i lëpiu krejt gojën, i puthi buzët dhe nga sytë morën udhë ca fjolla tymi. Të bardha.

E zhveshi xhubletën, kraholin dhe ashtu, lakuriq, hyri nën ujërat e kataraktit. Zjarrmia u shua dhe ajo mori kokulur dhe e qetë shtegun drejt derës ku e prista Nana Urana me një cohë të bardhë në duart. U fshi, u ngroh një copë herë pranë oxhakut, veshi fustanin dhe para se të largohej, ndaloi te pragu. Deshi të thoshte diçka, por nuk mundi. U përpoq përsëri. Gjuha gjarpëroi mes qiellzës në kërkim të fjalës, por nuk gjeti asgjë. Asgjë veç një rënkimi që Maria ia drejtoi plakës si një përshëndetje lamtumire.

Mjekët thanë që Maria nuk do të mund të fliste kurrë më. Trauma kishte qenë përfundimtare. Ditët kalonin më ngadalë. Heshtja kishte kapluar krejt vilën. Kishte rrëshqitur nga goja e Maries mbi veshët e Martinit, pastaj ishte derdhur pa u ndjerë mbi trupat e tyre, veshjet, shkallët e vilës, dhomat, muret, kishte dalë jashtë në oborrin luleshumë dhe kishte ndaluar te kangjellat e jashtme përtej të të cilave mbaronin të gjitha kurreshtitë.

U mësuan me heshtjen si me një kafshë shtëpiake. Mbrëmjeve Martini ulej përballë oxhakut dhe përpiqej t'u rezistonte sa më shumë pikëpyetjeve vrastare, ndërsa në kolltukun tjetër Maria hidhte qëndisma të reja mbi xhubletën e virgjër.

Dikur qëndismat mbaruan dhe Maria bashkë me lotin lëshoi edhe një rënkim të thellë. E mori xhubletën si diçka pa vlerë dhe e vuri në një cep, anash oxhakut, në krah të mashës me të cilën trazonte urët. Nuk kishte mbetur asnjë pjesë e paqëndisur dhe xhubleta, në atë larmi ngjyrash e simbolesh, tash dukej si një kështjellë lodër, por pa bërë të ndjeheshin fëmijë asnjërin prej të dyve.

Të nesërmen filloi ritualin e vjetër të ndërrimit të dheut të luleve.

Mëngjeseve qante e qeshte me to, pasditeve i gëzohej diellit në verandë dhe, kur binte muzgu, hynte brenda në dhomën e ndenjes, mblidhej kutullaç me një batanije mbi kolltuk me sytë përhumbur në pusin e zjarrtë të oxhakut, sikur të kërkonte shëmbëlltyrën e vet. Në kolltukun tjetër Martini, duke tymosur dhe duke pirë konjakun e tij, gotë pas gote, derisa nuk kishte më fuqi të mendonte.

I zinte gjumi aty, në kolltuqe, përballë njëri-tjetrit dhe kjo përsëritej çdo natë…

Një mëngjes Martini vendosi të nisej për në Kullnajë.

Në një çantë të madhe shpine futi xhubletën. Te "Ulpiana", pasi u dend në konjak, kërkoi dikë që mund të lexonte xhubletën e Maries, por të gjithë ngrinin supet përpjetë kur shihnin qëndismat e panjohura.

Më në fund e drejtuan për te Nana Urana, plaka shekullore që dinte të lexonte të gjitha gjuhët e xhubletave dhe i treguan me dorë shtegun mes dy katarakteve dhe një ngrehinë guri majë shkëmbinjve, nga oxhaku i së cilës atë mëngjes të ftohtë nuk po dilte tym…



Poezi

nga Artan Hasani

Shkëputur nga libri poetik "ID"

ËSHTË DASHURI…

…kur merr frymë me mushkërinë e tjetrit
…kur loti i huaj faqes tënde rrjedh
…kur nata e tij të ndriçon mëngjesin
…kur ç'ka shpirti i tij vështrimi yt nxjerr…
…kur gjak' i tij përflak zemrën tënde
…kur sytë e tu qerpikët e tij kanë
…kur prekja të vjen nga tingujt e një kënge
dhe duart e tua të tuat më s'janë…

PUTHJA JOTE


puthja jote është frymë e fatit,
mallkim i mallit,
padurim i duarve,
fëmijë i lojës,
vetmi e urave
është barka ime e Noes
që dallgët e pasionit e nxjerrin
mbi brigjet e thara të buzëve
kur krahët e fjalëve pushojnë
mbi rremat e lagura të gjuhëve
kur sytë e tu mbyllen
dhe i vënë kyçin botës…

TUNEL

u lodhëm së qënuri të lumtur
dhe larg
ndoshta më mirë pranë
e të dëshpëruar
të paktën dora që nuk përkëdhel
tjetrën ngrohtë do e mbajë
pranë zjarrit që s'duam të shuhet
sa herë që duket se diçka kemi harruar
përtej malit që ndan…

fati na kishte në anë të kundërta
dy tunele që duheshin takuar në mes
si krahët e mallit kur përqafohen
dhe padashje gërmuam njëri tjetrin
në funeralin e pritjes që vdes…

dikur fund i tunelit do të hapet
dhe lotë të verbërish
drita do rrjedhë mbi ne
por nuk e dimë ç'do të shfaqë
do bëhemi një me atë çka mbeti
se pjesën tonë më të mirë
e humbëm rrugës për te njëri tjetri
si dëbora gjurmët
kur zë e shkrin…
si fjalët shpirtin
kur thuhen…



SHUARJE

puthjet mbjellin farat e mia
kudo në trupin tënd
dhe lulëzoj brenda teje nën lëkurë,
në kapilarë,
në nerva
pa e ditur

tretem krejt…
shuhem në ty…
humbas…

bëhem ti
aq shumë
sa një ditë më kërkon
e nuk më gjen…

LULEPLAGA

lulet kanë zënë kore
e plagë aromatike më mbulojnë të tërin
si detin kujtimet e marinarëve
dhe gëzoj si dhimbja kur dehet
me çka mbeti…
gjaku nuk u bë ujë,
por lot
dhe plaga erëmirë çeli lule të reja
që mbajnë erën tënde
nën gushën time
aty ku
u mbollëm
u mlodhëm
u mbyllëm
si fjalët brenda heshtjes...

PREJ AJRI

është në ajër aty pranë
dhe ti s'e sheh...
pa formë,
mbështjellë të ka
e bashkë me ty fluturon...
asgjëkundit shkon e vjen
si krillat e librave rusë...
si gruaja kur ka mall
pa ditur se për çfarë...
e butë...
e ngrohtë...
re...
kashmir a gushë mjellmash
lot avulli mbi qelqin ku fryma
vjedhurazi veten dashuron....

i vë dy sy...
një hundë...
dy buzë
flokë prej ari
dhe një zemër që rreh
kërkon ta prekësh,
por s'është më në ajër
as aty pranë,
por ti e sheh...


Rruga e Arbërit nr. 149

Për fëmijërinë e viteve '60

Fëmijëria e viteve 1950-1960 në Shqipëri, nuk ka patur shumë dallime midis fëmijëve të së njejtës moshë për shkak se sistemi politik nuk lejonte disnivele të mëdha ekonomike, shoqërore apo politike. Por sidoqoftë fëmijëria në fshat dallonte nga ajo e qytetit siç dallon edhe sot e kësaj dite. Aq më tepër për një familje, si ajo e jona, të cilën fati e kishte vënë përballë sfidash të mëdha.

Autori, që njëkohësisht është vëllai im, ka marrë përsipër të rrëfehet para fëmijëve të tij, fëmijëve tanë dhe opinionit publik, për të sjellë në vëmëndje një kohë, e cila të mësonte të sfidosh realitetin për të ecur para. Janë rrëfime që të mësojnë se vetëm rruga e diturisë është rruga e vetme për të kapërcyer pengesat dhe për të ecur në rrugën e qytetërimit.

Autori jua ka përcjellë fëmijëvë të tij këtë histori në mënyrë të vazhdueshme për t'i motivuar ata të ecin në rrugën e dijes, në të njëjtën rrugë për të cilën luftuan edhe prindërit tanë.



Valbona dhe Drini, dy fëmijët e Sakipit, ja kanë shpërblyer babait të urtë dhe të mirë mundin dhe sakrificën e tij. Sakipi, në jetën e tij, i ka përqëndruar energjitë tek familja, duke realizuar detyrën si prind ndaj fëmijëve të tij por edhe ndaj prindërve tanë, amaneti i të cilëve ishte vetëm dituria.

Sidoqoftë kjo nuk do të thotë që të tjerët nuk kanë bërë dhe nuk bëjnë përpjekje për të arritur më të mirën dhe për t`u arsimuar, por rrethana të caktuara, të detyrojnë të mos arrish atë që dëshëron.

Teksa lexon nëpër rreshtat e këtij rrëfimi prekës, njihesh me historinë e një familjeje, e cila shkollimin e fëmijëve e kishte prioritet mbi të gjitha prioritetet.

Diku me bursë nga shteti, diku duke qendruar tek të afërmit, duke të lënë jashtë në borë apo ndonjë herë pa bukë si ndëshkim, shkollimi i fëmijëve, i arriti objektivat për kohën.

Babai i rreptë në çdo kohë por dhe i dashur kur duhej, duke udhëtuar natën dhe ditën për të qenë pranë fëmijëve në çdo rast kur ata kishin nevojë, pavarësisht detyrave shtetërore të kohës apo sëmundjes të cilën e sfidoi si çdo gjë tjetër, ka qenë një krah i fortë për ne pesë fëmijët e tij.

Nëna e urtë dhe vetsakrifikuese në çdo rast, e përkushtuar deri në vetflijim që fëmijët e saj të rriteshin dhe edukoheshin sa më mirë të ishte e mundur, ishte gjithmonë pranë me kujdesin dhe fjalën e ngrohtë.

Këto kujtime fëmijërie, tani në kohën e teknologjisë së informacionit, duken të pa imagjinueshme për brezin e sotëm, ato duken si përralla për të të vënë në gjumë apo për të treguar që brezi ynë ka qenë një brez i viktimizuar, por unë këmbëngul që ato duhet të shkruhen dhe t`u trashëgohen brezave. Ndërkohë brezave nuk duhet t'u vijë turp për historinë e të parëve, por t`u jenë mirënjohës pafund sakrificës së tyre, të nxjerrin mësime prej saj dhe t`a ngrenë në një nivel më të lartë zhvillimi.

Në këtë libër autori nuk rrëfen vetëm për veten e tij por edhe për vëllezërit dhe motrën, prindërit dhe gjyshërit, për të afërmit, për shokët, shoqet dhe mësuesit. Ai është i sinqertë në këto tregime, duke evidentuar se kush ka ndikuar në edukimin e tij.

Lëvizjet e mëdha të familjes, për shkak të detyrave shtetërore të babait dhe sëmundjes së tij kanë krijuar jo pak vështirësi në fillimin e jetës nga e para në mjedisin e ri ku shkonim. Gjirokastra, Tirana, Laçi, Burreli, Bulqiza, Zerqani, Shupenza dhe Golovishti janë qytete dhe fshtatra ku ka punuar dhe banuar familja në sistemin e viteve para 1990 dhe çdo vend ka historitë, sukseset dhe vështirësitë e veta.

Ky është një botim autobiografik, i cili ka për qëllim të sjellë tek brezat një histori të vërtetë. Ai paqyron kohën e shkollës fillore, 8 vjeçare (siç quhej për kohën) dhe shkollën e mesme me të gjithë faktorët dhe aktorët që kanë qenë bashkëshoqërues të kësaj periudhe si dhe fakte historike të zhvillimit ekonomik, politik dhe social të kohës, ndaj informacioni mund të shërbejë edhe për çdo studies historie të periudhës së viteve 1950-1970.

Ai mund të shërbejë edhe për një analizë krahasuese të jetës së fëmijëve të fshatrave Viçisht, Golovisht, Gjoricë, apo të qytetit të Bulqizës tani në vitin 2018, në krahasim me atë të viteve 60, por edhe të çdo fshati apo qyteti tjetër në Shqipëri, që në kohën e viteve para 1990 nuk kishte dallime të mëdha.

Dr. SHPËTIM CAMI

Një histori për klonin që ndau fshatin


Foto e klonit të kufirit. Tre gra duke punuar brezin e butë

Nga **SAKIP CAMI**

Për brezin e fëmijëve të mi, për nipërit dhe mbesat, për stërnipërit dhe stërmbesat e ardhshme, kjo është e pabesueshme. Por ja që kështu është e vërteta. Në vitet 1967-1968 filloi rindërtimi klonit të kufirit, kryesisht në viset kufitare të veriut dhe të verilindjes.

Fshati im u nda në dy pjesë. Pjesa e Viçishtit të Poshtëm mbeti brenda klonit, plotësisht e izoluar. Fëmijët për të ardhur në shkollë duhet të kalonin nëpërmjet një porte, të cilën e hapte dhe e mbyllte kapteri i qenit të kufirit të postës kufitare. Fatmirësisht fëmijët e kësaj lagjeje bashkoheshin me fëmijët e oficerëve dhe të kapterëve të postës kufitare dhe kështu nuk kishte pengesë. Në këtë grup ishin: Luan Mersim Rama, Haziz Tola, Dylber Markja etj. Ndoshta duhet shpjeguar pak se çfarë ishte kloni. Fshati im, si fshat kufitar, jetoi për rreth 20 vjet në këtë izolim, i rrethuar me klonin me tela gjembi.

Në qendër të një brezi toke të punuar dhe të shkrifëruar, me gjerësi rreth 3,5 metra, vendoseshin shtylla druri të staxhionuara në vijë të drejtë sipas terrenit e në largësi të barabartë nga njëra-tjetra. Këto shtylla mbanin të montuar tela me gjemba nga nëntoka dhe me gjerësi disa cm, sa më afër tokës e me distancë pak më të madhe, sa më lart në shtylla druri në 2 m. Mbi shtylla shtrihej në rreth 1 m gjerësi tel me gjemba dhe mbi to filli që siguronte ndërlidhjen. Në shtylla, në vende të caktuara, ishin vendosur prita në mënyrë të maskuar, por edhe për t'u mbrojtur nga shirat, në të cilat sigurohej ndërlidhje me aparat telefonik "TAJ-43". (Akoma ishin në punë aparatet sovjetikë të ndërlidhjes). Nga ana e brendshme e klonit, pra nga kufiri, në brezin e butë, në rreth 1 metër gjerësi, toka ishte e ngjeshur, pra ishte rrugë ku kalonte njësiti i kufirit me qenin e kufirit, duke kontrolluar me imtësi çdo shenjë dyshimi.

Për çdo dyshim apo gjurmë ato sinjalizonin postën. Në qoftë se dikush takonte dy fije teli, i këpuste ato, ose kur gjatë kullotjes së kafshëve takonte telat zinxhiri i kalit, në centralin qendror të postës jepej sinjali i alarmit. Në postë përcaktohej me saktësi edhe sektori ku ndodhte ngjarja. Menjëherë nga posta e kufirit niseshin kufitarët me shpejtësi maksimale. Njëri njësit, zakonisht me 2-3 kufitarë shkonte në sektorin ku u dha sinjali, ndërsa njësiti tjetër shkonte në brezin afër zonës neutrale (në këtë zonë nuk hynte askush nga shtetet), pasi parashikoheshin të dy variantet, shkelja e kufirit nga brenda-jashtë, ose nga jashtë-brenda. Në qoftë se sinjali mund të shkaktohej nga kafshët, bëhej objekt analize e ndalohej futja e bagëtive në afërsi të klonit.

Kloni ishte afro 100-200 metra larg vijës kufitare shtetërore, ose sipas vartësisë së terrenit. Vija ndarëse e kufirit kishte specifikat e veta. Toka ishte e punuar në rreth 2.5 metra, ku kishte një rrugë kalimi për njësitin kufitar dhe ishte vendosur një gardh me thupra. Këtu ishin vendosur piramidat në të dy anët e kufirit. Në piramidën që ndodhej në anën tonë shkruhej nga ana e kufirit RFSJ (Republika Federative Socialiste e Jugosllavisë) dhe nga ana jonë shkruhej RPSSH (Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë), dhe anasjelltas. Distanca në mes dy piramidave përballë njëra-tjetrës quhej zonë neutrale dhe ishte e paprekshme. Kloni vazhdonte nga Gjorica, në Viçisht dhe vazhdonte në Miresh.

Fshati im kishte dy porta hyrëse e dalëse, një tek Fisi i Likajve në Viçisht, afër shkollës, dhe një në xhade, pranë shtëpisë së Kasem Xhurës. Kishte edhe porta sekrete që përdoreshin vetëm në raste të veçanta dhe në rast lufte. Në Miresh kishte edhe një portë tjetër, sepse edhe kjo lagje-fshat, ashtu si Viçishti i poshtëm, mbeti e izoluar. Në Viçisht të Poshtëm mbetën të izoluar Fisi i Tolajve dhe Fisi i Markajve. Ishte gjithashtu edhe vetë Posta e Kufirit dhe shtëpitë e familjarëve të oficerëve të postës. Në fshatin tonë shërbente si komandant Mersim Rama. Djali i tij, Luani, bënte mësim në shkollën e Viçishtit, lart në qendër të fshatit, dhe kalonte nëpërmjet portës. Më vonë, pas

Në qendër të një brezi toke të punuar dhe të shkrifëruar, me gjerësi rreth 3,5 metra, vendoseshin shtylla druri të staxhionuara në vijë të drejtë sipas terrenit e në largësi të barabartë nga njëra-tjetra. Këto shtylla mbanin të montuar tela me gjemba nga nëntoka dhe me gjerësi disa cm, sa më afër tokës e me distancë pak më të madhe, sa më lart në shtylla druri në 2 m. Mbi shtylla shtrihej në rreth 1 m gjerësi tel me gjemba dhe mbi to filli që siguronte ndërlidhjen. Në shtylla, në vende të caktuara, ishin vendosur prita në mënyrë të maskuar, por edhe për t'u mbrojtur nga shirat, në të cilat sigurohej ndërlidhje... Nga ana e brendshme e klonit, pra nga kufiri, në brezin e butë, në rreth 1 metër gjerësi, toka ishte e ngjeshur, pra ishte rrugë ku kalonte njësiti me qenin e kufirit, duke kontrolluar me imtësi çdo shenjë dyshimi.

viteve 90, Luani do të bëhej ministër i brendshëm i Shqipërisë. Vendosja e klonit, për ta bërë kufirin të pakalueshëm, krijoi vështirësi për banorët e fshatit, si dhe fshatrat e tjerë të brezit kufitar. Pjesa më e madhe e tokës së fshatit, madje ajo nën ujë, mbeti brenda klonit. Për punimin e saj, si mbjelljet dhe gjitha shërbimet e tjera të rritjes dhe të mbledhjes së prodhimit, bëhej shoqërim me kufitarë të armatosur. Banorët e fshatit, të futur në rrethim edhe kur dilnin nga shtëpitë e tyre për punë, por edhe kur u vinte ndonjë mik, duhej të raportonin në postën e kufirit. Kryefamiljari të cilit i shkonte miku ose një nga djemtë e rritur, me të ardhur miku, i merrnin pasaportën dhe lejen e i dorëzonin në postën e kufirit, dokumente të cilat i merrte të nesërmen ose ditën që largohej miku.

Ne fëmijët që shkonim në shkollën 8-vjeçare të Gjoricës u detyruam që të bënim edhe më shumë rrugë dhe të kalonim nga kodrat e Gjoricës, në vend që të kalonim shkurt nga buza e kufirit, nga buza e Drinit të Zi. Por fëmijët si fëmijët. Mbeteshim vonë në mëngjes. Dhe kur gjenim portën e hapur në Viçisht shkonim buzë Drinit dhe arrinim shpejt në Gjoricë. Por atje gjenim portën e klonit të mbyllur. Askush nuk vinte për ta hapur sepse nuk kishin porosi apo urdhër. Kështu që ne mbeteshim pa shkuar në shkollë. Ose duhet të ktheheshim mbrapsht nga kishim ardhur, të humbnim mësimin për atë ditë. Atëherë ndodhte e palejueshmja. Me ato duart e vogla që na i gjakosnin telat me gjemba largonim telat dhe fusnim në fillim kokën dhe pastaj trupin. Futej i pari dhe e ndihmonim ne. Shokun e fundit e ndihmonim nga ana e brendshme.

Jepej sinjali i alarmit. Ushtarët vraponin në drejtim të vendit ku "ishte shkelur kufiri". Ne vraponim për t'u larguar nga vendi i ngjarjes. Qëllonte të na kapnin. Por shpëtimtari bëhesha unë. Jo se isha më i zoti se të tjerët, por se kisha shok nipin e Toger Manit, komandantit të Postës së Viçishtit. Nipi i tij nga një fshat i Tropojës kishte ardhur të bënte shkollën në Gjoricë. Rrugën nga Viçishti i Poshtëm në Gjoricë të Sipërme e bënte shkurt, buzë kufirit, buzë Drinit. Shumë herë e bënim bashkë. Më priste kur vija nga Golevishti, e thirrja tek shtëpia e oficerëve të Postës Kufitare dhe shkonim bashkë. Rrugës përsërisnim mësimet. Për hir të së vërtetës, unë isha shumë mirë me mësime. Mësoja shumë dhe më jepej. Bashkë me ne vinin në rrugën e shkurtër edhe shokët Zeqiri, Medati, Mentori, Pëllumbi etj. Pra kjo ishte arsyeja që bënim ndonjë gabim, por na shpëtonte shoku im, nipi i Toger Manit nga Tropoja.

Na ishte njëherë kloni i kufirit...Nuk është përrallë. Brezi im e ka vuajtur.

kalendar

KALENDAR HISTORIK
shek. V p.e.s. - qershor 2009

VITI	NGJARJET

(vijon nga numri i kaluar)

1943, qershor - Formohet Këshilli NÇ ilegal, ku bënin pjesë Stefan Luarasi, Thoma Harito, Ramadan Shehu, Ismete Baholli.

1943, 26 korrik - Formohet Batalioni Partizan i Dibrës, me komandant Haxhi Lleshin dhe komisar Njazi Islamin. Batalioni Partizan i Dibrës u formua mbi bazën e tri çetave (Çeta e Grykës Vogël, Grykës së Madhe dhe Çeta e Sllovës). Më vonë, 15 gusht, inkuadrohet dhe Çeta e Gollobordës. Në ditën e formimit Batalioni Partizan i Dibrës kishte 180 veta.

1943, 3 gusht - Forcat partizane të Dibrës dhe ata territoriale të Grykës së Madhe çliruan Zerqanin.

1943, 14 gusht - U zhvillua Lufta e Maqellarës ndërmjet forcave partizane dhe një autokolone italiane. Fashistët italianë lanë 13 të vrarë.

1943, 23 gusht - U zhvillua Lufta e Sofraçanit ndërmjet të forcave partizane të Dibrës e të Martaneshit dhe tre regjimenteve italiane. Ushtrisë fashiste iu vranë 100 ushtarë. Nga dibranët ranë Kamber Xhafa nga Kovashica e Shupenzës dhe Mexhit Tola nga Ostreni.

1943, 10 shtator - U dorëzohet forcave partizane Divizioni "Firence" (15000 trupa) i përqendruar në qytetin e Dibrës së Madhe.

1943, 17-19 tetor - U zhvillua Lufta e Peshkopisë ndërmjet forcave partizane dhe kontigjenteve të Parisë së Dibrës.

1943, 30 tetor - Vdiq në spitalin e Tiranës nga një plagë që mori më 18 tetor në Luftën e Peshkopisë, komandanti i Çetës së Gollobordës, Ahmet Cami. Lindi në Viçisht më 8. 8. 1900.

1943, 16 nëntor - Ra në Luftën e Qytetit të Dibrës së Madhe kundër trupave naziste gjermane dhe bashkëpunëtorve të tyre tankist i parë shqiptar Hamdi Lleshi. Lindi në Banjishtë të Dibrës, më 11 janar 1921.

1944, 1 shkurt - Ra në Vrakë të Shkodrës Kapiten Rifat Manjani bashkë me Vasil Shanton dhe Reshit Rusin. Rifati lindi në Homesh në Vitin 1908.

1944, 22 shkurt - Vdiq Fuad Dibra (Saraçi). Lindi në Oranik të Dibrës në vitin 1886. Gjithë pasurinë e tij e shkriu për çështjen kombëtare. Më 1910 hapi dy shkolla shqipe në Zerqan dhe Tiranë me të ardhurat e tij. Financoi Kongresin e Manastirit, 1908 dhe të Dibrës 23 korrik 1909, delegacionin shqiptar të kryesuar nga Ismail Qemali në 1913 me 30 mijë napolona floriri që udhëtoi në Evropë, financoi delegacionin shqiptar në Paris për gjashtë muaj me një shumë prej 500 mijë franga floriri. Në qeverinë e Iliaz Vrionit iu besua posti i Ministrit të Brendshëm. Më 16 tetor 1943 Kuvendi Kombëtar e shpalli anëtar të "Këshillin e Lartë të Regjencës.

1944, 1 mars - Ra heroikisht në Tiranë Shemsi Haka. Lindi në fshatin Cerjan në vitin 1918. Në prill të 1943 u inkuadrua Çetën Partizane të Dajtit.

1944, 8 korrik - Ra në Fushë Alie Stefan Luarasi. Lindi në Luaras të Korçës në vitin 1914. U diplomua në Itali për veteriner. Burgoset nga fashistët italianë. Është themeluesi dhe organizatori i Rinisë Antifashiste Dibrane. Shtypi në Peshkopi trakte e thirrje kundër fashizmit. Më 23 korrik 1943 caktohet zëvendës komisar i Çetës Partizane të Sllovës.

1944, 9 korrik - Ra në Kodrat e Çerenecit luftëtari internacionalist, komandanti i batalionit "Antonio Gramshi" Tercilio Kardinali. Kishte lindur në Terranova Braciolini, Itali, në një familje të varfër fshatare. Në korrik të vitit 1943 arrestohet dhe dënohet me 16 vjet burg, sepse kishte shkelur me këmbë fotografinë e Musolinit dhe të Konti Cianos. Nga burgu e mobilizojnë me forcë në Divizionin "Firence", që veproi dhe në Dibër. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, bashkë me internacionalistë të tjerë formojnë batalionin "Antonio Gramshi" dhe më 10 dhjetor 1943 inkuadrohet në Brigadën e Parë Sulmuese.

1944, 29 korrik - Forcat e Brigadës 4 Sulmuese, Batalioni i Dytë i Brigadës 5 Sulmuese, Batalioni "Antonio Gramshi" dhe Batalioni Partizan i Dibrës sulmuan dhe çliruan qytetin e Peshkopisë nga nazifashizmi.

1944, 18 gusht - Formohet në Sllatinë Brigada e 18-të Sulmuese, me komandant Esat Ndreun dhe komisar Miço Kallamatën. Në ditën e formimit Brigada numëronte 650 partizanë të Batalionit të Dibrës, Çermenikës dhe Martaneshit, si dhe të partizanëve të ardhur nga njësi të ushtrisë nacionalçlirimtare shqiptare.

1944, 2 shtator - Partizanët e Brigadës XVIII dhe Brigadës V Sulmuese çliruan qytetin e Dibrës nga nazifashizmi dhe bashkëpunëtorët e tyre rrogëtarë.

1944, 10 shtator - Konferenca e dytë NÇ e Qarkut të Dibrës zgjodhi Këshillin prej 30 anëtarësh dhe kryesia prej 10 anëtarësh me kryetar Faik Shehun.

1944, 10 shtator - U pushkatuan në kampin nazist të Prishtinës Hamza Shehu, Tasim Shehu, Osman Arifi nga Peshkopia; Shaban Jegeni, Bilal Konxholli, Irfan Tomini, Enver Trebishti nga qyteti i Dibrës së Madhe.

1944, 23 shtator - Ra në Shutovë të Kërçovë zëvendëskomisarja e Kompanisë së Dytë të Batalionit të Katërt të Brigadës 18o-të



Sulmuese, Heroina e Popullit Hibe Palikuqi. Lindi në lagjen "Inqar" të qytetit të Dibrës së Madhe.

1944, 23 shtator - Mblidhet Konferenca e Parë e Rinisë Antifashiste të Qarkut të Dibrës.

1944, 20 tetor - Ra në Kashar të Tiranës, kundër nazistëve gjermanë Rukie Roshi. Lindi në fshatin Bugjenec në vitin 1927. Në gusht të 1944 rreshtohet në Brigadën e 4-t Sulmuese.

1944, 27 tetor - Riformohet Këshilli i Ri qytetit të Peshkopisë me kryetar Ramadan Shehun, nënkryetar Rasim Fetahun dhe 6 anëtarë.

1944, nëntor - Shovinistët serbë vranë në Prilep komandantin e Zonës së Parë Operative të Maqedonisë, anëtarin e Shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Partizane të Maqedonisë dhe zëvendëskomandantin e Shtabit Suprem të Maqedonisë Hamdi Dema. Lindi në Homesh në vitin 1905.

1944, 19 dhjetor Ra në Budovik kundër nazistëve gjermanë Rifat Selim Kaloshi. Lindi në fshatin Kandër në vitin 1929.

1945, 4 prill - Vdiq në spitalin e Prishtinës dhe u varros në Vuçitern Rexhep Zuna. Lindi në fshatin Sahodoll më 1914. Më 12 shkurt 1944 arratiset nga ushtria italiane dhe u bashkohet forcave nacionaliste të Ismail Petrelës, por dhe nga ky në qershor të 1944 largohet dhe kalon në Çetën e Pezës. Më 18 shtator 1944 caktohet komandant i Batalionit të Katërt të Brigadës 22 Sulmuese dhe më 22 dhjetor 1944 caktohet komandant i Brigadës 22 Sulmuese.

1945, maj - U ngrit Biblioteka e Peshkopisë.

1945, 15 tetor - Zgjidhet Këshilli i Përgjithshëm i gruas dibrane dhe kryesia prej 9

anëtarësh me kryetare Sofie Baholli.

1945, 10 prill - Në Peshkopi formohet dega e Kryqit të Kuq Shqiptar me kryetar Haki Pahumi.

1945, 26 shtator - Bëhen zgjedhjet e reja për Këshillin e qytetit të Peshkopisë.

1945, 20 dhjetor - Hapet shkolla Unike e Peshkopisë.

1946, mars - Hapet dega e Bankës së Shtetit Shqiptar në qytetin e Peshkopisë.

1946, 16 maj- Inaugurohet Materniteti i Peshkopisë me 4 shtretër. Personeli shëndetësor përbëhej nga një mjek kirurg gjinekolog dhe një mami (Margarita Mezelxhiu).

1946, 18 maj - Këshilli i Ministrave vendosi hapjen e rrugës që do të lidhte Peshkopinë me Kukësin.

1946, 25 maj - Nisi puna për hapjen e rrugës Kukës-Peshkopi.

1946, 29 maj - Inaugurohet Shtëpia e Kulturës në Peshkopi, me përgjegjës Vasfi Xheladinin.

1946, 1 gusht - Shfaqet filmi i parë në kinemanë e qytetit me aparaturë stacionare.

1947, 20 nëntor - U ngrit dhe u vu në punë salla e operacionit me 3 dhoma. Salla e shtrimit kishte 15 shtretër.

1947, 12 dhjetor - Lindi në qytetin e Dibrës Lutfi Turkeshi. Mësimet e para dhe të mesme i kreu në vendlindje. Të lartën e mbaroi Fakultetin e Shkencave Politike, në degën e gazetarisë në Zagreb. Ka gradën shkencore "Doktor i Historiografisë së Gazetarisë". Ka punuar në "Radio Shkupi". Në vitin 2000 botoi librin e parë "Penda për çështjen kombëtare", në 2004 botoi "Nga fjala në metaforë" dhe në vitin 2005 "Dibra nëpër shekuj". Dr. Turkeshi është autor i qindra shkrimeve në shtypin periodik. U nda nga jeta më 8 maj 2006.

1948, 6 shkurt - U ekzekutua Faik Shehu, si pjesëmarrës në grupin e deputetëve që krijuan opozitën parlamentare. Faik Shehu Lindi në Peshkopi në vitin 1899. Qe një nga tregtarët më të pasur të qytetit të Peshkopisë. Në prill 1940 qe në përbërjen e delegacionit shqiptar që i dërguan kurorën mbretërore Viktor Emanuelit të III. U përfshi në lëvizjen nacionalçlirimtare dhe komandoi çetën vullnetare të katundeve të Peshkopisë. Është zgjedhur Kryetar i Këshillit të Qarkut të Dibrës dhe kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Qarkut të Dibrës. Mori pjesë në Kongresin e Përmetit dhe Konferencën e Beratit. Në zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 u zgjodh deputet në parlamentin shqiptar.

1948, 18 shkurt - Nisi punën Miniera e Bulqizës me 30 punëtorë. Deri në vitin 1984 nga kjo minierë u nxorën dhe u transportuan 9 milionë ton krom.

1948, shtator - Nis vitin shkollor me 18 nxënës Shkolla e Mesme Pedagogjike në Peshkopi, me drejtor Pandi Cici.

1949, 29 prill - Vdiq nga torturat e UDBASh -ve në burgun e Shkupit komisari i Brigadës VII shqiptaro-maqedonase, Ministri i asistencës sociale dhe zëvendës-kryeministri i Maqedonisë Nexhat Agolli. Lindi në qytetin e Dibrës së Madhe në vitin 1913. Mbaroi studimet e larta për drejtësi në Universitetin e Romës.

1949, 9 maj - Vdiq në burgun e Shkupit Cen Elezi. Lindi në Sllovë në vitin 1884.

1949, 1 korrik - Riorganizohet Qarku i Dibrës. Nga 26 lokalitete

që kishte, me organizimin e ri ngelën 12: Ostren, Klenjë, Zerqan, Shupenzë, Selishtë, Lurë, Dardhë, Kastriot, Muhurr, Maqellarë, Sllovë dhe lokaliti i qendrës.

1949, gusht - Mblidhet Këshilli Popullor i Rrethit, i cili zgjodhi kryesinë prej 7 anëtarësh me kryetar Demir Lekën.

1949, 30 dhjetor - Vdiq në Stamboll themeluesi i filozofisë moderne turke Riza Tefik Dibrani. Riza Tefiku, që nuk e mohoi origjinën e tij dibrane lindi në Stamboll në vitin 1869. U diplomua për mjekësi, por iu përkushtua filozofisë. Në 1908 u zgjodh deputet në mexhlisin turk. Në kabinetin e vitit 1918 të Damand Ferit Pashës iu dha posti i Ministrit të Arsimit. Në vitet '20 jep mësime filozofie në Universitetin e Stambollit. Pas fitores të Revolucionit Qemalist emigroi për 20 vjet në Qipro. U kthye në vitin 1943. Riza Tefiku botoi një seri veprash filozofike si: "Abdyl Hak Hamid ve mulahazati felsefijesi" (Abdyl Hak Hamdi dhe mendimet e tij filozofike), 1913; "Felesefe Dersleri" (Mësime filozofike), 1914; "Myfessal kamusi felesse" (Fjalor me hollësi filozofike), 1914. Në vitin 1934 botoi në Qipro përmbledhjen poetike "Serabi Umruni (Rrjedha e jetës time). Në vitin 1949 botoi kujtimet "Të flas pak dhe unë".

1951, 8 nëntor - Përurohet hidrocentrali i parë në Peshkopi, me përgjegjës Xhelil Çorjan.

1955, 21 janar - U ngrit kooperativa e parë bujqësore në rrethin e Dibrës në fshatin Dahoshisht, me kryetar Aqif Hoxhën. Fillimisht u bënë anëtarë të kooperativës 49 familje me 75 ha tokë, 18 qe pune, 154 dhen, 36 lopë.

1959, maj - Ngrihet Estrada Profesioniste e Peshkopisë.

1964, shtator - Nis vitin e parë Shkolla e Mesme e Përgjithshme (Gjimnnazi) me drejtor Riza Manjanin.

1967, 30 nëntor - Rrethi i Dibrës goditet nga një tërmet i fuqishëm 9 ballë i shkallës Rihter.

1968, 3 prill - Doli numri i parë i gazetës "Ushtima e Maleve" organ i Komitetit të Partisë rrethit me kryeredaktor Esat Basharin.

1968, 6 nëntor - Hapet shkolla 3 vjeçare për mami.

1969, shkurt - Krijohet Fanfara nën drejtimin e Tonin Rotës. Më vonë u drejtua nga Nuredin Mazari.

1969, 28 gusht - Inaugurohet Muzeu Historik i Dibrës, me drejtor Ilmi Sadikaj.

1970, 2 dhjetor - Inaugurohet Shtëpia e Pionierit.

1974, korrik - Nis punën Zyra e Kadastrës, pranë Komitetit Ekzekutiv të rrethit Dibër.

1975, 13 tetor- Krijohet Dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve.

1984, maj- Ngrihet Teatri Dramatik i Dibrës.

1991, 21 qershor - Doli numri i parë i gazetës "DIBRA".

1992, 28 janar - Doli numri i parë i gazetës "KASTRIOTËT", organ i shoqatës "Bashkimi DIBRAN" me kryeredaktor Moisi Murrën.

1997, 13 mars - Nis transmetimin TV Dibra, në staf: Veli Vraniçi, drejtor, Ben Zeqo - operator, Mentor Roçi - teknik dhe Gentiana Xhajku - folëse.

1999, 29 mars - Në Dibër vijnë të dëbuarit e parë kosovarë.

2001, 15 dhjetor - Inaugurohet Pallati i Kulturës "Haki Stërmilli".

2007, 11 mars, 23:30 - Peshkopia lëkundet nga një tërmet 4 ballë i shkallës Rihter. Muaji mars u shoqërua me lëkundje të lehta tërmeti.

2008, 10 shtator - Inaugurohet Xhamia e Re e Peshkopisë. Xhamia u ndërtua me kontributin e Abdyl Gani, nga Daka, Katar dhe u projektua nga inxhinierët Zabit Muda dhe Agim Islami. Trualli prej 500 m² u dhurua nga Ilir Shehu.

2008, 17 nëntor - Inaugurohet godina e re e Bashkisë.

2009, 9 qershor - Inaugurohet shtatorja e Skënderbeut në Peshkopi.

Rruga e Arbërit nr. 149

Kastriotët e Kastriotit

Kur janë prezent faktet, fjalët janë të tepërta, thotë populli, por duhen thënë.

Nga **MURAT KOLTRAKA**

Studjues të huaj, që kaluan nëpër krahina të veriut në shek. XIX ndeshën në gojëdhëna e toponime për Skënderbeun, që gjenden kudo në hapsirat shqiptare. Mbi një bazë të tillë ata dhanë mendimet e tyre për origjinën e Kastriotëve. Nuk kemi informacion për ndonjerin të ketë kaluar nëpër Dibër, të kishte informacion për fshatin Kastriot dhe të mos e merrte në konsideratë e të shkruante për të, që të shërbente si nxitje për studime të mëvonëshme. Studjues (simpatizant) të krahinave veriore, mbështetur në atë që na lanë studjues të huaj, pa ndonjë mbështetje shkencore, rendën pas emrash të përafërt me Kastriotët, si Kastri, Kastrat e të tjerë. Një situatë e tillë dhe lënia me një anë e Kastriotit të Dibrës, krijoi premisa për lindjen e disa hipotezave dhe solli kaq shumë zvarritje në kohë për të nxjerrë në dritë të vërtetën historike.

K A S T R I O T I

Vet emri Kastriot fletë më shumë se kushdo tjetër për lidhjen ndërmjet tij dhe Kastriotëve. Fshati Kastriot i sotëm ndodhet në të majtë të përroit të Kastriotit, ndërsa Kastrioti si vendbanim i Gjon Kastriotit, (qendra e tij) me një toponomi të pasur shtrihej në të djathtë të këtij përroi, ose në veri të Kastriotit të sotëm, në një vend të ngritur strategjik, që kontrollon gjithë pjesën fushore të Dibrës së Poshtëme. Në perëndim të Kastriotit në distancë rreth 6 km është fshati Sinë, ku shfaqen për herë të parë sipas dokumentesh Kastriotët me gjyshin e Skënderbeut, Palin, që sipas studjuesve daton me vitet 1350-1375.

Sipas thënieve të trashëguara në breza, Kastrioti ndahej në dy lagje. Njëra ishte Çeliasi, që fillonte tek kishat në lindje dhe përfundonte në kufi me fshatin e Blliçes në perëndim, kurse tjetra fillonte tek kishat në lindje dhe shtirhej drejt jugut në një rrafshinë me toponimin "Troja" deri tek Terzishti, (rrobaqepsi në ate kohë) ku sot ndodhet shkolla e mesme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu".'Publicisti i njohur dibran Haki Stërmilli, në kërkim të origjinës së Kastriotëve, në veprën "Kalorësi i Skënderbeut" shkruan, se Kastrioti dikur 8000 shtëpi rrënohej e zvoglohej si rezultat i luftrave me turqit. Kjo e dhënë, për mungesë të referencës mund të mbetet në kuadrin e gojëdhënave. Kastrioti i Çidhnës shtrihet rreth 6 km në veri-perndim të qytetit të Peshkopisë në Dibrën e Poshtëme.

SA I LASHTË ËSHTË FSHATI KASTRIOT I ÇIDHNËS?

Për këtë i referohemi "Fjalorit Enciklobedik Shqiptar''botim i Akademisë së Shkencave Shqiptare, Tiranë, 2008, në faqen 1136 të të cilit për Kastriotin thuhet: "Dëshmohet si vendbanim i lashtë nga gjetjet tek Kodra e Gështenjës. Në shek XIII ishte pronë e familjes së Kastriotëve". Kastriotin e ndeshim dhe në dëshminë e hershme boshnjake nga E. Fermenxhin në shek XVII. Ata që janë kundër ekzistences së Kastriotit si fshat i hershëm, pasi nuk ekziston në dëfterin turk te 1467, gabohen. Nuk mund të vazhdonte jeta në Kastriot pas masakrës së Çidhnës së shtatorit 1466. U rrënuan shumë fshatra të Çidhnës e të Dibrës, (18 fshatra te pabanuara)që sillen në dëfterin turk me fare pak shtëpi, por në dy fshatrat Kastriot dhe Kukaj jeta u ndërpre, pasi këtu kishte banuar familja e Gjon Kastriotit, që do të thotë se Skëndebeu ka kaluar vitet e fëmijërisë së tij.

Nga një sondazh që bënë të rinjtë e këtij fshati në këtë vend (tek Kodra e Gështenjës) të nxitur nga kurioziteti historik, me 1978, pas 2-3 m shpim ndeshën në lëndë të pasur arkeologjike, çka do të thotë, se lënda ekziston, por mungon dora e arkeologut për ta nxjerrë në dritë historinë e saj. Disa nga këta objekte u dorëzuan në muzeun e rrethit Dibër, vijuan rrugën dhe me tej, por askush nuk e vuri ujët në zjarr për këtë çeshtje.Flitet se disa nga historianët tanë e kanë ditur vendlindjen e Skënderbeut, por e kanë fshehur, për shkaqet nuk flitet gjë.

Gjurmë të lashtësisë dhe si vendbanim për Kastriotin mbajnë mend të gjithë të moshuarit e sotëm, por "qepja kodrave dhe e maleve per t'i kthyer në toka pjellore si dhe fushat'' në ish sistemin kooperativist, zhduku shumë nga këta gjurme, që ishin në sipërfaqe.

TOPONOMIA E KASTRIOTIT

Toponimi lind mbi një bazë, transmetohet në breza, shërben si nderlidhes i vendit me ngjarjen dhe kur bënë lidhjen me dëshmi e dokumente historike merr jetë e vërtetësi.

Toponimia mbi Kastriotët në krahinën e Çidhnës-është e veçantë dhe shumë e pasur, disa prej të cilëve të lidhur dhe me dokumente historike. I shërbejnë tezës për Kastriotët si banor të saj, si dhe shprehin historinë e Katriotëve në këtë vend. Toponimet si; Palpusi (pusi i Palit), Kulla e Gjonit, Kopështi, Pusi, Ogradja e Gjonit, Kroi i T'anë Zonë (zotit tonë, Skënderbeut) Gurra e Skënderbeut e të tjera i shëbejnë vendbanimit të tyre në Çidhën, ndërsa Kepi i Skënderbeut (fortesë), Kalaja e fshehtë e Skënderbeut, Qafë-Kalaja, Kalaja e Volezës, e Sfetigradit, Ferra e Pashës, beteja e Torviollit, e Otonetës, e Oranikut, e Mecadit, e Mireshit, e Sfetigradit, e Grykës së Radikës, , Masakra e Çidhnës e të tjera, dëshmojnë për historinë e tyre këtu në Dibër.

Mikrokrahina e Çidhnës ndahet në dy pjesë, në Çidhnën Malore dhe ate Fushore. Pjesa fushore është formuar nga fiset e ardhur nga pjesa malore. Çidhnakët shfrytëzonin edhe malin dhe fushën. Lëviznin në kohë luftrash nga pjesa fushore në atë malore, në kohë paqeje shfrytëzonin dhe fushën Veç kësaj ata dimrit (nje pjese) rrinin ne pjesën fushore, ndërsa verës ngjiteshin në viset malore, në bjeshken e Pllajut dhe të Xharshishtit ne perendim, kurse ne lindje shkonin ne bjeshket e Grames prane Korabit.. Aktualisht shume fise si Tola, Alia, Doçi, Pernezha, Koltraka, Pergjegji, Kukeli, Noka, Spata, Bitri, Bushi, Raska, Basha, Skepi, Kaloshi, e te tjere banojnë edhe në pjesën Malore në të majtë të Drinit të Zi edhe në pjesën Fushore te Çidhnes. Një praktikë të tillë e fiseve te Çidhnes ndiqte ate qe kishin bere Kastriotet me pare, te cilet ne kohe luftrash ngjiteshin ne Sine si vend me mbrojtje natyrore, kurse ne kohe paqeje zbrisnin ne Kastriot

Studjues të historisë së Kastriotëve, si prof. dr. Kristo Frashëri, prof. Riza Lika, Agim Bobo (Antar i Akademisë së Shkencave Shqiptaro- Amerikane), e të tjerë shprehen se Gjon Kastrioti ka banuar në fshatin Kastriot të Çidhnës.

Në mbështetje të tezës së tyre bëjmë të njohur për lexuesin toponimet e këtij fshati.

*Çeliasi'' si toponim në cilësinë e një lagjie të Kastriotit ekziston dhe sot. Ky toponim përmendet nga disa studjues të historisë së Kastriotëve, nga disa si vendlindje, nga të tjerë thuhet se Skënderbeu lindi në lagjen "Shëngjerth" në Sinë dhe u rritë në Çelias të Kastriotit. Celiasi përfshinë një sipërfaqe mbi 16 ha. Në këtë territor deri vonë ka pas rrënoja muresh, që flasin për të si vendbanim. Kulla, ose Kalaja e Gjonit ngrihej mbi një kodrinë të lartë, nga e cila mund të vrojtosh gjithë pjesën fushore të Dibrës së Poshtëme. Në pjesën lindore të saj vendasit piketojnë portën e saj. Në veriperëndim të kullës në largësinë 25 m është Kopështi i Gjonit, një sipërfaqe e sheshtë mbi 4 dy. Në pjesën perëndimore të tij ka pas rrënoja muresh deri para 50 vitesh, shenjat ende ekzistojnë. Në mes të kopështit është Pusi i Gjonit me gur e gëlqere anash, i thellë mbi 3 m para 4 dekadash. Brezi para nesh deklaronte prezencën e ujit në të. Në veri të kopështit është Ogradja e Gjonit, një sipërfaqe prej disa ha. Në juglindje të kullës, rreth 200 m larg saj janë Kishat. Në perëndim të tyre ka varreza të herëshme. Thuhet se ishin të Kastriotëve. Më në jug është Kodra e Shamatës.

500 m mbi Kullën, ose Kalanë e Gjonit gjendet Guri i Luftës. Më sipër tij janë Tre Gurthit, në pikën më të lartë të këtij territori, që shërbenin si pikë vrojtimi. Më në jug të tyre është Kaluerthi, një luginë e gjatë, e rrafshtë, e rrethuar anash me një terren të ngritur, si një stadium natyror, që shërbente për stërvitjen e kalorësve. Më në perëndim janë Gurët e Kazanave, vend ku gatuhej për ushtarët.

Në veri të Kalasë është Guri i Hajatit, kurse në veri -perëndim të saj në largësinë rreth 700 m është Kodra e Pareve, sot monument natyre, për formën e saj të veçantë, ku duket se ka vepruar dora e njeriut. Ka mendime se në këtë vend ka qenë tempulli i Kastriotëve. Ne veri të Kodrës së Pareve janë Varret e Dragojeve, vend ku varroseshin heronjtë, që tregonin shkallën më të lartë të trimerisë së tyre dhe heroizmit në luftë me pushtuesit. Në afërsi të Kodrës së Pareve janë Vreshtat. Ngjitur me ta kalon përroi me te njejtin emër, përroi i Vreshtave.

Në jug të Kalasë kalon përroi i Kastriotit. Në afërsi të urës së sotme deri vonë, më të moshuarit mbajnë mend rrënojat e mullirit të Kastriotëve. Ngjitur me te një sipërfaqe e pjerrët mban toponimin Bregu i Mullirit. Në perëndim të kalasë është Kroi i Kastriotëve, i cili shfrytëzohet si ujë i pijshëm nga banorët e fshatit Kukaj. Pjesën qëndrore te Çeliasit e zënë Gjerret e Kuke, ku sipas disa rrënojave të mureve në këtë territor mendohet se ka banuar fisi Pal Kukës, njerit nga njerëzit më të afërt me Skënderbeun. Një pus me mure gurësh me gëlqere anash ne mes të këtyre Gjerreve mund të kete shërbyer si ujë i pishëm për fisin e Kukeve, ose për fshatin Kukaj që ata na lanë. Këta 23-24 toponime i përkasin vetëm njerës lagje të Kastriotit, asaj të Çeliasit.

Këta toponime nuk ndodhen në Fushën e Katriotit, Fushën e Thatë, apo Sohodoll, siç është shprehur ndonjë studjues krahinor.

Zona rreth kalasë, ose kullës së Gjonit, sipas dëshmive te brezit para nesh, ka qenë e rrethuar me mure, që fillonin tek kishat më në lindje dhe përfundonin në perëndim të kopështit të Gjonit. Këta gjurmë që ishin në sipërfaqe u zhdukën me kthimin e ketij territori në tokë buke.

Në lindje të kalasë së Gjonit, pranë saj, ka kaluar Udha e Madhe; Ohër-Dibër-Lumë- Prizren, që kontrollohej nga Kastriotët.

Lagjia tjetër(sipas gojëdhënave) shtrihet në të majtë të përroit të Kastriotit, ose në jug të Kalasë së Gjonit. Këtu gjendet Katrioti i sotëm. Të moshuarit këtë territor fushor e emërtonin''Troja'', që me drejtim nga jugu shtrihet deri në Terzisht, (rrobaqepsi ne ate kohë) ku sot është shkolla e mesme e Kastriotit. Mendojmë se ky territor i përket ''Truallishtes së Gjon Kastriotit'' e përmendur nga humanisti Italian R. Volaterano bashkëkohës i Skënderbeut, e përforcuar nga dëfteri turk 1583. Ngjitur me truallishten e Gjonit në dokumente (d . 1583) është dhe truallishtja'' Kuka'', kurse në terren fare afër me njeri tjetrin kemi dy fshatrat, Kastriotin e Kastriotëve dhe fshatin Kukaj të fisit të Kukëve. Pra kemi dy fise fqinje, Kastriotët dhe Kukët, dy truallishtet, atë të Gjonit dhe të Kukëve ngjitur me njera tjetrën, dhe së fundi dhe dy fshatrat Kastriot dhe Kukaj, që të krijojnë bindjen se këtu kanë banuar Kastriotët. Gjatë gërmimit të themeleve të shtëpive të këtij fshati, jo rrallë është ndeshur në themele muresh të vjetra. Prej shumë vitesh, shkruan prof. Eqerem Çabej, kam formuar bindjen, se toponomastika shqiptare përbën mbase dokumentin më kryesor, që vërteton autoktoninë e popullit shqiptar. Toponomia e këtij fshati fletë mjaftueshëm për t'u bindur se këtu ka banuar i ati i Skënderbeut, Gjon Pal Dibrani dhe se këtu heroi ynë duhet të ketë kaluar vitet e para të jetës.

KASTRIOTËT DHE KUKËT

Ndonjë studjues krahinor shpreh dyshime për Kastriotin si vendbanim i Gjon Kastriotit duke aluduar për ndonjë Gjon tjetër, por pa asnjë bazë. Prezenca e ''Truallishtes Kuka'' pranë ''Truallishtes së Gjonit'' në dokumente dhe ne terren dhe e këtyre dy fshatrave Kastriot dhe Kukaj ngjitur me njeri tjetrin, hedhë poshtë cdo dyshim, shkruajnë studjues prestigjioz të kësaj fushe. Në ushtrinë e Skënderbeut, sipas disa burimeve historike, nga fisi i Kukëve kanë shëbyer si komandant të shquar dhe shumë besnik Pjetër Kuka, Pali, Rajani, Leka dhe Gjergj Kuka. Pra, Kastriotët dhe Kukët ishin dy fise që jetuan në fqinjësi, luftuan së bashku dhe na lanë farë pranë njeri tjetrit këta dy fshatra, Kastriotin e Kastriotëve dhe fshatin Kukaj të fisit të Kukëve, banorët e të cilëve edhe në ditët tona festojnë së bashku në gëzime familjare, përballojnë së bashku cdo fatkeqësi si të jenë, jo dy fshatra, por si një fis i vetëm. Varrezat i kanë pas të përbashkëta. Shërbimet fetare i kryejnë në të njejtin institucion bashkërishte... Një trashëgimëni e tillë vijon që nga periudha e Kastriotëve. Sipas disa burimeve historike(studime historike nr. 3\1979 dhe Dok. i Barcelonës, 6 tetor 1467) flitet se Kastriotët dhe Kukët ishin të nje gjaku.

DËSHMITË BAZË QË E BËJNË TË PAKUNDËRSHTUESHME ORIGJINËN DIBRANE TË KASTRIOTËVE

* – Vepra ''Komentarët'' e humanistit italian Rafael Volaterano, bashkëkohës i Skënderbeut, është botuar më 1506, dy vjet para botimit te Barletit dhe katër vite para ''Memorades'' së fisnikut Gjon Muzaka mbi Kastriotet. Ky autor është i paanshëm, i pa ndikuar nga të tjerë, pasi është i një kombësie tjetër dhe se botimi i tij është bërë i ditur para disa të tjerëve. Volaterano thekson, se Gjon Dibra, (ose Gjon Dibrani) kishte ''Trojen''dhe disa vise brenda vendit të tij. Të atit të Skënderbeut ai i jep si mbiemër emrin e krahinës, si dibran që ishte. Në se nuk do të ishte dibran Gjon Kastrioti, si mbiemër nga Volaterano do te kishte Hasin, Matin, Kastrin, Kastratin, apo ndonje tjetër.

*– Fisniku Gjon Muzaka, për gjyshin e Skënderbeut, Palin, thekson'' ..nuk kishte në zotrim më tepër se dy fshatra Sinën dhe Gardhin e Poshtëm. ''Keta dy fshatra figurojnë dhe në defterin turk të 1467-ës dhe ekzistojne në bashkësinë krahinore të Çidhnës në Dibër të Poshtëme, jo në ndonjë vend tjetër. Muzaka përjashton mundesinë e ndonjë pronësie tjetër të Palit, pasi shprehet, ''nuk kishte në zotrim më tepër se dy fshatra…'' e cila përjashton çdo mundësi të gjyshit të Skënderbeut për të patur prona të tjera

> Kanë kaluar shekuj, ndoshta është shkruar për Skënderbeun si për askënd tjetër kaq shumë. Do të kalojnë të tjerë, përsëri do të shkruhet. Ai burrë me veprën e tij historike i dha jetë dhe ekzistencë kombit të tij, emër kudo në botë, krenari të ligjëshme shqiptarëve kudo që jetojnë.



Shtatorja e Skënderbeut në Peshkopi. Vepër e skulptorit Sadik Spahija, realizuar e financimin e z. Zaim Korsi.



Ne foto: pamje nga punimet për ndërtimin e Memorialit të Kastriotëve. Shtator, 2018

(Vijon nga faqja 20)

si dhe për të qenë i një krahine tjetër. Dëshmia e Muzakës dhe dëfteri turk mbështesin njeri tjetrin. Si përfundim janë tre deshmi të kohës së Skënderbeut, e Volateranos, e Muzakës dhe dëfteri turk 1467, që dëshmojnë të njejtën gjë, mbështesin njeri tjetrin mbi Kastriotët si dibranë.

*– Shtojmë se në krahinën e Çidhnës nuk kemi një shfaqje sporadike të ndonjë kastriotasi të vetëm si diku tjetër.

Prof. dr. Kristo Frasheri, shumë i përkushtuar për historinë e Kastriotëve, që ka shkelur më këmbë më 1974 çdo pëllëmbë toke në Çidhën e cila lidhet me Kastriotet, në bazë të disa burimeve të pakundërshtueshme, argumenton në mënyrën më bindëse, se Kastriotët figurojnë si banorë të Çidhnës në harkun kohor prej 250 vitesh. Fillohet me Palin sipas Muzakës nga mezi i shek. XIV, me Dhimitrin sipas dëfterit turk 1467, me Palin sipas një regjistri turk 1571 dhe mbyllet me Jozef Kastriotin si përfaqsues i Çidhnës në kuvendin ndërkrahinor në Dukagjin të Matit me 1602. Në cilën krahinë të vendit tone kemi një prezence të Kastriotëve në 8 breza si në Çidhnën e Dibrës? Askund tjetër.

I referohemi Fjalorit Enc.Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave Shqiptare, Tiranë 2008, në fq. 1136 të të cilit thuhet:''Kastrioti është vendbanim i lashtë sipas gjetjeve tek Kodra e Gështenjës.Në shek e XIII ishte në zotrim të Kastriotëve .'' Nëse Pal Kastrioti u shfaq në Sinë në vitet 1350-75, sipas ketij informacionit më të fundit rezulton se Kastriotët dokumentohen si banor të Kastriotit në shek e XIII, pra dhe një shek para Palit te Sinës, që do të thotë se Kastriotët dokumentohen si banor të Cidhnës, jo më në 8, por në 11 breza.

A mund të hidhen poshtë burime të tilla të njëkohëshme me Skënderbeun shtuar këtu dhe toponiminë e pasur të kësaj krahine në përforcim të tyre për Kastriotët si banor të Çidhnës në Dibrën e Poshtëme? Logjikishtë, jo.

* Barleti që shkruan: ''Viset e Çidhnës, janë viset e Skënderbeut'' (fq. 695), shpreh një lidhje të pronarit me pronën në zotrim. Ai shtjellon shumë ceshtje të tjera për lidhje të ngushta, kontribut të vecantë, besim e besnikëri të lartë të dibranëve ndaj Skënderbeut, që i shërbejnë tezës dibrane te Kastriotëve. . Për ilustrim citojmë disa prej tyre;

* Skënderbeu nga Nishi me 3 nëntor 1443.... ''u nise me të vetët që këndej me shpejtësinë më të madhe dhe arriti në të shtatën ditë në Dibër...atë vend e njihte dhe e donte shumë.'' (Barleti''Histori e Skënderbeut'', bot. 1967, fq 69) Pse nuk u nis Skënderbeu për në Mat, Has, apo Mirdite?.. Vetëm tek njerezit e gjakut te tije, ai mund te bazohej për një sfidë të tillë, tepër të vështirë. Këte e përforcon pritja madhështore, e përmallshme, që dibranët mund t'ia bënin vetëm birit plot lavdi të Dibrës, të një gjaku me të, të rritur bashkë, askujt tjetër. Barleti shkruan:''Iu derdhën, pra, të gjithë rreth e përqark, e kush e kush më parë, tërë shend e verë dhe duke kërcyer nga gëzimi... një palë i puthnin duartë, një palë faqet e kokën, të tjerë këmbët, e pastaj gjithë trupin, duke e mbytur me përqafime të pambaruara.'' (Barleti, fq. 70 bot, 1967).

*Studjuesi dibran Haziz Ndreu, kur i referohet M. Sirdanit në veprën''Kastriotët dhe Skënderbeu në Trojet Arbërore'' ne fq. 26, për kthimin e Skënderbeut nga Nishi në Dibër shkruan: ''... u shmang me të vetët e voti në katund të Kastriotit, ku kishte fisin e vet. ''

* Me të mbërritur në Dibër, në fshehtësi e me shpejtësi të madhe, Skënderbeu thirri në takim të parët e vendit. Me 11 Nëntor1443 nën drejtimin e tij mbahet Kuvendi i Dibrës, në të cilin heroi ynë ua shfaqi dhe ua besoi planin e tij dibranëve, ku u vendos;të mblidheshin ushtarë, të pastrohej Dibra nga pushtuesit turq, të dërgoheshin përforcime me ushtarë përtej kalasë së Sfetigradit e malit të Mokrës për mbrojtje në rast sulmi nga turqit dhe të mblidheshin sa më shumë kryengritës për të qenë në gadishmeri për më vonë.

Këtu filloi formimi i ushtrisë kryengritëse, këtu u lidh besa dibrane, e cila do të materializohej për 25 vjet me plot shembuj heroizmi e besnikërie të pashembullt, jo vetëm në 18 betejat e zhvilluara në Dibër (nga 26 të tilla gjithësej ne vitet e Skënderbeut), por kudo në territoret e principatës së Kastriotëve. (Sipas Rakip Sinanit, ''Shënime Historike''referuar M. Barletit, bot. III Fq. 85, 86 Tiranë 1983).

* Ardhja e tij në Dibër s'ishte as spontane, as e rastësishme. Historianë të shquar, që shkruajnë se Skënderbeu më 1440 ishte sanxhakbej në Dibër, mendojnë se Heroi ynë, i kishte filluar me kohë pergatitjet për kryengritjen e përgjithëshme, por vetëm priste castin e volitshëm dhe kjo do të niste nga Dibra.

* Me dibranët Skënderbeu u nisë për marrjen e Krujës, kontribut që nuk përmendet askund, as si besueshmëri, as si vlerë. Barleti shkruan: ''..i shoqëruar nga disa dibranë (Skenderbeu), vazhdoi rrugën me shpejtësinë më të madhe për në Kruje. Barleti, fq. 70. bot. 1967 Ky ishte hapi i parë i mbështetje së Skënderbeut nga dibranët. . Barleti shkruan: ''Ai vetë (Skënderbeu M. K.) u drejtua menjëherë për tek porta së bashku me Hamzanë dhe me një tufë të tjerë pas dhe së andejmi e dërgoi atë bashkë me disa dibranë në Dibër, me qëllim që t'u lajmronin pjestarëve të planit të tijë (të parëve të Dibrës) çlirimin e qytetit dhe gjithçka tjetër kishte ndodhur...'' Barleti ''Histori e Skenderbeut''fq. 72 bot. 1967.

* Betejën e parë me turqit Skënderbeu e zhvilloi në Dibër të Poshtëme. Siç duket sulltan Murati II kishte vendos ta sulmojë Skënderbeun në vendlindjen e tij me mendimin se heroi ynë këtu kishte përqendruar forcat e tij mbrojtëse dhe se ketu do t'i jepej fund ''rrebelizmit'' shqipëtar. Në perëndim te diellit, Skënderbeu ngriti çadrat në Dibrën e Poshtëme pranë një pylli me druj shumë të dendur, shkrauan Barleti (në fq. 112 bot. 1976.) Kjo përplasje midis dy ushtrive, Beteja e Torviollit, në Dibrën e Poshtëme, përfundoi me shpartallimin e plotë të ushtrisë turke. Për këtë betejë, Barleti shkruan:''Luanët komanduan luanë''

* Barleti shkruan... Dibra... ''E Poshtëmja është e gjitha e rrafshtë dhe e rrethuar me fusha pjellore, që prodhojnë cdo gjë .Arbër dhe epiriot e banojnë atë vend, popuj shumë trima për luftë, me armët e të cilëve në radhë të parë e shpëtoi dhe e rriti Kastrioti mbretërinë dhe ia doli mb'anë çdo pune të rëndë e shumë të vështirë duke i patur kështu si Kolofonë kunder gjithe luftrave e mizërive të armiqëve.'' Barleti fq. 221, bot. 1967. Për trimërinë dhe aftësitë luftarake të dibranëve historiani turk Kemal Pashazade, kur fletë për Sfetigradin në Dibër shkruan: ''Në atë vend ndodhej një kështjellë e fortë, që ishte e njohur me emrin Koxhaxhik. Ajo ishte mbushur me të rinjë trima nga vendi i Juvan Ilisë (Gjon Kastriotit M. K.)të cilët ishin si luanë që të shqyejnë. ''

Eshtë një realitet historik (i mohuar) fakti, se Dibra ishte bazë kryesore e gardës se Skënderbeut, e furnizimit me ushtarë të ushtrisë së Heroit tonë, garanci fitoresh, për trimërinë, besën e besueshmërinë, aftësi të rralla luftarake në mbështetjen pa rezerva të Skënderbeut, , siç citon Barleti, ''me armët e të cilëve në radhë të parë shpëtoi dhe e rriti Kastrioti mbretërinë e tij''... Ndonëse Barleti në mënyrë të veçantë shkruan për peshën e rëndë të luftës që përballoi populli dibran dhe kontributin e jashtëzakonshëm (18 beteja vetëm në Diber), për çudi këtë kontribut dibran askund nuk e gjejmë në historinë tonë shqiptare. Ndoshta dhe të qenurit dibran te Skënderbeut, mund të jetë shkaku, që dhe lokalizimi i vendlindjes së tij zvarritet kaq shumë?!

ME KASTRIOTIN NIS ZGJERIMIN PRINCIPATA E KASTRIOTËVE.

Gjoni trashegoi nga i ati, Pali, vetëm Sinën dhe Gardhin e Poshtëm. Studjues prestigjioz te historisë si prof. dr. K. Frasheri, prof. Riza Lika, Agim Bobo, e të tjerë shpjegojnë se Gjon Kastrioti u vendos në fshatin Kastriot për të cilin fletë dhe toponimia e tij. Nga Kastrioti nis zgjerimin e saj principata e Kastriotëve. Si në shumë raste të tjera, kur princër, apo feudal kanë marrë emrin e vendit nga ku ka nisur fuqizimi i pushtetit të tyre, gjykojmë se Kastriotët morën si mbiemër emrin e fshatit Kastriot nga ku nisi vërshimin e saj Principata e Kastriotëve.

* Gjon Kastrioti, pas shtrirjes së sundimit të tij në Dibër deri matanë Sfetigradit, duke përfituar nga lufta për pushtet ndërmjet djemëve të sulltan Bajazitit, (pas vdekjes së tij më 1402), mori drejtim drejtë perëndimit, kështu bëhet zotërues dhe i Matit.

Z. Agim Bobo antar i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në shkrimin e tij ''Vendlindja e Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe mbështetësit e tij dibranë'' sjell një fakt më interes. Në një vendim të senatit të Shën Markut, me 20 shkurt 1445, në të cilin Skënderbeut dhe vëllait të tij Stanishit u jepet qytetaria e Venedikut, autori shkruan:''Në këtë vendim shohim se vëllezerit Kastrioti më parë ishin zotrues të Dibrës dhe pasi shtinë në dorë Krujën u bënë zotër dhe të Matit''...

Nuk ka vend për te gjykuar se Kastriotët ishin nga nje krahine tjeter, por zgjerimin e principates së tyre e filluan nga Dibra.

Ka plot fakte të tjera që vertetojnë se Kastriotët ishin nga krahina e Çidhnës. Këtu kishin pronat fillestare, këtu filloi ngjitja në fillim si zotër të Dibrës, më pas të Matit dhe shtrirja e sundimit të tyre drejtë perendimit arriti deri në bregdet.

* Eshtë Barleti ai që në veprën e tij na sjell një fakt tjeter. Skënderbeu, përveç këshillit të tij të Besëlidhjes për çeshtjet e mbrojtjes, kishte dhe një këshillë tjetër me të tijët dibrane (A. Bobo sipas Barletit fq. 477).

BETEJAT E DIBRËS

* Sipas studjuesve të historisë së Kastriotëve, nga 26 beteja gjithësej në vitet e Skënderbeut, 18 prej tyre u zhvilluan në territoret dibrane. Kjo fletë për kontributin e madh dhe peshën e rëndë të luftës, që ka përballuar popullsia e kësaj krahine. Ne veprën''Kujtime dhe Shënime Historike''të studjuesit dibran Rakip Sinani bëhet një pasqyrë e plotë e këtyre betejave. Shkurtazi përmendim vendin dhe kohën e zhvillimit të tyre;Beteja e Torviollit më 29 qershor 1444 në Dibër të Poshtëme, në Grykë të Radikës në tetor1445, beteja e Otonetës në shtator 1446, e Oranikut në gusht 1448, e Mireshit në maj 1449, e Sfetigradit maj-korrik 1449, e Sfetigradit(e dyta) në shtator 1449, e Modriçit në korrik 1452, e Meçadit në korrik 1452, e Oranikut në maj 1456, e Mokrës së Dibrës në gusht 1462, e Vajkalit në prill 1465, e Meçadit në qershor 1465, në fushë të Sfetigradit në korrik 1465, e Vajkalit në gusht 1465, Masakra e Çidhnës me 1 gusht 1466 dhe rimarrja e Çidhnës në prill 1467.

Masakra e Çidhnes ishte shprehja e egërsisë së tejskajshme e sulltan Mehmetit II nga dëshprimi pas dështimit të tij për marrjen e Krujës për të cilën u përdor tërë potenciali ushtarak i perandorise osmane. Për të shfryrë urrejtjen dhe për hakmarrje ndaj Skënderbeut, pas largimit nga Kruja, ushtria e tije e devijoi rrugën nga Elbasani për në Dibër të Poshtëme në krahinën e Çidhnës, atje ku Skënderbeu kishte të strehuar njerëzit e gjakut të tije.

Në se në Çidhën, Skënderbeu nuk do të kishte njerëzit më të afërt të tij, ushtria turke s'kishte pse te devijonte e të bënte një rrugë kaq të gjatë deri në Çidhnën e Dibrës. Tradhëtia si shumë herë të tjera vihet në shërbim të tragjedisë, të gjëmës. Pasi zbulohet shtegu i fshehtë që të dërgonte në kala, ushtria turke sulmoi njerëzit e pambrojtur te strehuar në këtë anë dhe bëri masakën më barbare, që ndoshta s'ka të krahasuar gjatë ekzitencës së perandorisë osmane.. Për këtë masakër një kronist turk shkruan: ''Ngado që të shkoje pas luftës, gjak do të shikoje, ngado që të shikoje kufoma do të gjeje''.

''Në betejën për rimarrjen e Çidhnës, në prill të vitit 1467, ushtria e Skënderbeut vrau 2 000 jeniçerët turq, që ishin vendosur në këtë kështjellë. (F. Noli '', Histori e Skenderbeut''fq. 103)

VENDLINDJA

Dy janë pistat më kryesore për vendlindjen e Skënderbeut, Kastrioti dhe Sina, dy fshatra në bashkësinë krahinore të Çidhnës, ku kanë banuar Kastriotët. Toponimia e fshatit Kastriot fletë për vendbanim të Gjonit në këtë vend. Viti i lindjes se Skënderbeut me 1405, i përket kohës kur filloi rritja me shpejtësi e zotrimeve të Gjonit, i favorizuar nga lufta për pushtet midis djemve të Sulltan Bajazitit, pas vrasjes së tij nga mongolët.

Gjykojmë se në vitet e para të zgjërimit të principatës së Kastriotëve si fillim deri në rrethinat e Vardarit, familja e Gjonit ka jetuar në Kastriot, çka të bënë të mendosh se këtu ka lindur Skënderbeu. Në përforcim të kësaj ideje sjellim një të dhënë nga intervista e studjuesit dibran Haziz Ndreu në veprën e tij ''Kastriotet dhe Skënderbeu në Trojet Arbërore''. Në fq. 26 të saj ai shkruan: ''Sulë Bruga nga fshati Gur-Lurë, në vitin 1973, në moshën 83 vjecare tregon: ''Emrin Çelias e kam dëgjuar për herë të parë në vitin 1906 në Stamboll nga mësuesi im i historisë. Në një orë mësimi, kur përmendet emri i Skënderbeut, një nxënës i një kombësive tjetër e pyetën profesorin, se ku kishte lindur Skënderbeu. Ai u përgjigj me një fjali të shkurtër:''Skënderbeu ka lindur në Çelias. ''Unë, vazhdon Sula, jo atëhere, por dhe sot e kësaj dite nuk e di në ç'vend është Çeliasi. ''Ky Çelias, sipas trashgimenisë së percjellë në breza (që ekziston dhe sot) ishte një lagje e Kastriotit te Çidhnës në vitet e Gjon Kastriotit.

'Po këtu autori i këtij libri bazuar në tregime popullore (në fq. 25) shkruan: ''.... që nga Dibra e Epër e deri në Lurë thonë, se vendlindja e Skënderbeut është në Kastriot. ''

Nga trashëgimënia gojore sillet dhe një mendim tjetër, se Skënderbeu lindi në lagjen ''Shëngjerdh'' në Sinë dhe u rritë në Çelias të Kastriotit. Sidoqoftë fjala e fundit për këta dy vende u përket arkeologëve.

Me 2 nëntor 1985 në fshatin Sinë u përurua një muze modest kushtuar Kastriotëve. Në sesionin shkencor të organizuar me këtë rast me temë''Mbi origjinën e Kastriotëve'' merrnin pjesë figurat më të shquara të historisë sonë si, Stefanaq Pollo, Kristo Frashëri, Selami Pulaha, Luan Maltezi, Maliq Horshova e të tjere. U krijua përshtypja, se po lokalizohej origjina e Kastrioteve ne Dibër të Poshtëme në krahinën e Çidhnës. Por, po bëhen mëse tri dekada e askush nuk po kujtohet më, se historianë e pushtetarë të këtij vendi një borxh ia kanë më të madhit të kombit shqiptar të të gjitha kohërave, Gjergj Kastriotit, Skenderbeut, lokalizimin e origjinës krahinore dhe saktësimin e vendlindje së tij.

Edhe një njeri sado i thjeshtë, e ka një origjinë krahinore, një vendlindje. Ende nuk e gëzon këtë të drejtë HEROI ynë kombëtar, jo se mungon informacioni i duhur, kushtet apo mundësitë, por për indiferentizëm, e ndoshta vetem pse ai është dibran... Me këtë trevë, Çidhnën, komunizmi u gjakos, pati probleme shqetësuese për 50 vite. Po tani pse heshtet?

U ''çmendën'' pas Skënderbeu studjues historianë, shkrimtar, strateg ushtarak, piktor, muzikant, e te tjerë nga vendi e sidomos nga bota, si dhe politikanë të rengut me të lartë, në Europë, Azi dhe gjerë matanë Atlantikut. Me 2005, në tempullin e dijes, kryeqendrën botërore të kulturës dhe shkencës, në Nju York, si dhe në Boston e vende te tjera, mbahen sesione shkencore në kujtim të veprës historike të Skenderbeut. Dy senator të nderuar Tom Lantosh dhe Dana Rohrbaker paraqitën një rezolutë në Kongresin Amerikan në nderim të veprës historike të Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu me rastin e 600 vjetorit të lindjes së tij. Një ngjarje e pazakont dhe një vlersim i madh për kombin tonë. Me këte rast senatori Dana Rohrbaker në intervistën e dhënë para gazetarëve është shprehur:''Skënderbeu, kjo figurë historike, ndali përparimin turk drejtë Europës, perëndimit, duke ndryshuar historinë dhe mënyrën tonë të jetesës''.

Kanë kaluar shekuj, ndoshta është shkruar për Skënderbeun si për askënd tjetër kaq shumë. Do të kalojnë të tjerë, përsëri do të shkruhet. Ai burrë me veprën e tij historike i dha jetë dhe ekzistencë kombit të tij, emër kudo në botë, krenari të ligjëshme shqiptarëve kudo që jetojnë.

Viti 2018 është shpallur viti i Skënderbeut nga Kryeministri ynë....Gjykuam ne dibranët, se Dibrës si origjinë, vendlindje e Skënderbeut si dhe për peshën më te rëndë të luftës me 18 betejave të zhvilluar në këtë trevë, do t'i bëhej diferencimi në këtë vit të Skënderbeut.Gjykuam se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sporteve do të komunikonte me historianë e studjues te Kastriotëve dhe se në Diber, veç të tjerash do te behej nje konferencë shkencore kombëtare mbi Kastriotet si dhe në Kastriot të Dibrës do të ndërtohej si fillim një përmendore madhështore kushtuar birit te Dibrës, (me pas nje muze modern,) lavdia e të cilit është prezent në të gjithë kontinentet e botës, si ne asnjë tjetër.

Rruga e Arbërit nr. 149

E vogla Elda vetëm 11 vjeç prej vitesh nuk dëgjon tingujt e ziles së mësimit e cila ishte aq e dashur për të. Aromën e librave, bankave, lapsave me ngjyra nuk i kujton më, për të mos përmendur shkronjat që nuk mendohet ti mbajë mend.

Elda, historia e një vajze që nuk shkon në shkollë

Nga **SAMET ZAGRADI**

"-N'shkollë kam qejf me ardh, por babi nuk m'len! Ai ka merak mos dikush më fol e unë mos e turpnoj. Tash jam e madhe e duhet me u kujdes për shtëpinë. Ai do m'rrafë me mpa tu fol me shoqet poshtë gardhit. Unë nuk kam shokë, se baba mthotë që cucat duhet të rrinë me cuca. Ai nuk mle as me lujt me to!" Me gjysmë shpirti e me sy të skuqur nga dhimbja, kërkon të gjej forcë teksa sheh me admirim shoqet e saj me libra në duar. Kërkon të jetë me to por nuk mundet. Kërkon të shmanget por kthetrat e forta të mentalitetit barbarisht e kanë mbërthyer akoma pa dalë në jetë. E vogël, trupnjomë me sy të jeshilta e një fytyrë dukshëm të lodhur nga dhimba ajo vuan. E paveshur e me flokë të trazuara pa drejtim si për ironi të fatit ngjan shumë me situatën në të cilën ndodhet. E vogla Elda vetëm 11 vjeç prej vitesh nuk dëgjon tingujt e ziles së mësimit e cila ishte aq e dashur për të. Aromën e librave, bankave, lapsave me ngjyra nuk i kujton më, për të mos përmendur shkronjat që nuk mendohet ti mbajë mend.

Ajo jeton në një shtëpi të vogël, të vjetër diku në një fshat të thellë të Maqellarës në Dibër, e cila brenda mureve të saj shekullorë ka arritur bë mbajë fort idetë të cilat në realitetin e sotëm kalojnë përtej të paimagjinueshmes. Ide që patjetër brez pas brezi sa vijnë e forcohen duke i bërë ballë kohës e duke pasur akoma ndikim tek këto njerëz. Te ngulitura thellë në të ndërgjegjshmen e tyre këto fëmijë bëhen pre e një veprimi makabër duke u shkatërruar një jetë të tërë. Elda është e mesmja prej 3 fëmijësh që kësaj familje zoti i dhuroi duke qenë kaq bujarë me to. Të shëndoshë e të bukur si vetë natyra këto fëmijë hasin probleme çdo sekondë të jetës, edhe në ëndrrat e tyre! Sytë e tyre duket sikur kërkojnë shpresë për të qenë si gjithë të tjerët, e për të pasur fatin të jetojnë një jetë normale. Dhimbshëm shohin moshatarët e tyre kur prindërit apo gjyshërit i presin tek dera e drunjtë e shkollës e për ta këto prindër as ato vetë nuk i lejnë të shkojnë duke ushqyer fort ndjenjën e padies.

Shtatori nuk ndryshoi gjë nga përditshmëria e saj. Lutja disa mujore që buronte thellë nga shpirit nuk arriti që të atit të saj ti mbushej mendja që Elda si gjithë shoqet e saj të ulej në bankat e klasës së saj. Shtëpia shekullore, gati e rrënuar gjendej pranë shkollës dhe një rrugë i ndan në mes. Të rrënuar nga ana shpirtërore e të pangopur me asnjë lloj harmonie në familje, ku nëna dhunohej në sy të fëmijëve e fëmijët nuk njohin asnjë të drejtë që kushtetuta dhe ligji u ka caktuar. Ligjin e bën babai, duke u vetëquajtur pardon i çdo frymori që merr frymë brenda atyre mureve dhe jo vetëm.

Vjeshta erdhi! Shkolla dukej sa afër po aq larg për të. Çdo mëngjes vjeshtor Elda detyrohet të ngrihet herët, të bëjë kafetë, të përgatisë vëllai vetëm dy vjet më të madh që shkon në shkollë, të mbushë bidonët me ujë e më pas të ndjekë çdo urdhër që vjen nga lart. Vjeshta erdhi dhe sigurisht që punët do të shtohen pasi jetojnë në fshat, e kush jeton në fshat e di mjaftë mirë çfarë do të thotë të punosh në fushë. Elda, nëna e saj dhe gjyshja do bënin çdo punë teksa i ati bënte patrullimin e çdo dite në klubet që prej vitesh vazhdon ti frekuentojë. Ishte klient i përhershëm, të gjithë e njihnin e sigurisht një pjesë nuk gëzonte respekt për të. Shpesh herë përfundonte i pirë, duke dhunuar gruan, fëmijët dhe nënë e tij tashmë në moshë të thyer. Varfëria dukej se ka mbytur çdo mundim për ringritje duke i zhytur si gur çdo ditë e më poshtë.

"-Kur bie zilja e fëmijët në rrjesht për një hyjnë në klasë unë mbyllem n'dhomë e qaj pa zë, qaj se du me shku te shoqet, te mësuesja që cdo ditë e lut tim atë me m'lan me shku nshkollë. Sa herë shkoj për me mbush ujë lej bidonat e fshehtas dëgjoj sa bukur lexojnë, leje më kur ata këndojnë. Unë dua që kurr të rritem të bëhem këngëtare sepse më pëlqen shumë kënga. Ndonjëherë mësuesja me fut brënda, më jep rroba e më thot që ti do bëhesh një nanë e mirë. Një ditë teksa fshehtas dëgjoja, bidonat u zhdukën, e kur shkoj nshpi baba nuk më la të dilja për tri ditë rrjesht nga oda. Nana ashtë e smurë e gjyshja e vjetër nuk mund me ja ndryshu mendimin babit. Unë e dua shumë atë, por dua me shkue nshkollë edhe unë si gjithë shoqet e mia". E trembur ajo tregon vetëm majën e një mali të gjigant të problemeve që ajo mban brenda në zemrën e saj.

Elda nuk din të shkruaj, as vëllai i saj madje edhe nëna me të atin nuk mund të lexojnë rrjedhshëm qoftë edhe dy fjali të vetme. Bujqësia dhe hamallëku ka qenë baza e ekonomisë së babait rreth njëzetë vite më të re se nëna e këtyre fëmijëve të pafat dhe të braktisur nga çdo e mirë minimale. Varfëria i ka ndjekur këto njerëz në çdo hap duke lënë pasoja të cilat prej brezash fatkeqësisht trashëgohen duke bërë që fëmijët të jenë kopje e shëmtuar e prindërve të tyre. Varfëria sjell dhunë, dhuna sjell padijen e çdo gjë kthehet pas njësoj si askush nuk do të donte të ishte. Zakonet prapanike dhe në kundërshtim total me kohën, bëjnë që këto fëmijë të mos shkojnë në shkollë duke u vënë përpara një mur të pa kalueshëm për të qenë dikushi në jetë. I mbyllur në botën e tij të vogël, duke ndjekur zakonet e shpikura nga ai vetë ky baba bën që Elda të mos shkojë në shkollë, të mos ndjek ëndrrat duke bërë një krim që koha do ta tregojë. Pas disa vitesh Elda do të martohet dhe sigurisht që ketë fatin e nënës së saj. Ajo nuk din të shkruaj, nuk din të lexojë, nuk din të flas dhe është e frikësuar në çdo moment.

Si Elda që (sigurisht nuk është emri i saj i vërtetë) në Shqipëri fatkeqësisht ka shumë. Shumë vajza akoma nuk lejohen të shkojnë në shkollë, duke i martuar në një moshë fare të re e duke u mohuar cdo ëndërr që ato kanë në veten e tyre. Në Shqipëri akoma femra trajtohet si pronë e të atit, burrit duke pasur një fat të kontrolluar nga të tjerët.

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/ menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin:
069 20 68 603.

Ikja e shpejtë e Ledios dhe mesazhet e familjes Methasani, për të gjithë ata që qëndruan pranë tij.

Ledio, dhimbje dhe dashuri...!



Kanë kaluar dIsa kohë që kur familja, fisi Methasani, por edhe fshati i madh Sohodoll, përjetuan një dhimbje që duket se ka lënë gjurmë kujtese akoma edhe sot e ndoshta për vite e ndoshta për vite e vite me radhë do të kujtohet. Pas një sëmundje të gjatë, është ndarë nga jeta djaloshi simpatik Ledio, që nuk i rezistoi dot sëmundjes edhe pse për më shumë se dy vjet, qëndroi stoik në spitalet e Italisë. Edhe pse dinte çfarë kishte, Ledio kurrë nuk dorëzohej dhe vetëm qeshte e thoshte fjalë të bukura. Komentet e tij në rrjetet sociale, apo mesazhet që përcillte hera-herës përmes telefonit, vërtet bënin përshtypje. Lajmi i ikjes së tij nga kjo botë ka qenë shumë i rëndë dhe ajo mbrëmje e zezë në Rinas kur trupi i tij i pajetë mbërriti, ishte nga më të vështirat për të gjithë ne dhe familjen e tij. Shemsiu dhe Sabria nuk ishin vetëm, sepse dhjetëra e qindra njerëz, kishin dalë në aeroport, për t'jua lehtësuar këtë dhimbje kaq të madhe. Por ikja e Ledios ishte pa kthim, ndërsa mjaft doktorë, miq, apo artist, ishin pranë tij në dhomën e spitalit, me e vizituara nga të gjithë pacientet. Edhe pse vetëm 12 vjeç, ai respektohej sikur të ishte një burrë i madh, sepse dinte të të bënte për vete dhe të dhuronte vetëm mirësi e buzëqeshje. Në shtëpinë e tyre në fshatin Sohodoll, akoma hyjnë e dalin njerëz, si të ishte dita e parë e ndarjes së tij. Por prindërit e Ledios, dhimbjen e ruajnë në shpirt dhe me po kaq patos, kërkojnë të shprehin mirënjohje dhe fjalë zemre, për secilin që u lut për të, për mjek, miq, apo artistë që ishin pranë tij.

Fillimisht prindërit duan të shprehin mirënjohjen për familjen Antonio Guarna nga Rexho Kalabria, të cilët vunë të parët dorë në dëshirën për të shëruar Ledion.. Pastaj ky person bashke me Enzo Krea dhe shokët e tyre, ndihmuan për ta dërguar ne spitalin e Romes. Edhe aty dashuria dhe përkujdesja kurrë nuk i munguan djaloshit shqiptarë që dinte të bënte për vete çdokënd. Por mirënjohja është gdhendur për disa prej mjekëve italianë, si Dr Antonio Ruxhero, Palma Maurisio, Silvio Mastranxherio dhe Atina si dhe personeli i spitalit onkologjik i pediatrisë GEMELLI ne Rome, që bënë gjithçka për jetën e tij. Nga ana tjetër, dy artistë me emër, Nojzi dhe Gali vinin e shikonin shpesh dhe e bënë të famshëm jo vetëm në këtë pavion, por edhe në rrjetet sociale Ledion e vogël. Vizitorët në spitalin ku ishte Ledio ishin të shumtë. Ai edhe pse o vogël, bëri miq edhe atje. Një shqiptar nga Lezha, që quhej Besmir Celkupa dhe shoqja e tij, kanë mbetur në kujtesë gjatë për dashurinë që ofruan. Ndëkaq që zonjat e nderuara italiane, Viktoria Dafne, XHorxhana Atanasia dhe Francha Spinella dhe principesh e e LEDIOS Ramona Barbietola u bënë pjesë e familjes Methasani me vizitat që bënin në dhomën e tij...

Gjithsesi, ishte e pathënë që me gjithë këtë përkujdesje, interesim dhe mbështetje, Ledio të ishte sot pranë nesh... Familjes së tij i mbetet ti gëzohen sot dy fëmijëve të tjerë, Albi dhe Neviana, por edhe dashurisë së pakufishme që njerëzit ofruan për Ledion dhe kujtimeve të pafund në adresë të tij. Kur ikin nga kjo botë, ka njerëz që vdesin dhe ka të tjerë që ndahen. Ledio ka vetëm ndarje dhe kurrë s'ka vdekje, sepse gjërat që la pas e bëjnë atë të pavdekshëm dhe familjes e miqve, ju rezervojnë kujtime e mbresa të pafund...

DEFRIM METHASANI





homazh

Takimi i fundit me Rexhep Smaçin



Nga **SHAQIR SKARRA**

Kurrë nuk e kisha menduar se do të shkruaja një ditë për vdekjen tënde Rexhep! Por ja që ndodhi dhe e paskam mjaft të vështirë, mjaft të pa mundur, pasi lotët në të tilla momente nuk komandohen dot.

Të ikësh fare pa pritur, befasisht në një moshë të bukur ku ende prisnin të gjithë nga ti edhe më shumë, ndarja jote nga kjo botë gënjeshtare na la pa fjalë të gjithëve. Ashtu si për vetë moshën tënde që premtonte jetë, e them sot edhe nga dhimbja, me pikëllim të thellë, se me ty jeta u tregua shumë e pa drejtë, shumë tinzare dhe të mori shpejt nga kjo botë krejt e rrejshme.

U bënë njëzet e ca ditë që jemi pa ty, njëzet e ca ditë që na mungon Rexhep, njëzet e ca ditë që nuk po e dëgjojmë më atë zilen e shpeshtë të telefonit. U bënë njëzet e ca ditë Rexhep që na mungon buzëqeshja jote, bujaria jote, fisnikëria jote, modeli yt i veçantë i të qenit njeri.

Ajo dita e gjashtë shtatorit kur mora vesh për vdekjen tënde ishte e vështirë për mua. Ishte e vështirë se nuk na e krijove edhe njëherë mundësinë të takoheshim siç takoheshim shpesh te Veri, të çmalleshim, të iknim me kujtesën tonë në kohë e vite të largëta, të kujtonim vitet e rinisë, të bëheshim sado pak nostalgjik për vendlindjen tonë të dashur, Shumbatin. Eh! U desh përsëri Veri që unë të marr vesh për vdekjen tënde. Takoheshim shpesh te Veri unë e ti Rexhep. Më binte shpesh zilja e telefonit dhe në ekran shfaqej emri yt Rexhep! Po tani atë zile dhe atë emër në telefonin tim nuk do ti dëgjoj më, ndaj e kam të vështirë sot të shkruaj, ti them dy fjalë zemre, shpirti e malli Rexhep.

U takuam edhe para pesë muajsh bashkë, qëndruam gjatë, i ramë cep më cep fshatit me kujtime, projektuam diçka të mirë dhe të bukur në dobi të fshatit, por ku ta dija unë se ai do të ishte takimi i fundit?

U ndjeva në faj Rexhep, sinqerisht u ndjeva në faj. Unë e dija se je në spital por nuk munda të vija të të shikoja qoftë edhe njëherë të vetme në të gjallë. Jo, nuk munda. Nuk mund ta pranoja që ta shikoja ashtu shtrirë në një dhomë spitali, mikun, shokun, bashkëfshatarin, intelektualin e kompletuar, njeriun e mirë, fjalë pak e model Rexhep Smaçi.

Nejse ky mund të jetë edhe një justifikim i kotë por sinqerisht ndjehem me faj dhe ndaj ky shkrim le të shërbejë edhe si një pendim i madh për mua por tashmë ajo që u bë nuk zhbëhet.

U lindëm të dy në një fshat të bukur, me njerëz fisnik e bujarë por varfëria ishte ulur këmbëkryq në vatrat tona.

Ti ishte ndryshe, Rexhep, ishe krejt ndryshe nga fëmijët e atij brezi. Ishe ndryshe se ishe i heshtur, i qeshur, i dashur me të gjithë e nxënës i shkëlqyer në mësime. I doje njerëzit shumë, e doje jetën!

Por le të dalim edhe njëherë tek shkolla që edhe në momentet e fundit të jetës tënde kur ishe i shtruar në spital mundoheshe t'ju jepje këshilla të gjithëve për shkollën dhe dobinë që kishte ajo .

Po të shfletosh sot të gjitha regjistrat në shkollën nëntë vjeçare "Hasan Leka" Shumbat, nga viti në vit emri yt shënon vetëm notën dhjetë, nuk e njeh fare nëntën. Por në një shkollë të zgjedhur e të kërkoje bursë për ty ishte një tabu, ishte e vështirë. Atëherë ishe ende fëmijë e nuk e kuptoje, por vite më vonë e kuptove dhe ti se kishe një "kleçkë" të vogël. Të parët e tu diku kishin "gabuar", "kishin shkelur në kallo" shtetin e ndaj edhe ti duhej të paguaje nga ky haraç. Njolla e zezë në biografi të ndiqte pas si hije e zezë kudo ku hidhje këmbën, por ti nuk u dorzove, nuk u përkule, me forcë, vullnet dhe kurajo vazhdove shkollën e mesme në Sllovë. Ishte larg shkolla nga shtëpia jote, rrugë e vështirë, mbi një orë, në ditë me diell e borë , stuhi e furtunë por ti kurrë nuk mungove, kurrë nuk e le një orë mësimi pa zhvilluar, dhe në fund të katër viteve rezultatet ishin shkëlqyeshëm në të gjitha lëndët. E mbarove shkollën e mesme me rezultate të larta që siç do të shprehej vite më vonë Naim Plaku, mësues i asaj shkolle "nxënës si Rexhep Smaçi do të mbeten gjithmonë, ndër vite krenaria e asaj shkollës".

Dhe megjithatë nuk e more mundin dhe sakrificën tënde, nuk ta dhanë vlerësimin. Kishe kusure Rexhep! Kishe kusure shumë që duhej ti paguaje ti në atë moshë të re që sapo e kishe filluar jetën. Po thuaj gjysma e klasës tënde vazhduan studimet e larta. Ishin me nota shumë e shumë poshtë teje. Por ty , njolla e zezë në biografi të ndiqte si fantazmë, të ndiqte kudo. Ti e e kuptove më vonë edhe pse ishe i ri në moshë por ishe i pafuqishëm për ta hequr ndaj e luftove gjithmonë me heshtjen tënde , me zgjuarsinë tënde, me kurajon dhe forcën tënde dhe në fund përsëri ti fitove. Të gjitha përpjekjet që bënin dështuan me turp.

Të dërguan në minierën e kromit në Bulqizë ku u njohe në moshë të njomë me ato zgafellat e frikshme të nëntokës. Nuk di se pse e bënë këtë. Ishte stash, ishte dënim për atë që kishin bërë të parët e tu apo..... Nejse ti si gjithmonë i urtë, i sjellshëm, i bindëshëm pranove me "dëshirë" për të vajtur në Bulqizë. Jeta ishte ndryshe këtu, jo si në Shumbat. Kishte lëvizje qyteti, kishte gjallëri si ditën edhe natën. i shikoje minatorët kur dilnin nga galeritë që nuk njiheshin, ishin sterrë nga pluhuri dhe lagështira e nëntokës. U fute dhe vetë nëpër këto galeri, u fute në një kohë kur duart i kishe të njoma e pa kallo, kur shpatullat e tua ishin tepër të njoma për të shtyrë atë vagon me mineral kromi mbi shina. Punove shumë, djersite, u lodhe, vrave ndonjë gisht e këmbë nga pakujdesia por nuk u tërhoqe përballë vështirësive. Jo pak, jo një një muaj, jo një vit por katër vjet derdhe djersën tënde nëpër galeritë e frikëshme të Bulqizës. Të binte vagoni me mineral kromi nga shinat, të fikej kandili me karbit dhe ashtu , në errësirë, i vetëm dhe pa asnjë pranë i vendosje shpinën e njomë vagonit mbushur plot me mineral kromi. Lodheshe, djersiteshe, vriteshe dhe më së fundi vagonin e vendosje përsëri në shina. Duhej realizuar norma, bile dhe tejkaluar. Paga e jote ishte ndihmë edhe për familjen në fshat. Besoje shumë se një ditë do të dukej drita në fund të tunelit. Besoje se do të vinte koha edhe për ty birin e mirë të Shumbatit ,do të vinte koha të futeshe në uaditoret e universitetit. Kryebiseda jote kudo e nëçdo situatë universiteti ishte. Në punë në galeri, në dhomë, nëpër rrugët e Bulqizës në kohë të lirë, në kafene me miq e shokë.

Ëndëra për të vazhduar universitetin u bë pjesë e pa ndarë e jotje Rexhep në ato katër vite në minierën e kromit. Bile e dhe shokët e tu që punonin në të njejtin front e bënë shqetësim të tyre, por hija, hija të ndiqte pas. Askush nuk e shikonte se ishte e pa dukshme kurse ti po. E ndjeje shumë, e shikoje, e kishe pranë bashkëudhëtare në jetën tënde. Eh kjo lufta e klasave deri ku i kishte shtrirë metastazat e saj?.

Dhe megjithatë besoje shumë se do të zbardhte drita edhe për ty Rexhep, dhe në fakt nuk ishe gabuar . Dështuan të gjithë përballë vullnetit tënd, përballë forcës tënde, përballë zgjuarsisë tënde. Kishe fituar tashmë të drejtën për të vazhduar shkollën e lartë në Tiranë, një ëndërr që të kishte mbetur prej vitesh në sirtar.

Ti uleshe për herë të parë në auditoret e universiteti, shokët e tu kishin përfunduar, kishin filluar punë sipas profileve. Katër vjet të shkuan kot Rexhep, katër vite bëre një shkollë të vështirë nëpër zgafellat e Bulqizës. Më së fundi erdhi dhe dita e shumë pritur.

U nise atë mëngjes shtatori drejt Tiranës me një valixhe të thjeshtë druri por punuar bukur e me shije nga një dorë mjeshtri që punonte drurin. Vetëm pak rroba dhe asgjë më shumë. Me vehte more dhe mallin për nënën, babain motrën dhe vëllanë.

Këtu ndryshonte çdo gjë Rexhep, ndryshonte metropoli shqiptar me Bulqizën e frikshme dhe me Shumbatin tënd që nuk e ndërroje me asgjë në botë. Jeta studentore vërtet e bukur. Gjatë asaj periudhe lexoje shumë, studioje shumë dhe kur u ktheve me diplomën e shkollës së lartë në vendlindje ishe një ndër studentët më të mirë të Dibrës që kishit mbaruar në atë vit.

Ishte viti 1988 dhe fill pas përfundimit të shkollës të dërguan në kooperativën bujqësore të Fushë-Çidhëns, në detyrën e vështirë shef i zyrës së planit. U largove nga Fushë-Çidhne me vlerësimet maksimale, me përshtypjet ma të mira nga të gjithë si nga fshatarët por edhe nga kuadri. Erdhe në Ndërmarjen bujqësore Shumbat dhe atë Kastriot. Edhe këtu qëndrove kuadër dinjitoz, qëndrove mbi të gjitha njeri.

Pas viteve nëntëdhjet u vra frika për të gjithë, u largua ajo njolla që të ndiqte si fantazmë. Fillove punë në policinë financiare në Peshkopi, në audit në prefekturë por ti ishe po ai Rexhep, punëtor, i heshtur, kurajoz, i drejtë, i rregullt në marrëdhënje me punën dhe të tjerët se kështu ishe brumosur herët, se i tillë ishte karakteri yt.

Jeta e njeriut është si një udhë.Në fund të kësaj "udhe" të shkurtër apo të gjatë, të lehtë apo të mundimshme, të dështuar apo të sukseshme, njeriu përllogarit "faturën" e tij përmbyllëse, duke nxjerrë bilancin përfundimtar të viteve të jetës së tij. Se si del vlera e bilancit, pozitiv apo negativ, kjo varet nga vetë njeriu, se sa kova me dhe ka mbartur ai ndër vite për të ndërtuar "malin" e tij.

Në atë që po mundohem të shkruaj dëshiroj të nxjerr në dritë jetën e një njeriu me kontribut të gjatë, në të mirë të vendit, të zhvillimit dhe të emancipimit të shoqërisë, të dibranit Rexhep Smaçi.

Karakteri i njeriut formohet e forcohet në përpjekje për të arritur gjithmonë më të mirën, duke u kacafytur shpesh me të keqen e cila ka për detyrë "të zërë rrugën". Të të mundojë e të të lodhë shumë që ti të dorzohesh, por ti Rexhep nuk ishe i tillë, nuk u dorzove kurrë nga rruga e minuar ku shkelje se e hidhje hapin me kujdes.

Rexhep, e njohe mirë jetën, me uljet e ngritjet e saj, duke e filluar atë nga hiçi për të arritur më vonë shumë në formimin tënd, do ti falnin , për të ndërmarrë më pas veprime që në fund të fundit do të ishin si një shtërngatë për ti dhënë vetë jetës drejtimin e duhur.

Gjërat më të bukura apo ato që të dëshpërojnë në jetë nuk mund të dëgjohen, të shihen ,as të preken.Ato vetëm mund të ndjehen. Brezi yt Rexhep dhe i shokëve të tu ishte i vështirë , përjetuam kohra shumë të vështira por që në fund të fundit ato që deshën të mbesin njerëz përsëri njerëz mbetën, ashtu siç mbete dhe ti Rexhep.

Karakter në gjëra të vogla apo mëdha do të thotë të marrësh përsipër ato gjëra që ti ndjehesh i zoti ti bësh.

Je i vyrtytshëm kur ndërmarjen e guximshme e bën vetiu e jo kur ta kërkojnë të tjerët. Në jetën me plot ngjarje të lakmueshme të Rexhep Smaçit, gjen njeriun e bindur për të kryer veprime të guximshme, pa e ditur se ai ato i bën nën trysninë e ndërgjegjes së pastër dhe të njeriut idealist.

Kam parasysh këtu veprimtari të tij , të cilat kur i sjellim e i ballafaqojmë me atë çka bëjmë ne të sotmit, për vendin, për flamurin të cilit i këndojmë nga mëngjesi në darkë e nga darka në mëngjes, të duket sikur atdheu është në dorë të intrigantëve të cilët të drejtët dhe idealistët i marrin për naiv e budallenj.

Jeta ka provuar se ai që shpërfill mundimin, vuajtjet, përgjithësisht sakrificën për të arritur diçka të vyrtytshme, në fund ndjehet i lumtur dhe i plotësuar në shpirt e në ndërgjegje. Rexhep Smaçi i ngjan pa dyshim i ngjan, është "binjak" me çdo njeri që i ngjit shkallët e karierës me urtësi, duke e konsideruar pozicionin apo një detyrë të lartë qoftë partie, qoftë administrative si një premtim të mundimit për të arritur deri aty.

Janë vetë sfidat ata që e bëjnë jetën interesante e këto sfida nuk munguan as në jetën tënde Rexhep. Ti nuk ishe vetëm një ëndërrimtar për ti kryer punët ashtu siç duhej. Kishe edhe bindjen se brenda vetes fshihej forcë, durim dhe pasion për të gjetur fjalën me të gjithë.

Thonë se fati nganjëherë troket në derë. Erdhi koha të krijoje familje Rexhep. Duhej një vajzë e mirë si ti dhe vërtet e gjete.

Vjollca Nesimi nga Rabdishti ishte natyra jote, karakteri yt, ishte njeri i përsosur që edhe sot pas kaq vitesh këdo që të pyesësh në Shumbat për Vjollcën nuk dinë të thonë fjalë tjetër por njeri i përkryer që edhe kur ishte me punë në Peshkopi, mjaft ti thoshin se jemi nga Shumbati dhe nga zyra e saj nuk doli asnjë pa përfunduar punë.

Por ja që pikërisht në kohën që familja jote ishte konsoliduar, me shtëpi dhe punë ishit të dy,vajza e madhe Erida e mbaroi shkollën e lartë dhe po bën specializime në Gjermani, Elsa mbaroi dhe kjo për ekonomi si dhe masterin, djali yt Erioni sapo përfundoi gjimnazin, vdekja e pa pritur nuk të priti më gjatë.

E la Vjollcën me lotët në sy e rrobat e zeza veshur si dhe me detyrimin e përgjegjësinë më të madhe për vazhdimin më tutje për fëmijët. Dhe jam i bindur se ashtu si ti, edhe vetë Vjollca do ta shtojë edhe më shumë merakun e shqetësimin dhe fëmijët do të vazhdojë ti edukojë ashtu siç i edukove ti.

Jeta dhe vdekja qenkan të dyja bashkëudhëtare në të njejtën udhë, dhe ne bashkë me to ecim çdo ditë, por kur vdekja merr dhe moshat e reja kjo është vërtet tragjedi, por nuk kemi forcë, duhet ti bindemi fatit të gjithë.

Ti ishe në një moshë që familja, shoqëria prisnin më shumë prej teje por nuk ishte e thënë. Si njeri i ndershëm, i vendosur, i sinqertë dhe me zë të mirë, të drejtë e të pa epur nëpër kohë, i çmuar dhe i mirënjohur kudo ku punove, meriton jo vetëm nderim për shumë çka por edhe ngushëllim të veçantë me këtë rast.

Dhëmbja për ty nuk i takon vetëm bashkëshortes tënde, Vjollcës, fëmijëve të tu, vëllait, Petritit, motrës, Violetës por të gjithëve se ishe dhe mbete i mirë me të gjithë. Unë edhe sot tek po hedh këto radhë për ty Rexhep e ndjej shumë mungesën tënde. Aty jam ulur tek ajo tavolina që rrinim gjithmonë bashkë, aty do të ulem gjithmonë. Vije pas pune i lumtur dhe më tregoje dhjetat që kishte marrë Erida në shkollën e mesme dhe përsëri nuk ishe i kënaqur. "Ka mundësi për më shumë, jep edhe më" më thoje mua por buzëqeshjen nuk e fshihje për këto rezultate të larta të vajzës tënde. E dije mirë rëndësinë e shkollës, kujtoje vitet e tua, vuajtjet dhe sakrificat që kishe bërë për tu arsimuar e ndaj kërkoje tek fëmijët shumë e më shumë. Sot imazhin e mirë të babait fëmijët e tu nuk do ta shlyejnë kurrë nga kujtesa. Vdekja jote është vdekje fizike se shpërtërisht ti nuk ke vdekur, do të rrosh gjithmonë në kujtesën tonë.

Lamtumirë miku, shoku dhe njeriu i mirë Rexhep Smaçi!





Festa e të Korrës

Tri ditë gëzohemi vjeshtës

KJO REKLAMË ËSHTË KONTRIBUT
I GAZETËS PËR PROMOVIMIN
E PRODUKTEVE BUJQËSORE
DHE TURIZMIN NË DIBËR

Eja në Dibër

4-6 tetor 2018

- PANAIRE - EKSPOZITA - TURE TURISTIKE - MUZIKË
- USHQIM TRADICIONAL - VEPRIMTARI PËR FËMIJË

USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE · Sweden Sverige · Albanian Local Capacity Development Foundation · World Vision · AVizion · Connecting Natural Values & People

cyan magenta yelloë black